



RAPORT I SHKENCËS PËR POLITIKAT - JRC

Promovimi i mësimit efektiv në epokën digjitale

*Korniza evropiane për
organizatat arsimore
kompetente në sferën
digjitale*

Panagiotis Kampylis, Yves Punie, Jim Devine

2015

Joint
Research
Centre

EUR 27599 EN

Ky publikim është një raport në kuadër të Shkencës për politikat i Qendrës së Përbashkët për Kërkime, shërbimit të brendshëm të Komisionit Evropian për shkencën. Qëllimi i tij është ofrimi i mbështetjes shkencore të bazuar në dëshmi për procesin evropian të shtjellimit të politikave. Rezultatet shkencore të shprehura nuk përbëjnë qëndrimin politik të Komisionit Evropian. As Komisioni Evropian e as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit Evropian nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet këtij publikimi.

Qendra shkencore e JRC-së
<https://ec.europa.eu/jrc>

JRC98209

EUR 27599 EN

PDF ISBN 978-92-79-54005-9 ISSN 1831-9424 doi:10.2791/54070 LF-NA-27599-EN-N

© European Union, 2015

Riprodhimi lejohet, me kusht që të njihet burimi.

Si të citohet: Kampilis, P., Punie, Y. & Devine, J. (2015); Promoting Effective Digital-Age Learning - A European Framework for Digitally-Competent Educational Organisations; EUR 27599 EN; doi:10.2791/54070

Të gjitha imazhet © European Union 2015, përveç: Kopertina, f/sco - Fotolia.com

Abstrakt

Promovimi i mësimi efektiv në epokën digjitale - Korniza evropiane për organizata arsimore kompetente në sferën digjitale

Teknologjitë digjitale po përfshihen në forma premtuese dhe interesante në të gjitha nivelet e arsimit. Për të konsoliduar progresin dhe për të siguruar qëndrueshmëri dhe shtrirje, institucionet arsimore duhet të rishikojnë strategjitë e tyre organizative për të rritur kapacitetin e tyre për novacion dhe për të eksploruar potencialin e plotë të teknologjive dhe përmbajtjes digjitale. Ky raport prezanton *Kornizën evropiane për organizata arsimore kompetente në sferën digjitale* (DigCompOrg). Korniza mund të lehtësojë transparencën dhe krahasuesmërinë midis nismave të ndërlidhura nëpër Evropë dhe të luaj një rol në adresimin e fragmentimit dhe zhvillimit të pabarabartë në Shtetet anëtare. Qëllimet parësore të Kornizës DigCompOrg janë (i) të inkurajojë vetë-reflektimin dhe vetë-vlerësimin brenda organizatave arsimore gjatë kohës që ato thellojnë në mënyrë progresive angazhimin e tyre me mësimin dhe pedagogjitë digjitale (ii) t'u mundësojë politikëbërësve të dizajnojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë ndërhyrjet e politikave për integrimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive të mësimi digjital.

Tabela e përmbajtjes

Fjala hyrëse.....	2
Mirënjohje.....	3
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrje.....	7
2. Objektivat dhe metodologjia	8
2.1 Rishikimi i literaturës.....	9
2.2 Inventari	9
2.3 Analizë e detajuar.....	12
2.4 Konsultimi me ekspertë dhe palë interesi	16
3. Rezultatet: Korniza DigCompOrg	17
3.1 Elementi tematik: Praktikat e lidërshpit dhe qeverisjes	21
3.2 Elementi tematik: Praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies	23
3.3 Elementi tematik: Zhvillimi profesional	25
3.4 Elementi tematik: Praktikat e vlerësimit	26
3.5 Elementi tematik: Përmbajtja dhe kurrikula	28
3.5 Elementi tematik: Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi	30
3.5 Elementi tematik: Infrastruktura	32
4. Diskutim.....	34
5. Vërejtjet përmbyllëse dhe puna në të ardhmen	36
Referencat	37
Lista e shkurtesave dhe përkufizimet	38
Lista e tabelave.....	44
Shtojca 1: Ekspertët që kontribuan në zhvillimin e DigCompOrg.....	45
Shtojca 2: Matrica e analizës së detajuar	46
Shtojca 3: Faktet e strukturuar të kornizave/pyetësorëve (SAQ) të analizuar	49

Fjala hyrëse

Instituti IPTS i JRC-së është përfshirë për më shumë se dhjetë vite në kërkime që mbështesin zhvillimin e politikave dhe praktikave në fushën e mësimit digjital, një fushë që po zhvillohet shpejt, duke filluar me një punëtori dhe raport për *Të ardhmen e TIK-ut dhe mësimin në shoqërinë e njohurive*¹. Kjo punëtori dhe raporti treguan për nevojën për një vizion të përditësuar të mësimit për të adresuar shkathtësitë dhe kompetencat e reja të nevojshme që Evropa të arrijë rritje të mençur, të qëndrueshme dhe përfshirëse. Ato prezantuan një vizion të *hapësirave të të nxënësve* që përkrah potencialin e mësimit me teknologji digjitale (atëherë të referuara si *TIK për mësimnxënien dhe shkathtësinë*) për të formësuar dhe për të kontribuar për karakteristika të të nxënësve që priten në të ardhmen: të nxënësve të lidhur, social, i personalizuar, relevant, i besueshëm, i këndshëm, emocional, kreativ, fleksibil, i hapur dhe i certifikuar. Ky vizion i hapësirave të të nxënësve kishte në qendër nxënësin, duke pranuar në të njëjtën kohë se të nxënësve është një proces social.

Dhjetë vite më vonë, shumë nga çështjet e përfshira brenda këtij vizioni ishin ende në agjendën arsimore. Teknologjitë personale dhe arsimore janë zhvilluar me shpejtësi që atëherë, në aspektin e funksionalitetit, pranisë kudo dhe depërtimit social. Sot, ndikimi i teknologjive digjitale, përmbajtjes dhe proceseve mund të shihet në të gjithë sektorët arsimorë (p.sh. shkollat, arsimin e lartë dhe po ashtu në mësimin informal dhe joformal), duke ndikuar në të gjitha aspektet e zinxhirit të vlerës arsimore (p.sh. reforma curriculare, praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimi, zhvillimi profesional fillestar dhe i vazhdueshëm i mësimdhënësve) dhe përfshirjen e të gjithë akterëve në arsim (mësimdhënësve, nxënësve, drejtuesve të shkollave).

Teknologjitë digjitale mundësojnë ndryshime të mëdha në praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies; megjithatë ato nuk i garantojnë ato. Një ndryshim në shkallë dhe i qëndrueshëm kërkon qasje sistematike të shumanshme, duke përfshirë investimin në infrastrukturë dhe në zhvillimin profesional të mësimdhënësve, ndryshimin e kurrikulës, ri-shtjellim të vlerësimit të nxënësve dhe vlerësimit të mësimdhënësve, marrjen e vendimeve të duhura për përmbajtje që lidhen me kurrikulën, promovimin e bashkëpunimit dhe përmbajtjeve të praktikave të hapura, dhe integrimin e të gjitha këtyre brenda një mjedisi që siguron qeverisje të mirë dhe mbikëqyrje të cilësisë.

Nismat e njëpasnjëshme kërkimore të institutit IPTS të JRC-së mbështesin politikat evropiane për modernizimin dhe novacionin në arsim dhe trajnime. Në veçanti, raporti i prezantuar këtu prezanton *Kornizën evropiane të referimit për organizatat arsimore kompetente në sferën digjitale* (DigCompOrg) të zhvilluar përmes një qasjeje të kombinuar, duke përfshirë rishikimin gjithëpërfshirës të literaturës akademike dhe asaj gri, analizën e detajuar të kornizave ekzistuese dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit që promovojnë integrimin e teknologjive digjitale në arsim dhe në sisteme të trajnimit në nivel kombëtar/ndërkombëtar, dhe një proces të konsultimit me ekspertë dhe palë të interesit.

Korniza konceptuale e DigCompOrg mund të udhëzojë trajektore të ndryshme të integritit dhe përdorimit efektiv të teknologjive në mësimin digjital dhe të stimulojë kërkime të mëtejme në fushë, duke kontribuar në modernizimin e sistemeve të arsimit dhe trajnimit nëpër Evropë.

Ky raport është pjesë e studimit "Zhvillimi i mëtejme i arsimit novator" (InnovativEdu) të filluar nga DG për Arsim dhe Kulturë (DG EAC) dhe institutit IPTS të JRC-së - Njësia e IS-së² në dhjetor 2014 dhe do të vijojë deri në qershor 2017.

Më shumë informacione për kornizën DigCompOrg dhe lidhjet për publikimet e ndërlidhura mund të gjenden në faqen e internetit: <https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomporg>

¹ <http://ftp.jrc.es/EURdoc/eur22218en.pdf>

² Instituti për Studimet e Ardhshme Teknologjike (IPTS) është një nga shtatë institutet shkencore të Qendrës së Përbashkët për Kërkime të Komisionit Evropian (JRC). IPTS-ja e JRC-së përbëhet nga gjashtë njësi kërkimore, njëra nga të cilat është Njësia e Shoqërisë së Informacionit. Shih më shumë në <https://ec.europa.eu/jrc/en/institutes/ipts>

Mirënjohje

Autorët e këtij raporti falënderojnë Mario Roccaro, Konstantin Scheller, Geir Ottestad, Irina Sombre-Nizovtseva, Jan Pakulski, Bodo Richter dhe Denis Crowley, nga Drejtoria Gjenerale për Arsim dhe Kulturë (DG EAC), për mbështetjen dhe reagimet e tyre të vazhdueshme lidhur me të gjitha aspektet e studimit të InnovativEdu, duke përfshirë këtë raport.

Kontributi i veçantë i Mario Roccaro në ofrimin e komenteve me vlerë dhe të detajuara në versionet e mëhershme të këtij raporti vlerësohet shumë, përfshirë edhe roli i tij në koordinimin së bashku me Konstantin Scheller të sesioneve të punës në grup dhe shkëmbimit të përvojave për kornizën DigCompOrg gjatë takimeve të grupit punues të ET2020 për mësimin digjital dhe në linjë. Gjithashtu falënderojmë anëtarët e Grupit punues për ofrimin e të dhënave me vlerë dhe kontributin në diskutime në faza të ndryshme të zhvillimit të kornizës.

Autorët falënderojnë gjithashtu pjesëmarrësit e punëtorive me ekspertë të mbajtura në Sevilje më 20 nëntor 2014, ku u prezantuan rezultatet preliminare të DigCompOrg dhe u mbajtën diskutime për zhvillimin e mëtejshëm të kornizës konceptuale. Falënderime të veçanta shkojnë për ekspertët që ofruan informacione shtesë për kornizat dhe mjetet e vetë-vlerësimit që u analizuan (shih fletët e fakteve në Shtojcën 3) si dhe për ekspertët që ofruan komente dhe të dhëna për versionet draft të kornizës (lista e ekspertëve që kontribuuan në zhvillimin e kornizës DigCompOrg është në Shtojcën 1).

E fundit por jo më pak e rëndësishme, falënderime për kolegët e IPTS – JRC që ofruan komente dhe sugjerime, në veçanti: Riina Vuorikari, Margherita Bacigalupo, Jonatan Castaño Muñoz dhe Andreia Inamorato dos Santos. Falënderim edhe për Patricia Farrer për lektorimin dhe redaktimin e versionit final të këtij raporti.

Përmbledhje ekzekutive

Konteksti i politikës

[Strategjia Evropa 2020](#) pranon se Arsimit dhe Trajnimi (A&T) luajnë rol strategjik që Evropa të mbetet konkurruese, të tejkalojë krizën ekonomike aktuale dhe të shfrytëzojë mundësitë e reja. Transformimi digjital i sistemeve të A&T është i pranishëm në disa nisma të njohura të strategjisë Evropa 2020 dhe promovimi i shkathtësive digjitale dhe mësimi në linjë është në mesin e [prioriteteve të Presidentit J.C. Juncker](#). Gjithashtu, nisma e Komisionit Evropian e quajtur [Hapja e Arsimit](#) thekson nevojën që institucionet arsimore të rishikojnë strategjitë e tyre për të integruar teknologjitë digjitale në mësimdhënie, mësimnxënie dhe praktikën e tyre organizative.

Megjithatë, transformimi digjital i organizatave arsimore po përparon në shkallë të ndryshme, me synime dhe rezultate të ndryshme në rajone dhe vende të ndryshme në Evropë. Si rezultat, **ka pak hapësirë për mësim të ndërsjellë** për praktikën më të mira ose për dështimet në procesin e integrimit ose përdorimit efektiv të teknologjive të mësimi digjital. Si rrjedhim, ka rrezik që të mos shfrytëzohen mundësitë për bashkëpunim, që puna të dyfishohet dhe të përsëriten zbatime të nivelit nën-optimal.

Konkluzionet kyçe

Teknologjitë digjitale po përfshihen në forma premtuese dhe interesante në të gjitha nivelet e arsimit. Për të konsoliduar progresin dhe për të siguruar shtrirje dhe qëndrueshmëri, institucionet arsimore duhet të rishikojnë strategjitë e tyre organizative për të rritur kapacitetin e tyre për novacion dhe për të eksploruar potencialin e plotë të teknologjive dhe përbajtjes digjitale.


Janë disa korniza dhe mjete të vetë-vlerësimit që përdoren në disa vende evropiane, por nuk është bërë asnjë përpjekje për të zhvilluar një model pan-evropian të kapacitetit digjital për organizatat. **Një kornizë evropiane e referimit që përdor një qasje sistematike mund të shtojë vlerë duke promovuar transparencën, krahasueshmërinë dhe shkëmbimin e përvojave.**

Ky është qëllimi i *Kornizës evropiane për organizata arsimore kompetente në sferën digjitale* (DigCompOrg). Ajo mund të lehtësojë **transparencën dhe krahasueshmërinë** midis nismave të ndërlidhura nëpër Evropë dhe mund të luajë rol në adresimin e fragmentimit dhe zhvillimit të pabarabartë në Shtetet anëtare. Përveç kësaj, Korniza është me vlerë si e tillë sepse **mund të përdoret nga organizatat arsimore** (p.sh. shkollat fillore, të mesme dhe profesionale, si dhe institucionet e arsimit të lartë) si udhëzues për procesin e vetë-reflektimit për progresin e tyre drejt integrimit gjithëpërfshirës dhe aplikimit efektiv të teknologjive të mësimi digjital. DigCompOrg po ashtu mund të përdoret si **mjet planifikimi strategjik për politikëbërësit** për të promovuar politika gjithëpërfshirëse për të kuptuarit efektiv të teknologjive të mësimi digjital nga organizatat arsimore në nivel rajonal, kombëtar dhe evropian.

Gjetjet kryesore

Gjetja kryesore e studimit është se **një qasje konceptuale e përbashkët** në nivel evropian, e aftë të mbështetë zhvillimin e kapacitetit digjital në organizata arsimore, **është e dëshirueshme dhe e arritshme.**

Korniza DigCompOrg ka **shtatë elemente kyçe** dhe **pesëmbëdhjetë nën-elemente** që janë të përbashkët për të gjithë sektorët e arsimit. Ka po ashtu hapësirë për të shtuar elemente dhe nën-elemente specifike për çdo sektor. Për secilin nga elementet dhe nën-elementet e DigCompOrg, janë zhvilluar **një numër i përshkruesve** (gjithsej 74). Në mënyrë grafike, elementet, nën-elementet dhe përshkruesit e DigCompOrg prezantohen si sektorë të një rrethi, me theks në ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e tyre.



Aktivitetet e JRC-së të ndërlidhura ose të ardhshme

Nisma e Komisionit Evropian [Hapja e arsimit](#) nënvizon rëndësinë e zhvillimit të '...**kornizave të kompetencës digjitale dhe mjeteve të vetë-vlerësimit për nxënësit, mësimdhënësit dhe organizatat**' dhe bën thirrje për një përpjekje të bashkërenduar për të shfrytëzuar mundësitë e revolucionit digjital dhe për të përmirësuar bazën e njohurive për shkathtësi digjitale për shekullin 21.

IPTS-JRC, përveç kornizës DigCompOrg, ka zhvilluar edhe Kornizën e kompetencës digjitale për nxënësit ([DIGCOMP](#)) dhe tani po zhvillon Kornizën e kompetencës digjitale për mësimdhënësit.

Faza e ardhshme e DigCompOrg do të fokusohet në zhvillimin e një *Pyetësori të vetë-vlerësimit për shkollat kompetente në sferën digjitale* (p.sh. shkollat fillore, të mesme dhe profesionale) bazuar në përshkruesit e DigCompOrg.

Udhëzues i shpejtë

Teknologjitë e mësimin digjital, në kontekstin e DigCompOrg, përbëjnë një element lehtësues kyç për organizatat arsimore, për të mbështetur përpjekjet e tyre për të arritur misionin dhe vizionin e tyre për arsim cilësor. Integrimi i thellë, për dallim nga ai sipërfaqësor, i teknologjive digjitale kërkon novacion të konsiderueshëm në arsim dhe përfshin një proces të planifikimit për **ndryshim në tri dimensione bazë: pedagogjik, teknologjik dhe organizativ**.

DigCompOrg ofron një **kornizë konceptuale gjithëpërfshirëse dhe të përgjithshme** që reflekton të gjitha aspektet e procesit të integrimit sistematik të mësimin digjital në organizatat arsimore nga të gjithë sektorët e arsimit. Mund të përshtatet për kontekste të veçanta brenda të cilit veprojnë organizatat arsimore, ndërmjetësit ose zhvilluesit e projekteve (p.sh. mund të shtohen elemente, nën-elemente ose përshkrues specifik për sektorin).

DigCompOrg nuk i zëvendëson, por i plotëson kornizat e tjera që përdoren tashmë për qëllime të veçanta: p.sh. korniza [DIGCOMP](#) mund të përdoret për të zhvilluar aspekte relevante të kompetencës digjitale të nxënësve.

Qëllimet parësore të kornizës DigCompOrg janë (i) **të inkurajojë vetë-reflektimin dhe vetë-vlerësimin brenda organizatave arsimore** ndërsa ata thellojnë në mënyrë progresive angazhimin e tyre me mësimin dhe pedagogjitë digjitale (ii) **t'u mundësojë politikëbërësve** (në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar) **të dizajnojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë programet, projektet dhe ndërhyrjet e politikave** për integrimin e teknologjive të mësimin digjital në sistemet e A&T.

DigCompOrg është e dizajnuar që **të fokusohet kryesisht në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim dhe aktivitete të ndërlidhura të mbështetjes së mësimin** të ndërmarra nga një organizatë. Si e tillë, nuk ka për qëllim të adresojë gamën e plotë të sistemeve për menaxhimin e informatave dhe administrative që mund të përdoren nga organizata. DigCompOrg përfshin elemente, nën-elemente dhe përshkrues që mund të shihen si të lidhur me 'përgjegjësitë organizative' (p.sh. infrastrukturën) ose me 'përgjegjësitë individuale' (p.sh. praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies). Kjo reflekton faktin se një organizatë arsimore kompetente në sferën digjitale i duhet një **kombinim i balancuar** i lidershit dhe qeverisjes së fuqishme (për vizion dhe **strategji nga lart-poshtë**) dhe personel dhe palë të interesit të afta për të marrë përgjegjësi personale (për veprime të inicluara vetë dhe **përpyjekje dhe nisma nga poshtë-lart**).

1. Hyrje

Arsimi njihet gjerësisht si një prej mjeteve më të rëndësishme për sigurimin e konkurrueshmërisë dhe prosperitetit në epokën e globalizimit. Marrë parasysh këtë, vendet në mbarë botën mundohen të modernizojnë sistemet e tyre të arsimit dhe trajnimit (A&T) për të mbajtur hapin me ekonominë dhe shoqërinë digjitale.

Strategjia Evropa 2020³ pranon se nevojitet një transformim thelbësor i Arsimit dhe Trajnimit (A&T) për të ofruar njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme nëse Evropa dëshiron të mbetet konkurruese, të tejkalojë krizën ekonomike aktuale dhe të shfrytëzojë mundësitë e reja. Sistemet novatore të A&T janë prioritet kyç në disa nisma të strategjisë Evropa 2020,⁴ në veçanti në Agjendën për shkathtësi të reja dhe vende pune, Rinia në lëvizje, Agjendën digjitale dhe Agjendën e novacionit. Krahas transformimit digjital të arsimit dhe trajnimit, promovimi i shkathtësive digjitale dhe mësimi në linjë përmendet edhe në prioritetet e reja të Komisionit Juncker, në veçanti ato me fokus në Tregun e vetëm digjital⁵ dhe në Vendet e punës, rritje dhe investim⁶.

Pranohet se është e nevojshme që [organizatat arsimore](#)⁷ si shkollat dhe universitetet të integrohen dhe të përdorin në mënyrë efektive teknologjitë digjitale për të arritur [misionin](#) e tyre themelor: edukimin e [studentëve](#) për të qenë të suksesshëm në një botë komplekse dhe të ndërlidhur që përballlet me ndryshime të shpejta teknologjike, kulturore, ekonomike, ndërkombëtare dhe demografike.

Në këtë kontekst, teknologjitë dhe përmbajtja digjitale luajnë një rol të rëndësishëm çdo ditë e më shumë për nxitjen dhe promovimin e [novacionit arsimor](#) dhe, rrjedhimisht, shumë politika në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar janë duke promovuar përdorimin e tyre në sistemet e A&T (p.sh. Kampylis et al., 2013). Përdorimi efektiv i [teknologjive të mësimi digjital](#) po ashtu është një element kyç në strategjinë e Komisionit Evropian për hapjen dhe modernizimin e sistemeve të A&T. Siç theksohet në nismën [Hapja e arsimit](#) (Komisioni Evropian, 2013), institucionet e A&T duhet të rishikojnë strategjitë e tyre organizative dhe të përmirësojnë kapacitetin e tyre për të promovuar novacionin dhe shfrytëzimin e potencialit të teknologjive të reja dhe [përmbajtjes digjitale](#). Marrë parasysh këtë, është e dukshme nevoja që Komisioni Evropian të zhvillojë në bashkëpunim me palët e interesit dhe Shtetet anëtare (ShA) '...korniza të kompetencës digjitale dhe mjete të vetë-vlerësimit për nxënësit, mësimdhënësit dhe organizatat' (ibid., fq. 7).

Kërkimi i diskutuar në këtë raport bazohet në Kornizën e kompetencës digjitale (DIGCOMP) për qytetarët⁸ (Ferrari, 2013) dhe e plotëson atë, dhe ka për synim të shoqërojë dhe mbështetë aktivitetet e vazhdueshme të politikave duke inkurajuar integrimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive digjitale nga organizatat arsimore. Organizatat arsimore dhe politikëbërësit në Evropë aktualisht janë aktivë në promovimin dhe integrimin e teknologjive digjitale në praktikën e tyre të mësimdhënies, mësimnxënies dhe ato organizative. Megjithatë, modernizimi i organizatave arsimore po përparon me shpejtësi të ndryshme dhe me synime dhe rezultate të ndryshme në rajone dhe vende të ndryshme në Evropë (p.sh. Komisioni Evropian, 2015). Si rezultat, ka pak hapësirë për mësim të ndërsjellë lidhur me praktikën më të mira dhe/ose dështimet, dhe ekziston rreziku që të mos shfrytëzohen mundësitë për bashkëpunim, që puna të dyfishohet dhe zbatime të nivelit nën-optimal të përsëriten.

³ http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

⁴ Për një përmbledhje shih: http://ec.europa.eu/europe2020/europe-2020-in-a-nutshell/flagship-initiatives/index_en.htm

⁵ <https://ec.europa.eu/digital-agenda/en/digital-single-market>

⁶ http://ec.europa.eu/archives/juncker-commission/priorities/01/index_en.htm

⁷ Një fjalor i termave kyç mund të gjendet në Shtojcën 1. Paraqitja e parë e secilit prej termave të përfshirë në këtë fjalor është nënvizuar në tekst dhe është ofruar një hyperlink për te fjalori.

⁸ Korniza identifikon komponentët kyç të kompetencës digjitale dhe është zbatuar tashmë në disa Shtete anëtare (<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomp/implementation>).

2. Objektivat dhe metodologjia

Puna e tanishme synon të adresojë këto probleme duke zhvilluar një Kornizë evropiane për organizatat arsimore kompetente në sferën digjitale (DigCompOrg). DigCompOrg është zhvilluar në kontekstin e studimit kërkimor *Promovimi* i arsimit novator në Evropë (InnovativEdu), i cili u lancua nga DG për Arsim dhe Kulturë dhe Njësia IS e institutit IPTS të JRC-së në dhjetor 2014 dhe do të vijojë deri në qershor 2017. Studimi InnovativEdu ka këto objektiva:

- (i) Të zhvillojë një Kornizë evropiane të referimit për [organizata arsimore kompetente në sferën digjitale](#) (DigCompOrg - që është fokusi i këtij raporti), bashkë me një [pyetësor të vetë-vlerësimit](#) (SAQ) që do të zhvillohet duke u bazuar në DigCompOrg;
- (ii) Të zhvillojë një kornizë të [kompetencës digjitale](#) për [mësimdhënësit](#), bashkë me një pyetësor të vetë-vlerësimit (SAQ);
- (iii) Të analizojë modelet e politikave efektive për integrimin dhe përdorimin novator të teknologjive digjitale në sistemet e A&T; dhe
- (iv) Të ofrojë dëshmi kërkimi për përdorimin e [analitikës së të nxëniet](#) në kontekstet e A&T dhe implikimet e mundshme për politikat në arsim.

Qasja metodologjike e përdorur për zhvillimin e DigCompOrg ishte në pjesën më të madhe cilësore (shiko një përmbledhje në Figurën 1), bazuar në katër elemente kryesore që përshkruhen në detaje në seksionet më poshtë:

- rishikimi gjithëpërfshirës i literaturës akademike dhe asaj gri;
- një listë e kornizave ekzistuese dhe pyetësorëve vetë-vlerësues që promovojnë integrimin e teknologjive digjitale në sisteme arsimit dhe trajnimit në nivel kombëtar/ndërkombëtar;
- analizë e detajuar e kornizave/pyetësorëve vetë-vlerësues të përzgjedhur; dhe
- konsultimet me ekspertë dhe palë të interesit.




Figura 1: Metodologjia e përgjithshme për zhvillimin e DigCompOrg

2.1 Rishikimi i literaturës

Si pikë fillimi për zhvillimin e DigCompOrg, instituti IPTS i JRC-së ka kryer një rishikim të zgjeruar të literaturës akademike dhe asaj gri. Në veçanti, mbledhja e të dhënave dhe analiza e përmbajtjes mbuluan një gamë të gjerë të materialeve, si ato teknike, raporte vlerësimi dhe të politikave; punime për revista dhe konferenca; kapituj librash; sajte uebi, *wikis* dhe blorge; literaturë promovuese (p.sh. fletëpalosje); videoklipe; dhe prezantime me slajde. Qëllimet kryesore të rishikimit të literaturës ishin:

- zhvillimi i një konceptualizimi të termit *Organizatart arsimore kompetente në sferën digjitale*, duke përfshirë përkufizimet, elementet kyçe, modelet, mundësuesit dhe barrierat;
- zhvillimi i një liste duke identifikuar dhe përmbledhur korniza dhe pyetësorë vetë-vlerësimi që lidhen me Organizatat arsimore kompetente në sferën digjitale.

Përmes rishikimit të literaturës, u identifikuan një numër i kornizave dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit në Evropë dhe rajone të tjera nëpër botë. U përpilua një listë e 20 'rasteve premtuese' dhe u bë një analizë nga instituti IPTS i JRC-së për përzgjedhjen e kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit për analizim të mëtejshëm.

2.2 Inventari

Analiza mbuloi këto kritere:

- verifikimin që secila kornizë ose pyetësor i vetë-vlerësimit përdoret (ose mund të përdoret) nga organizatat arsimore për vetë-vlerësimin e praktikave të tyre në integrimin dhe përdorimin në mënyrë efektive të teknologjive digjitale dhe/ose nga politikëbërësit për mbështetjen e nismave të ndërlidhura për politika;
- verifikimin se nisma është duke vazhduar dhe se mund të merren të dhëna të besueshme dhe relevante;
- paraqitja e kornizave dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit, duke përdorur një skemë të zhvilluar nga instituti IPTS i JRC-së (shih Figura 2), për të siguruar që kornizat/pyetësorët e përzgjedhur të vetë-vlerësimit reflektojnë mbulimin më të gjerë të mundshëm të:
 - *fazës së zbatimit*: duke përshkruar fazat e zhvillimit, nga aplikimi i kufizuar (pilot) deri te ai më i konsoliduar (i shkallës) e deri te përdorimi i rregullt (sistem i rregullt);
 - *nivellit të qasjes*: duke iu referuar mbulimit gjeografik të kornizës/pyetësorit të vetë-vlerësimit nga një zonë e kufizuar (rajonale) te një hapësirë më e gjerë (kombëtare), e deri te një nivel ndërkombëtar ose mbarë botëror (ndërkombëtar);
 - *sektorit arsimor*: duke marrë sektorët arsimorë ku kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit janë të aplikueshëm, nga një sektor në dy ose më shumë (disa sektorë);
 - *burimit(eve)* të informacionit: duke treguar se kush i ofron informatat/të dhënat për integrimin e teknologjive digjitale në një organizatë arsimore të caktuar, nga një person (kontribuues i vetëm) te më shumë se një (disa kontribuues) e deri te një gamë e gjerë e palëve të interesit (gamë e gjerë e kontribuuesve);
 - *fushëveprimi të përdorimit*: duke iu referuar përdorimit të rezultateve të kornizës/pyetësorit të vetë-vlerësimit, nga përdorimi i saj/tij nga individët e deri në nivel të organizatës ose më tej, p.sh. mbledhjen në nivel të sistemit.
- verifikimi se secili rast reflekton një qasje autentike dhe unike që mund të ofrojë njohuri për zhvillimin e DigCompOrg dhe (në fazën tjetër) të pyetësorit përkatës të vetë-vlerësimit.




Figura 2: Skema e ndërlidhjes⁹

Tabela 1 paraqet një përmblendje të 15 kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit të përzgjedhur nga instituti IPTS i JRC-së për analizë të detajuar bazuar në kriteret e përmendura më sipër. Dy nga kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit nuk fokusohen shprehimisht në integrimin e teknologjive digjitale: HEInnovate synon potencialin ndërmarrësor dhe novator të institucioneve të arsimit të lartë dhe Vensters është kryesisht një mjet për llogaridhënien dhe transparencën e shkollave. Megjithatë, ekipi i kërkimit vendosi t'i analizojë ato në detaje (duke bërë përjashtim për kriterin e parë) sepse ato ofrojnë njohuri me vlerë për strukturën dhe praktikën e zbatimit të kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit për organizatat arsimore.

Tabela 1: Përmblendje e kornizave dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit (SAQ) të analizuar

FW/SAQ	Lloji	Elementet/ nën-elementet /përshkruesit ose deklaratat	Që nga	Sektori arsimor/mbulimi gjeografik	Kush ofron informacionet
eLEMER	Kornizë dhe SAQ në linjë	4/40/100	2010	P-S ¹⁰ , Hungari	Mësimdhënësit, studentët
Opeka	FW dhe SAQ në linjë	3/17/145	2012	P-S, Finlandë	Mësimdhënësit
Microsoft SRT	Kornizë dhe SAQ në linjë	4/16/16x6	2009	P-S, Në mbarë botën	Drejtorit(ët)
LIKA	FW dhe SAQ në linjë	4/-/78	2013	P-S, Suedi	Drejtorit(ët)
Ae-MoYS	FW dhe SAQ në linjë	5/-/30	2011	P-S, BE	Koordinatori i shkollës ODS
e-Learning Roadmap	FW dhe matricë e shtypur	5/-/27x4	2009	P-S, Irlandë	Drejtorit(ët)

⁹ Skema e ndërlidhjes u realizua gjatë punëtorisë në Sevilje me ekspertët e ftuar dhe përfshin 7 kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit që ata përfaqësonin.

¹⁰ P-S është shkurtesa për shkollat fillore dhe të mesme, ndërsa HE për arsimin e lartë (terciar). FW është shkurtesa për kornizë dhe ODS për Open Discovery Space (<http://opendiscoveryspace.eu>). Titujt e plotë të kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit janë dhënë në Tabelën 3.

School mentor	Kornizë dhe SAQ në linjë	6/-/30x5	N/A	P-S, Norvegji	Drejtori(ët)
NAACE SRF	Kornizë dhe SAQ në linjë	6/11/55x4	2005	P-S, MB	Disa opsione
FCMM	Kornizë dhe SAQ në linjë	5/-/5x5	2010	P-S, BE	Disa opsione
Speak Up NRP	Kornizë SAQ në linjë	Pyetësorë vetë-vlerësimi të ndryshëm	2003	P-S, SHBA	Disa palë interesi
Vensters	SAQ në linjë	20 tregues	2008	P-S, Holandë	Disa palë interesi
SCALE CCR	FW	8/28/-	2012	kryesisht P-S, në mbarë botën	Nuk ka pyetësor vetë-vlerësimi
ePOBMM	Kornizë dhe SAQ në linjë	7/-/60x5	2013	kryesisht HE, BE	-
Jisc	FW dhe SAQ (si skedar MS Excel)	6/-/69	2010	HE, MB	Udhëheqësit (Biznes dhe TIK)
HEInnovate	Kornizë dhe SAQ në linjë	7/-/44	2013	HE, në mbarë botën	Disa palë interesi

Një inventar u krijua duke përfshirë dy fletë në Excel për secilën nga kornizat/pyetësorin e vetë-vlerësimit, duke ofruar:

- tërë informacionin e disponueshëm bazuar në studimin e dokumenteve dhe fletët e strukturuar të fakteve të ofruara nga ekspertët (Shtojca 4);
- kornizën/pyetësorin e plotë të vetë-vlerësimit.

Struktura e inventarit prezantohet në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2: Struktura e inventarit

Titulli dhe adresa(t) e uebit	Emri i kornizës/pyetësorit të vetë-vlerësimit (SAQ) dhe hyperlink për te sajti(et) e saj të uebit
Lloji	A është kornizë, SAQ apo të dyja
Përshkrim i shkurtër	Ofron një kontekst të shkurtër të nevojshëm për ta kuptuar më mirë
Fushëveprimi gjeografik	Cilin rajon(e)/vend(e) synon ose ku zbatohet
Spektori arsimor	Arsimi fillor, i mesëm, profesional, terciar
Gjuha(ët)	Gjuha(ët) në të cilën është e disponueshme
Periudha kohore	Date e fillimit dhe data e përfundimit të zhvillimit/zbatimit
Zhvilluesi(t)	Entiteti(et) dhe palët e interesit të përfshirë në zhvillimin e tyre
Historiku	Nëse ka korniza/pyetësorë vetë-vlerësimi paraprakë, të ngjashëm
Personi(at) kyç	Emri(at) dhe detajet e kontaktit të personi(ave) kyç të përfshirë në zhvillimin dhe/ose zbatimin e tyre
Financimi/modeli i biznesit	Si financohet, duke përfshirë burimet e financimit publik/të korporatave
Objektivat	Adresimi i objektivave të përgjithshme dhe specifike
Fusha e fokusit	Qëllimi kyç (p.sh. integrimi i teknologjive digjitale)
Relevanca e politikës	Nëse lidhet me cilëndo politikë arsimore në nivel rajonal, kombëtar ose të BE-së
Profili i përdoruesit	Popullata që synohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga korniza/SAQ (nganjëherë kombinim, p.sh. drejtorët, mësimmshënësit dhe studentët) dhe kush ofron të dhënat (dhe kur)
Strategjia e zbatimit	Si zbatohet nisma për politikën, numri i organizatave arsimore të synuara, nëse ka stimuj për përdorimin etj.
Përdorimi	Kush ka qasje në rezultate, si mund të përdoren, nëse lejojnë krahasimin e rezultateve me të tjerët etj.
Ndikimi	Rezultatet cilësore dhe sasiore të gjeneruara si rezultate direkte të zbatimit, p.sh. numri i organizatave arsimore të mbuluara
Elementet kyçe	Kokëzimet dhe përshkrimi i elementeve kyçe
Nën-elementet	Kokëzimet dhe përshkrimi i nën-elementeve
Pyetjet/deklaratat	Në rastin e pyetësorëve të vetë-vlerësimit, numri i pyetjeve/deklaratave të përdorura, lloji i tyre, sa pyetje janë të detyrueshme etj.
Nivelet/shkalla	Në rastin e pyetësorëve të vetë-vlerësimit, shkalla/nivelet e maturisë të përdorura
Mësimet e nxjerra	Vëzhgime të veçanta/interpretime/përfundime lidhur me zhvillimin dhe zbatimin

Publikimet/burimet	Publikimet, raportet e ndërlidhura dhe dokumentacioni në linjë
Shënimet e kërkimit	Shënimet e mbajtura nga ekipi i kërkimit
Korniza/pyetësori i plotë i vetë-vlerësimit	Korniza/pyetësori i plotë i vetë-vlerësimit ishte e përfshirë në një faqe Excel-i të veçantë.

Gati të gjitha kornizat dhe pyetësorët e analizuar të vetë-vlerësimit janë nga konteksti i arsimit në Evropë (me përjashtim të Speak Up NRP nga SHBA), sepse qëllimi ishte të zhvillohet një kornizë konceptuale që do t'i shërbejë organizatave arsimore evropiane. Lista e kornizave dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit të paraqitur më lart nuk është shteruese por është e mjaftueshme për përfaqësimin e kornizave dhe pyetësorëve ekzistues të vetë-vlerësimit në Evropë, sidomos për sektorin e shkollës, meqë 12 nga 15 kornizat/pyetësorët e analizuar të vetë-vlerësimit janë për [arsimin fillor/të mesëm](#). Numri i pakët i kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit për institucionet e arsimit të lartë mund të reflektojë faktin se, për shkak se infrastrukturën e tyre të TIK-ut janë shumë të zhvilluara, ato nuk janë fokusuar në zhvillimin e kapacitetit të tyre digjital për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe në veçanti praktikën e reja pedagogjike.

Disa nga kornizat dhe pyetësorët e vetë-vlerësimit të analizuar janë zhvilluar gjatë një periudhe prej më shumë se dhjetë viteve (si Speak Up NRP në SHBA) ose janë mjete që janë bazuar në nisma të mëparshme që kanë filluar disa vite më parë (p.sh. Korniza e vetë-rishikimit e NAACE në MB është pasuese e Kornizës së vetë-rishikimit të Becta¹¹). Për më shumë, shumë prej kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit të analizuar janë zhvilluar nga organizata dhe institucione publike të kërkimit (me përjashtim të Microsoft SRT). Të gjitha kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit që janë analizuar janë të disponueshëm falas, me përjashtim të SRF-së së NAACE.

Disa nga këto korniza/pyetësorë të vetë-vlerësimit janë dukshëm nisma pilot, si ePOBMM, e cila u krijua në kontekstin e projektit të Europortfolio¹². Në anën tjetër, të tjerat si, Vensters në Holandë, kanë arritur tashmë fazën e përdorimit të rregullt (Figura 2). Në aspektin e mbulimit gjeografik, kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit variojnë nga nismat kombëtare në gjuhë lokale, si LIKA që ofrohet në gjuhën suedeze, e deri te Microsoft SRT ose HEInnovate që janë nisma ndër-kufitare dhe mbulojnë një numër të madh të shteteve.

Akterët e përfshirë në këto korniza/pyetësorë të vetë-vlerësimit përfaqësohen kryesisht nga drejtorët e shkollës që kanë ofruar informacionin përkatës për integrimin e teknologjive digjitale nga organizata arsimore në fjalë. Në disa korniza/pyetësorë të vetë-vlerësimit, një sërë palësh të interesit ofrojnë informacione përkatëse duke përdorur pyetësorë të përshtatur (shih për shembull Speak-up NRP). Shumë nga nismat kanë një kornizë dhe një pyetësor të vetë-vlerësimit ose matricë. Pjesa më e madhe e këtyre pyetësorëve/matricave ofrohen si mjete në linjë, ndonëse njëri ofrohet në formë të shtypur (e-Learning Roadmap). Kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit të analizuar kanë 3 deri në 8 elemente kyçe. Disa janë relativisht të shkurtër (p.sh. the FCMM), që është matricë me 5X5 përshkrues, ndërsa mjetet e tjera janë më komplekse (p.sh. ePOBMM me 30x5 përshkrues).

2.3 Analiza e detajuar

Qëllimi ishte të analizoheshin në detaje dhe të krahasoheshin kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit të përzgjedhur për të identifikuar pikat e përbashkëta, pikat e dallimit dhe mangësitë, për të marrë njohuri për dizajnin, fokusin e tyre, metodologjinë dhe strategjitë e zbatimit, dhe për të sintetizuar praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra.

Tabela 3 ofron një përmbledhje të shkurtër të fokusit, karakteristikave të spikatura dhe mësimet të nxjerra nga të 15 kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit të analizuar. Njohuri me vlerë për zhvillimin e DigCompOrg u mblodhën edhe nga korniza dhe mjete të tjera në linjë:

¹¹ http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20101102103713/https://selfreview.becta.org.uk/about_this_framework

¹² <http://www.europortfolio.org/events/eportfolios-and-open-badges-maturity-matrix-webinar>

- Modeli Four in Balance¹³ (Kennisset, 2013), kishte për qëllim të ndihmonte shkollat holandeze që përdorin teknologjitë digjitale të bënin zgjedhje që do të përmirësonin cilësinë dhe produktivitetin e arsimit që ofrojnë;
- Nisma kërkimore SABER-ICT¹⁴ e Bankës Botërore që identifikonte një grup prej tetë temash që trajtohen në përgjithësi në bazën e të dhënave globale të dokumenteve për politikën lidhur me përdorimin e TIK-ut në arsim (vizioni dhe planifikimi; infrastruktura e TIK-ut; mësimdhënësit; shkathtësitë dhe kompetencat; burimet mësimore; përdorimi i TIK-ut në menaxhimin e sistemit të arsimit; monitorimi dhe vlerësimi, kërkimi dhe novacioni; barazia, përfshirja dhe siguria);
- Balanced Scorecard¹⁵, që përdoret gjerësisht në biznes si model që nxit performancën.

Pika e fillimit dhe baza për analizën e detajuar është koncepti shumë dimensional i Klasave kreative (Creative Classrooms (CCR)) që instituti IPTS i JRC-së ka zhvilluar në emër të DG EAC në kontekstin e studimit Përmirësimi i klasave kreative në Evropë (SCALE CCR) (Kampylis, Bocconi & Punie, 2012; Bocconi, Kampylis & Punie, 2013). CCR-të janë mjedise kreative të të nxëniet që përfshijnë dhe shfrytëzojnë potencialin e novacionit të teknologjive digjitale për praktikën e mësimnxënies dhe mësimdhënies në arsimin formal, joformal dhe informal. Korniza konceptuale CCR ofron një qasje sistematike për zbatimin e teknologjive digjitale në një kontekst arsimor dhe përbëhet nga tetë dimensione përfshirëse dhe të ndërlidhura: përmbajtja dhe kurrikula; vlerësimi; praktikën e të nxëniet; praktikën e mësimnxënies; organizimi; lidhshmëria dhe vlerat; lidhshmëria; dhe infrastruktura.

Një kornizë/pyetësor i vetë-vlerësimit që është shqyrtuar si shembull dhe mbështetje për shqyrtimin e DigCompOrg është HEInnovate i zhvilluar nga Komisioni Evropian dhe OECD-ja. Ndonëse HEInnovate është kryesisht mjet i vetë-vlerësimit për Institucionet ndërmarrëse të arsimit të lartë, mësimet e nxjerra nga struktura e tij dhe strategjitë e zbatimit kanë ndihmuar shumë për zhvillimin e DigCompOrg.

Në fazën e parë të analizës së detajuar, elementet kyçe të kornizave/pyetësorëve të përzgjedhur të vetë-vlerësimit (Tabela 1) u paraqitën në një matricë (shih Shtojca 3) duke sjellë kështu zhvillimin e versionit të parë të DigCompOrg.

Në fazën e dytë të analizës së detajuar, ekipi i institutit IPTS të JRC-së u fokusua në nën-elementet dhe përshkruesit përkatës të përfshirë në secilën kornizë/pyetësor të vetë-vlerësimit të analizuar për ta zhvilluar më tej DigCompOrg dhe për të ofruar detaje për të. Nën-elementet dhe deklaratat/përshkruesit nga kornizat/pyetësorët e vetë-vlerësimit të analizuar u paraqitën kundrejt elementeve kyçe të DigCompOrg. Nën-elementet dhe përshkruesit finalë të DigCompOrg të prezantuar në Kapitullin 3 janë rezultat i:

- skemës së ndërlidhjes;
- njohurive nga rishikimi i literaturës;
- inputeve nga konsultimet me ekspertë dhe palë interesi.

Bazuar në këto inpute, ekipi i kërkimit (institutit IPTS i JRC-së dhe Jim Devine) mori vendimet finale lidhur me zhvillimin, organizimin dhe prezantimin e DigCompOrg.

¹³ https://www.kennisnet.nl/fileadmin/kennisnet/publicatie/vierinbalans/Four_in_balance_Monitor_2013.pdf
¹⁴ <http://saber.worldbank.org/index.cfm?indx=8&tb=10>
¹⁵ <http://balancedscorecard.org/Resources/About-the-Balanced-Scorecard>

Tabela 3: Fokusi, karakteristikat e spikatura dhe mësimet e nxjerra nga analiza e detajuar

Titulli/titulli i shkurtër dhe hyperlink	Fokusi	Karakteristikat e spikatura dhe mësimet e nxjerra
eLEMER	Integrimi i TIK-ut – tërë shkolla	Nga përdoruesit kërkohet të ofrojnë dëshmi të mundshme (p.sh. plane mësimore, rregullore të shkollës, e-portfolio etj.) për të mbështetur përgjigjet e tyre. Ofron një pamje çasti për vendin. 66% e mësimdhënësve dhe 50% e studentëve anketohen. Krahasimi me mesataren e vendit. Të dhënat e përmbledhura përdoren për politikëbërje .
Opeka	Vlerësimi i kompetencave dhe kulturës digjitale të mësimdhënësve dhe shkollave	Kërkimi cilësor bëhet për të validuar rezultatet e mjetit. Ka edhe pyetje për cilësinë e vetë mjetit . Krahasimi me mësimdhënësit e tjerë nga e njëjta shkollë ose i njëjti qytet, mësimdhënësit që japin të njëjtën lëndë ose me të gjithë mësimdhënësit. Informacioni nga mjetet përdoret për të modifikuar politikën e TIK në arsim në Finlandë
Microsoft Innovative Schools Toolkit and Self-Reflection Tool / Microsoft SRT	Mjeti i menaxhimit të ndryshimit për integrimin e TIK-ut	Fokusi në krijimin e një vizioni . Mbështetje për të menaxhuar procesin e ndryshimit .
Ledning, Infrastruktur, Kompetens, Användning / LIKA	Mbështetje e shkollave për të vlerësuar, planifikuar dhe prioritetizuar integrimin e TIK-ut	Plotësuar nga një blog me pyetje dhe përgjigje, video . Përdoruesi vendos se kush ka qasje në rezultate (vetëm unë, shkolla ime apo kushdo por në mënyrë anonime). Krahasimet vetëm jashtë linjës.
Assessing the e-Maturity of your School / Ae-MoYS	Pikat e forta dhe të dobëta në përdorimin e TIK-ut për mësimdhënie dhe mësimnxënie	Nuk ka krahasime, por rezultatet përdoren për të krijuar planin e veprimit të shkollës. Një përqindje indikative e integritetit ofrohet në rastin e shumë elementeve.
Planning and implementing e-learning in your school / e-Learning Roadmap	Ku janë të pozicionuara aktualisht shkollat në e-mësim dhe ku duan të arrijnë	Mjet planifikimi në letër, pjesë e Manualit për planifikimin dhe zbatimin e eMësimit. Nuk ka krahasim, por mundësohet planifikimi dhe vetë-vlerësimi për tërë shkollën.
School mentor	Reflektimi për lehtësimin dhe ekzekutimin e përdorimit pedagogjik të TIK-ut	Plotësuar nga Teacher Mentor . Synuar për drejtorët , por për përdorim në bashkëpunim me personelin tjetër. Nuk ka krahasime, sepse vetëm shkolla ka qasje në rezultate dhe mund të vendosë nëse dëshiron t'i japë qasje ose jo pronarit të shkollës.
Self-review Framework / NAACE SRF	Rrjedhë e strukturuar për rishikimin dhe përmirësimin e përdorimit të teknologjisë nga shkollat – kosto vjetore	Shkolla arrin një nivel të caktuar (me dëshmi mbështetëse) dhe aplikon për Akreditim kombëtar për cilësi (ICT Mark) .
Future Classroom Maturity Model / FCMM	U mundëson mësimdhënësve dhe shkollave të vlerësojnë nivelin e novacionit me teknologji	OER nën CC . Pjesë e Paketës së mjeteve për klasat e së ardhmes. Raport diagnostikues për të planifikuar për nivelin e ardhshëm të maturimit. Krahasimi me mesataren kombëtare dhe ndërkombëtare.
Speak Up National Research Project / Speak Up NRP	Studentët, prindërit, edukatorët në arsimin dhe teknologjinë e shekullit 21	40% e pyetjeve ndërrohen çdo vit. Gjetjet ndahen çdo vit me politikëbërësit federal, shtetëror dhe lokal për të mbështetur vendimet për programet, politikat dhe financimin e arsimit. 2.6 milion palë interesi kanë marrë pjesë deri më tani .

Vensters voor Primair en Voortgezet Onderwijs¹⁶ / Vensters	Llogaridhënia dhe transparenca¹⁷ – sistem i rregullt	Ekziston një bazë kombëtare e të dhënave me rezultate dhe ka partneritet me institute të kërkimit . Shkollat vendosin se cilat rezultate prezantohen, si dhe ata mund të shtojnë shpjegimin e tyre për ta. 88% e shkollave fillore dhe më shumë se 95% e shkollave të mesme janë të përfshira. Përdorimi është vullnetar por ka presion nga shkollat e tjera dhe nga publiku.
Up-scaling Creative Classrooms in Europe / SCALE CCR	Përmirësimi i inovacionit në mësimin e mundësuar me ndihmën e TIK-ut – pa SAT	Model ekologjik i ndryshimit . Një numër i aplikacioneve dhe ndikim (p.sh. më shumë se 120 citime duke përfshirë dokumentet e politikave).
The ePortfolios & Open Badges Maturity Matrix / ePOBMM	Integrimi i ePortfoliove dhe Open Badges	Plan nga i cili matricat e përshtatura mund të dizajnohen. Jo normativ .
Jisc Strategic ICT Toolkit / Jisc	Mundësitë institucionale dhe individuale në 'mundësuesit e biznesit të teknologjisë strategjike'	Në MS Excel për të lejuar përshtatje të lehtë . Grupe të ndryshme të pyetjeve për secilin grup. Nuk ka krahasime, por skedari Excel mund të përshtatet me lehtësi.
HEInnovate	Potenciali ndërmarrësor¹⁸ dhe novator i IAL-ve	Një komunitet profesional ndërkombëtar po zhvillohet rreth kësaj nisme. Qasje në raste studimore, shënime udhëzuese etj.

¹⁶ Përkthyer si Kornizë për arsim fillor dhe të mesëm. E njohur edhe si *Scholen op de kaart* (shkollat në hartë).

¹⁷ Ndonëse Vensters nuk i referohet drejtpërdrejt përdorimit të teknologjive digjitale në arsim, ajo përfshihet në analizën e detajuar sepse është tashmë në fazën e rregullt dhe ofron njohuri me vlerë për strategji të suksesshme të zbatimit.

¹⁸ Fokusi i HEInnovate është në potencialin ndërmarrësor dhe novator të institucioneve të arsimit të lartë dhe jo në integrimin e teknologjive digjitale. Megjithatë, është përfshirë sepse është e strukturuar mirë dhe e lehtë për përdoruesin me një fushëveprim ndërkombëtar dhe strategji zbatimi interesante.

2.4 Konsultimi me ekspertë dhe palë interesi

Skema e ndërlidhjes dhe analiza e detajuar e kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit si dhe drafti i parë i DigCompOrg u validua përmes një punëtorie të organizuar nga instituti IPTS i JRC-së (20 nëntor 2014, Sevilje) dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të përfshirë në zhvillimin dhe/ose zbatimin e kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit të analizuar (shih Shtojca 2). Për pjesën më të madhe të këtyre kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit, fletët e strukturuar të fakteve u plotësuan nga ekspertët e ftuar (Shtojca 4) dhe u përdoren në fazën e dytë të analizës.

Bazuar në konsultimet me ekspertë gjatë punëtorisë në Sevilje, si dhe në skemën e ndërlidhjes dhe analizën e detajuar të kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit të përzgjedhur, ekipi i kërkimit i institutit IPTS të JRC-së arriti në konkluzionet në vijim:

"Ndonëse disa korniza/mjete që lidhen me përdorimin e teknologjive digjitale nga organizatat arsimore janë në dispozicion ose përdoren në një numër vendesh në Evropë, ende nuk është ndërmarrë një qasje sistemike dhe një qasje konceptuale e përbashkët nuk është e evidente. Një Kornizë evropiane e referimit që përdor një qasje sistemike mund të rekomandohet dhe të shtojë vlerë duke lejuar krahasueshmërinë dhe shkëmbimin e përvojave (peer learning)".

Bazuar në analizën e detajuar dhe rezultatet nga punëtorja me ekspertët, drafti i parë i DigCompOrg u rishikua nga instituti IPTS i JRC-së dhe u prezantua në takimin e 3-të të grupit punues të strategjisë ET2020 për të nxënëit digjital dhe në linjë (WG DOL) në Bruksel më 18 mars 2015¹⁹.

Bazuar në komentet e marra nga anëtarët e këtij grupit punues (ET2020 WG DOL), instituti IPTS i JRC-së zhvilloi dhe prezantoi një version më të përditësuar dhe më të elaboruar (drafti i plotë) të kornizës²⁰ në takimin e 4-të të grupit punues (WG DOL) në Bruksel më 29 qershor 2015, si dhe një prezantim duke përfshirë një përmbledhje të analizës së detajuar të bërë për 15 kornizat dhe pyetësorët e përzgjedhur të vetë-vlerësimit. Të njëjtat materiale iu dërguan edhe ekspertëve pjesëmarrës në punëtori në Sevilje për të marrë reagimet e tyre për kornizën dhe validimin e analizës së detajuar.

Versioni i konsoliduar i DigCompOrg prezantohet në detaje në Kapitullin 3 në vijim dhe diskutohet në Kapitullin 4.

¹⁹ https://www.yammer.com/et2020workinggroups/#/uploaded_files/32625464?threadId=512249049

3. Rezultatet: korniza DigCompOrg

DigCompOrg synohet për përdorim nga organizatat arsimore (shkollat fillore, të mesme dhe profesionale, si dhe institucionet e arsimit të lartë si universitetet, kolegjet universitare dhe shkollat politeknike) për të vetë-reflektuar për **progresin e tyre në integrimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive të mësimit digjital**. Teknologjitë e mësimit digjital konsiderohen gjerësisht nga organizatat arsimore si mundësues të **misionit të tyre bazë dhe vizionit për arsim cilësor**. Nga ky këndvështrim, integrimi progresiv dhe përdorimi efektiv i teknologjive digjitale mund të ketë karakterin e një **novacioni në arsim**, dhe kjo nënkupton një proces të planifikimit të **ndryshimeve në tri dimensione themelore**: atë pedagogjik, teknologjik dhe organizativ.

DigCompOrg është e strukturuar në shtatë elemente tematike që janë të përbashkëta për të gjitha sektorët e arsimit (pra, ndër-sektoriale). Secili nga këto shtatë elemente reflekton një aspekt të ndryshëm në procesin kompleks të integritit dhe përdorimit efektiv të teknologjive të mësimit digjital. **Të gjitha elementet janë të ndërlidhura dhe duhet të shihen si pjesë e një tërësie**. Përveç elementeve ndër-sektoriale, DigCompOrg është e hapur për të shtuar elemente që janë specifike për secilin sektor (shih më shumë në Seksionin 4, Diskutimi).

Për gjashtë nga shtatë elementet tematike ndër-sektoriale janë identifikuar një sërë elementesh të ndërlidhura. Figura 3 ofron një paraqitje grafike të DigCompOrg me elementet dhe nën-elementet e saj. Harqet e jashtme përfaqësojnë të shtatë elementet ndër-sektoriale dhe një element shtesë (ende i paspecifikuar) rezervohet për kërkesat specifike për secilin sektor. Jashtë rrethit, identifikohen të 15 nën-elementet e kornizës. Brenda rrethit, janë 75 fusha, që përfshijnë 74 përshkruesit plus elementin specifik për sektorin që mund të nën-ndahet në X numër të përshkruesve që mbetet të përcaktohen në një fazë të mëvonshme²¹.

²¹ Ky numër është indikativ. Siç përmendet edhe në seksionin e diskutimit, numri i elementeve, nën-elementeve dhe përshkruesve specifikë për çdo sektor është i hapur për t'u përshtatur sipas nevojave dhe specifikave lokale.




Figura 3: Elementet kyçe dhe nën-elementet e DigCompOrg

Të 74 përshkruesit janë paraqitur shkurtimisht më poshtë (shih Tabelën 5) dhe në detaje në seksionet në vijim.

Tabela 4: Përmbledhje e DigCompOrg

Elementet tematike	Nën-elementet	Përshkruesit
Praktikat e lidershipit dhe qeverisjes	Integrimi i Mësimi në epokën digjitale është pjesë e misionit, vizionit dhe strategjisë së përgjithshme	1. Potenciali i teknologjive të mësimi digjital theksohet qartë
		2. Përfitimet e teknologjive të mësimi digjital komunikohen
		3. Plan strategjik përfshin mësimin në epokën digjitale
		4. Arsimi i hapur është një aspekt i angazhimit publik
	Strategjia për mësimin në epokën digjitale mbështetet nga një plan zbatimi	5. Planifikimi bazohet te lehtësuesit ndërsa adreson pengesat
		6. Palët e brendshme të interesit kanë një shkallë të autonomisë
		7. Mundësitë, stimujt dhe shpërblimet për personelin janë identifikuar
		8. Mësimi në epokën digjitale është i harmonizuar me prioritetet më të gjera
		9. Ka qëllime të dyanshme për modernizimin e arsimit ekzistues dhe ofrimin e mundësive të reja

	Ekziston një model menaxhimi dhe qeverisjeje	10. Plani i zbatimit kuptohet nga të gjithë dhe ka zotim lidhur me të 11. Përgjegjësia e menaxhmentit është e përcaktuar qartë 12. Burimet janë në harmoni me buxhetet dhe personelin 13. Rezultatet, cilësia dhe ndikimi i planit të zbatimit rishikohen 14. Nismat specifike ose pilot vlerësohen 15. Statusi i zbatimit krahasohet 16. Mbikëqyrja e politikave dhe drejtimi i tyre është i dukshëm
Praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies	Kompetenca digjitale promovohet, krahasohet dhe vlerësohet	17. Personeli dhe studentët janë kompetent në teknologjinë digjitale 18. Siguria, rreziku dhe sjellja e përgjegjshme në mjedise në linjë është në plan të parë 19. Kompetenca digjitale (KD) e personelit dhe studentëve krahasohet 20. KD-ja përfshihet në vlerësimin e personelit
	Rolet dhe qasjet pedagogjike rimendohen	21. Personeli janë partnerë në ndryshim 22. Parashihen role të reja për personelin 23. Parashihen role të reja për studentët 24. Qasjet pedagogjike zgjerohen 25. Mësimi i personalizuar zhvillohet 26. Kreativiteti promovohet 27. Bashkëpunimi dhe puna në grup priten 28. Shkathtësitë sociale dhe emocionale zhvillohen
Zhvillimi profesional	-	29. Zotimi për Zhvillim të vazhdueshëm profesional (ZHVP) është i dukshëm 30. ZHVP-ja ofrohet për personelin në të gjitha nivelet 31. ZHVP-ja është e harmonizuar me nevojat personale dhe organizative 32. Një gamë e gjerë e qasjeve të ZHVP-së është e dukshme 33. Mundësitë për ZHVP të akredituar/certifikuar promovohen
Praktikat e vlerësimit	Formatet e vlerësimit janë tërheqëse dhe motivuese	34. Fushëveprimi i vlerësimit formativ zgjerohet 35. Vlerësimi sumativ diversifikohet 36. Vetë-vlerësimi dhe vlerësimi midis studentëve (peer assessment) promovohet 37. Inkurajohen dhe priten reagime të pasura, të personalizuara dhe kuptimplote
	Mësimi informal dhe joformal njihen	38. Mësimi i mëparshëm, i bazuar në përvojë dhe mësimi i hapur njihen dhe akreditohej
	Dizajni i mësimit mbështetet nga analitika	39. Analitikës së të nxënësve i jepet konsideratë strategjike 40. Ekziston një kod i praktikës për analitikën e të nxënësve 41. Mësimi mbështetet përmes analitikës së të nxënësve 42. Menaxhimi i cilësisë dhe dizajni i kurrikulës/programit mbështetet përmes analitikës së të nxënësve
Përmbajtja dhe kurrikula	Përmbajtja digjitale dhe OER-ja promovohen dhe përdoren gjerësisht	43. Personeli dhe studentët janë krijuesit e përmbajtjes 44. Depot e përmbajtjes përdoren gjerësisht dhe në mënyrë efektive 45. Pronësia intelektuale dhe të drejtat e autorit respektohen 46. Mjetet dhe përmbajtjet digjitale janë të licencuara siç kërkohet 47. Burimet arsimore të hapura promovohen dhe përdoren
	Kurrikula ridizajnohet ose riinterpretohet për të reflektuar mundësitë pedagogjike që sjellin teknologjitë digjitale	48. Mësimi i bazuar në lëndë riimagjinohet për të krijuar qasje më të integruara 49. Koha dhe vendi i mësimit riplanifikohen 50. Ofrimi në linjë është realitet 51. Mësimi në kontekste autentike promovohet 52. Ofrimi i mësimit digjital është i dukshëm në fushat e kurrikulës 53. Kompetenca digjitale e studentëve zhvillohet në tërë kurrikulën

Bashkëpunim i dhe rrjetëzimi	Rrjetëzimi, ndarja dhe bashkëpunimi promovohen	54. Bashkëpunimi në rrjet i personelit për të marrë ekspertizë dhe për të ndarë përmbajtjet është normë
		55. Përpjekjet për këmbimin e njohurive vlerësohen
		56. Studentët angazhohen në rrjetëzim efektiv
		57. Pjesëmarrja në aktivitete dhe evente të këmbimit të njohurive promovohet
	Përdoret një qasje strategjike e komunikimit	58. Bashkëpunimi i brendshëm dhe këmbimi i njohurive priten
		59. Ekziston një strategji e qartë e komunikimit
	Zhvillohen partneritete	60. Një prani dinamike në linjë është e dukshme
		61. Një zotim për këmbim të njohurive përmes partneriteteve është i dukshëm
		62. Personeli dhe studentët stimulohen për t'u përfshirë në mënyrë aktive në partneritete
Infrastruktura	Hapësirat fizike dhe virtuale të mësimit janë të dizajnuara për mësimin në epokën digjitale	63. Hapësirat fizike të mësimit optimizojnë mundësitë e mësimit në epokën digjitale
		64. Hapësirat virtuale të mësimit optimizohen
	Infrastruktura digjitale planifikohet dhe menaxhohet	65. Ekziston një Politikë e përdorimit të pranueshëm
		66. Ekspertiza teknike dhe pedagogjike drejton investimet në teknologji digjitale
		67. Një gamë e teknologjive të mësimit digjital mbështet mësimin në çdo kohë/në çdo vend
		68. Qasjet Sill pajisjen tënde (SPT) mbështeten
		69. Rreziqet lidhur me pabarazinë dhe përfshirjen digjitale adresohen
		70. Mbështetja teknike dhe e përdoruesit është e dukshme
		71. Teknologjitë ndihmëse adresojnë nevojat e veçanta
		72. Merren masa për të mbrojtur privatësinë, konfidencialitetin dhe sigurinë
		73. Planifikim efektiv i prokurimit është i dukshëm
		74. Ekziston një plan operacional për rrjetin kryesor dhe shërbimet bazë të TIK
Elementi(et) specifik për sektorin	Nën-elementi(et) specifik për sektorin	Përshkruesi(it) specifik për sektorin

3.1 Elementi tematik: praktikat e lidershipit dhe qeverisjes

Ky element i DigCompOrg i referohet roli të lidershipit në integrimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive digjitale në tërë organizatën lidhur me misionin dhe aktivitetet e saj të mësimdhënies/mësimnxënies. Procesi i planifikimit strategjik të organizatës duhet të përfshijë teknologjitë e mësimin digjital, dhe këto në këmbim duhet të jenë gur themel i një vizioni arsimor afatgjatë të definuar dhe të komunikuar mirë. Vizioni duhet të mbështetet në mënyrë të dukshme përmes lidershipit dhe qeverisjes dhe të artikulohet në plane strategjike afatshkurta dhe afatmesme.

Elementi tematik *Praktikat e lidershipit dhe qeverisjes* përbëhen nga tri nën-elemente dhe gjashtëmbëdhjetë përshkrues të paraqitur më poshtë.

Tabela 5: Nën-elementet dhe përshkruesit e Praktikave të lidershipit dhe qeverisjes

Integrimi i Mësimin në epokën digjitale është pjesë e misionit, vizionit dhe strategjisë së përgjithshme Faktorët që nxisin mësimin efektiv duke përfshirë integrimin dhe përdorimin në tërë organizatën të teknologjive të mësimin digjital janë të përfshirë qartë në deklaratat e misionit, vizionit dhe strategjinë e organizatës.	
Potenciali i teknologjive të mësimin digjital theksohet qartë	Proceset strategjike/të planifikimit të organizatës dhe dokumentacioni përfshijnë një vizion dhe mision që artikulon qartë potencialin e teknologjive të mësimin digjital për të modernizuar praktikat arsimore , të orientuara drejt rezultateve më gjithëpërfshirëse të të nxënës.
Përfitimet e teknologjive të mësimin digjital komunikohen	Organizata ka proceset e duhura për komunikimin brenda dhe jashtë të vizionit dhe për përfitimet që do të ketë nga integrimi i teknologjive të mësimin digjital.
Plani strategjik përfshin mësimin në epokën digjitale	Plani strategjik i organizatës bazohet në dëshmi dhe mbështetet nga kërkime të vazhdueshme për përdorimin në arsim të teknologjive digjitale dhe përfshin qëllime dhe objektiva specifike në lidhje me përfshirjen e mësimin në epokën digjitale në forma të qëndrueshme në tërë organizatën me treguesit e ndërlidhur të performancës .
Arsimi i hapur është një aspekt i angazhimit publik	Aspekti i angazhimit publik i strategjisë së organizatës përfshin zotimin ndaj praktikave të arsimit të hapur si kurset e hapura, ligjëratat e hapura dhe qasja e hapur ndaj burimeve dhe publikimeve digjitale.
Strategjia për mësimin në epokën digjitale mbështetet nga një plan zbatimi Organizata ka një plan zbatimi të kapacitetit digjital të përkufizuar mirë dhe realist, me prioritetet e qarta dhe objektiva të matshme për përdorimin efektiv të teknologjive të mësimin digjital në mbarë organizatën, në kontekstin e një politike/plani strategjik të përgjithshëm për mësimdhënie, nxënie dhe vlerësim.	
Planifikimi bazohet te lehtësuesit ndërsa adreson pengesat	Plani i zbatimit të kapacitetit digjital është i kontekstualizuar dhe bazohet në mundësues/lehtësues të integritetit të teknologjisë së mësimin digjital, duke adresuar në të njëjtën kohë pengesat e mundshme.
Palët e brendshme të interesit kanë një shkallë të autonomisë	Plani i zbatimit të kapacitetit digjital u lejon palëve të brendshme një shkallë të autonomisë për zbatimin e teknologjive të mësimin digjital, në kontekstin e një politike të përgjithshme për mësimdhënie dhe mësimdhënie dhe/ose kërkesave të një kurrikule.
Mundësitë, stimujt dhe shpërblimet për personelin identifikohen	Plani i zbatimit të kapacitetit digjital identifikon mundësi, stimujt dhe shpërblime për personelin që angazhohet në mënyrë aktive në procesin e ndërtimit të kapacitetit digjital dhe modernizimin e mjediseve të nxënës.

Mësimi në epokën digjitale është i harmonizuar me prioritete më të gjera	Plani i zbatimit të kapacitetit digjital është i harmonizuar me prioritete më të gjera, duke përfshirë mundësi të barabarta dhe duke zgjeruar pjesëmarrjen për të reduktuar disfavorizimet sociale dhe rrezikun e adresimit joadekuat të nevojave të grupeve të caktuara si studentëve të talentuar, emigrantëve dhe atyre që braktisin shkollën para kohe.
Ka qëllime të dyanshme për modernizimin e arsimit ekzistues dhe ofrimin e mundësive të reja	Plani i zbatimit të kapacitetit digjital përfshin jo vetëm përdorimin e teknologjive të mësimi digjital për të modernizuar arsimin ekzistues por edhe për të ofruar mundësi të reja për mësimin formal, joformal dhe informal .
Ekziston një model menaxhimi dhe qeverisjeje Ekziston një model menaxhimi dhe qeverisjeje për të koordinuar dhe mbikëqyrur planin e zbatimit për mësimin në epokën digjitale dhe kapacitetin digjital, duke përfshirë përdorimin efektiv të personave dhe burimeve të tjera dhe orkestrimin e integritetit dhe përdorimit efektiv të teknologjive të mësimi digjital.	
Plani i zbatimit kuptohet nga të gjithë dhe ka zotim lidhur me të	Ekipi i lidershit e kupton njëjtë se pse dhe si organizata kërkon të integrojë teknologjitë e mësimi digjital , dhe zotimi për zbatimin e planit është i dukshëm.
Përgjegjësia e menaxhmentit është e përcaktuar qartë	Përgjegjësia e menaxhmentit është e përcaktuar qartë për ekzekutimin dhe monitorimin e planit të zbatimit të kapacitetit digjital.
Burimet janë në harmoni me buxhetet dhe personelin	Personeli dhe burimet buxhetore të nevojshme për të mbështetur planin e zbatimit të kapacitetit digjital janë të identifikuar qartë dhe janë të optimizuara në kontekstin e buxhetit dhe planeve të personelit të organizatës.
Rezultatet, cilësia dhe ndikimi i planit të zbatimit rishikohen	Ka një proces për të rishikuar dhe raportuar në mënyrë periodike rezultatet, cilësinë dhe ndikimin e planit të zbatimit të kapacitetit digjital dhe për ta rishikuar atë për të marrë parasysh nevojat në zhvillim të organizatës dhe tendencat teknologjike në zhvillim dhe zhvillimet pedagogjike .
Nismat specifike ose pilot vlerësohen	Ka procese të duhura për vlerësimin e nismave specifike ose pilot që mund të ndërmerren nga organizata si pjesë e planit të zbatimit të kapacitetit digjital.
Statusi i zbatimit krahasohet	Ka një proces për të krahasuar me jashtë kapacitetin digjital të organizatës , sa i përket organizatave të ngjashme, në nivel rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar.
Mbikëqyrja e politikave dhe drejtimi është i dukshëm	Bordet e menaxhmentit ose autoritete e tjera qeverisëse angazhohen në çështje që lidhen me politikat dhe drejtimin në lidhje me mësimin në epokën digjitale.

3.2 Elementi tematik: praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Për kalim në [mësimin në epokën digjitale](#) (Rrjeti Evropian i Këshillave për Arsim, 2014), është jetike që organizatat të modernizojnë praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, për të përfituar nga potenciali i teknologjive të mësimin digjital si mundësues të përvojave më efektive të të nxënësve si brenda ashtu edhe në mjedisin e jashtëm dhe në ekosistemin e gjerë të njohurive.

Elementi tematik *Praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies* përbëhet nga dy nën-elemente dhe dymbëdhjetë përshkrues të paraqitur më poshtë.

Tabela 6: Nën-elementet dhe përshkruesit e Praktikave të mësimdhënies dhe mësimnxënies

Kompetenca digjitale promovohet, krahasohet dhe vlerësohet Ky nën-element thekson rëndësinë që personeli dhe studentët të demonstrojnë kompetencë digjitale (KD) të nevojshme për të përdorur në mënyrë efektive teknologjitë digjitale për mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim dhe udhëheqje. Gjithashtu adreson përgjegjësinë dhe detyrën për kujdes të organizatës lidhur me sigurinë dhe mirëqenien e personelit dhe studentëve gjatë kohës që janë të angazhuar me mjete digjitale. Siguria dhe vetëdijësimi për rreziqet, i balancuar me të kuptuarit e sjelljeve të përgjegjshme, janë me rëndësi parësore.	
Personeli dhe studentët janë kompetentë lidhur me teknologjinë digjitale	Organizata ka procese për të siguruar që personeli dhe studentët të kenë besim dhe të jenë kompetentë në integrimin e teknologjive digjitale në praktikën e tyre të përditshme (mësimdhënie, mësimnxënie, komunikim, vlerësim, administratë) dhe të jenë në gjendje të zgjedhin (ose të kenë qasje në) pajisje, softuerë, aplikacione, përmbajtje digjitale dhe shërbime në linjë që i përgjigjen më së miri nevojave dhe pritjeve të tyre arsimore.
Siguria, rreziku dhe sjellja e përgjegjshme në mjedisin në linjë është në plan të parë	Kompetenca digjitale e personelit dhe studentëve adreson sigurinë, vetëdijësimin për rreziqet dhe normat për sjellje të përgjegjshme në mjediset në linjë.
KD-ja e personelit dhe studentët krahasohen	Në planin e organizatës përshkruhet se si matet zhvillimi i kompetencave digjitale. Organizata ka adoptuar/përshtatur korniza relevante dhe mjete në linjë (p.sh. Kornizën DigComp , Kornizën e UNESCO-s për kompetencën digjitale për mësimdhënësit) për të krahasuar kompetencën digjitale të personelit dhe studentëve në mënyrë sistematike.
Kompetenca digjitale përfshihet në vlerësimin e personelit	Kompetenca digjitale përfshihet në vlerësimin e performancës së personelit.
Rolet dhe qasjet pedagogjike rimendohen Organizata fuqizon personelin dhe studentët dhe pret nga ta që të përdorin dhe të përshtatin praktika pedagogjike novatore të mundësuar me përdorimin e teknologjive të mësimin digjital dhe që t'i përdorin këto praktika në mjedisin në ndryshim të të nxënësve (brenda dhe jashtë organizatës) dhe për qëllime të ndryshme (formale dhe joformale)	
Personeli janë partnerë në ndryshim	Organizata synon të krijojë një kulturë ku personeli (përfshirë studentët nëse kjo është e përshtatshme) konsiderohen si partnerë në ndryshim dhe inkurajohen dhe stimulohen që të marrin rreziqe të llogaritura dhe të eksplorojnë qasje të reja që kontribuojnë në mënyrë aktive në integrimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive të mësimin digjital për rezultate të të nxënësve.
Parashihen role të reja për personelin	Organizata fuqizon personelin që të veprojnë si mentorë, orkestrues dhe lehtësues të mësimin dhe si model për mësimin gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin profesional personal . Pritet që personeli të eksperimentojë me përdorimin kreativ dhe novator të teknologjive digjitale për të bërë përmirësime në mësimnxënie dhe mësimdhënie.
Parashihen role të reja për studentët	Organizata promovon teknologji të ndryshme të mësimin digjital dhe përmbajtje multimodale, mjete dhe platforma që nxisin qasjet që kanë në qendër studentin të optimizuara për kontekste të caktuara të të nxënësve (përfshirë, për shembull, materialet audiovizuale,

	e-portfoliot, OER, simulimet, lojërat serioze, mjediset e kodimit dhe realizimit, artet kreative). Studentët inkurajohen dhe pritët nga ta që të veprojnë si nxënës të autodirigjuar dhe mund të konsiderohen dhe përfshihen si bashkë-dizajnues të procesit të të nxënës .
Qasjet pedagogjike zgjerohen	Mësimdhënia dhe mësimnxënia 'ridizajnohen' për të përfshirë teknologjitë digjitale. Bazuar në kërkime relevante, organizata promovon një diversitet të praktikave të mësimnxënies dhe mësimnxënies të mundësuar nga teknologjia, të cilat janë fleksibile, të adaptueshme dhe tërheqëse (p.sh. të nxënës përmes lojës, të nxënës përmes eksplorimit, të nxënës përmes krijimit, të nxënës përmes punës, të gjitha këto të përmirësuar dhe të zgjeruara përmes teknologjive digjitale).
Mësimi i personalizuar zhvillohet	Organizata mbështet dhe parasheh përdorimin e teknologjive të mësimi digjital për të rritur mundësitë për mësim të personalizuar , duke marrë parasysh pikat e forta, potencialin dhe pritjet e studentëve .
Kreativiteti promovohet	Studentët dhe personeli inkurajohen të eksplorojnë dhe diversifikojnë praktika kreative duke përdorur teknologjitë digjitale si mundësues të kreativitetit dhe shprehjes krijuese.
Bashkëpunimi dhe puna në grup priten	Meqë të nxënës është proces social, organizata inkurajohet dhe pret bashkëpunim dhe punë në grup, të mbështetura në shumë raste nga mjetet dhe platformat digjitale . Kjo inkurajon personelin dhe studentët që të mendojnë dhe punojnë si të pavarur dhe me të tjerët, duke ua mundësuar të marrin parasysh pluralitetin e perspektivave.
Shkathtësitë sociale dhe emocionale zhvillohen	Organizata promovon zhvillimin e shkathtësive sociale dhe emocionale nga personeli dhe studentët (shkathtësitë e nevojshme për të kuptuar dhe menaxhuar emocionet, për të caktuar dhe për të arritur qëllime pozitive, për të ndjerë dhe për të shfaqur empati për të tjerët, për të ndërtuar dhe mbajtur marrëdhënie pozitive dhe për të marrë vendime të përgjegjshme) dhe mënyrën se si këto shkathtësi mund të aplikohen në mjedise digjitale dhe në linjë .

3.3 Elementi tematik: zhvillimi profesional

Organizata lehtëson dhe investon në zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP), përfshirës dhe të përshtatur të personelit të saj në të gjitha nivelet për të zhvilluar dhe integruar mënyra të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies që shfrytëzojnë teknologjitë e mësimin digjital për të arritur më shumë rezultate të të nxënësve. Organizata pret që personeli të përfitojë plotësisht nga këto mundësi të ZHVP-së. Organizatat arsimore fokusohen në veçanti në ndërtimin e kapaciteteve në pedagogjinë digjitale të personelit që janë të angazhuar drejtpërdrejt me nxënësit dhe ata që janë të përfshirë në lidhshpin akademik/shkollor, menaxherial ose në rolet e dizajnit të kurseve.

Elementi tematik *Zhvillimi profesional* ka pesë përshkrues, por nuk ka nën-elemente, siç është paraqitur më poshtë. Konsultimet me ekspertë dhe palë të interesit, si dhe gjetjet nga analiza e detajuar sugjeruan fuqishëm që Zhvillimi profesional të qëndrojë në vete si një element kyç, si në rastin e një numri të kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit (shih Shtojca 3). Disa dokumente të politikave (p.sh. Komisioni Evropian 2013; 2015) theksojnë po ashtu se zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve është kërkesë për një mësim relevant dhe cilësor në epokën digjitale. Mbështetja e fuqishme për mësimdhënësit për të përdorur (mes tjerash) pedagogji novatore dhe teknologji digjitale në mënyrë optimale është po ashtu një nga gjashtë fushat e reja të prioritetëve për Arsimin dhe Trajnimin 2020²².

Tabela 7: Nën-elementet dhe përshkruesit e Zhvillimit profesional

Një zotim ndaj ZHVP-së është i dukshëm	Organizata zotohet për zhvillim profesional të personelit lidhur me integrimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive digjitale dhe pedagogjisë digjitale , si pjesë e një konteksti më të gjerë të vizionit, misionit dhe ofrimit të ZHVP-së në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien në përgjithësi.
ZHVP-ja ofrohet për personelin në të gjitha nivelet	Zhvillimi profesional ofrohet në tërë organizatën dhe ka për objektivi lidhshpin si dhe personelin e vijës së parë përmes ndërrhyrjeve të duhura të ZHVP-së me pritshmëri për pjesëmarrje të gjerë nga stafi.
ZHVP-ja është e harmonizuar me nevojat personale dhe organizative	Organizata ka procese që zbatohen për identifikimin, dizajnimin dhe zhvillimin (ose për prokurimin) e programeve të zhvillimit profesional që adresojnë aspekte të ndryshme të teknologjive të mësimin digjital dhe pedagogjisë digjitale, në harmoni me nevojat individuale dhe nevojat e veçanta të organizatës .
Një gamë e gjerë e qasjeve të ZHVP-së është e dukshme	Organizata përdor një gamë të gjerë të qasjeve për zhvillimin profesional të personelit (përfshirë këshillimin dhe mentorimin) , duke kombinuar ofrimin e tyre përmes pjesëmarrjes fizike dhe në linjë brenda dhe jashtë organizatës.
Mundësi për ZHVP të akredituar/certifikuar promovohen	Organizatat do të inkurajojnë dhe mbështesin personelin për të përfituar nga mundësitë për zhvillim profesional me akreditim/certifikim që kontribuojnë në profesionalizëm të shtuar të personelit në rolet e tyre të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit.

²² http://ec.europa.eu/education/news/2015/0901-et2020-new-priorities_en.htm

3.4 Elementi tematik: praktikat e vlerësimit

Ky element i DigCompOrg i referohet rolit që luajnë teknologjitë e mësimit digjital në mbështetjen e një qasjeje të integruar për vlerësimin, që ofron për të gjitha palët e interesit informacione në kohë dhe me kuptim për përvojat dhe arritjet e nxënësve. Elementi i vlerësimit përfshin masa të cilat organizatat mësimore mund t'i shqyrtojnë për të kaluar në mënyrë progresive nga vlerësimi tradicional drejt një repertori më përfshirës të praktikave. Ky repertor do të përfshijë praktika vlerësimi që kanë në qendër studentin, janë të personalizuar, autentike, të integruara dhe kuptimplote të cilat mund të marrin parasysh po ashtu njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e zhvilluara në mjedise formale, informale dhe joformale.

Elementi tematik *Praktikat e vlerësimit* ka nga tri nën-elemente dhe nëntë përshkrues të paraqitur në detaje më poshtë.

Tabela 8: Nën-elementet dhe përshkruesit e Praktikave të vlerësimit

Formatet e vlerësimit janë tërheqëse dhe motivuese	
Një sërë formatesh vlerësimi përdoren për të ofruar reagime në kohën e duhur, të personalizuar dhe me kuptim, që angazhojnë dhe i motivojnë studentët.	
Fushëveprimi i vlerësimit formativ zgjerohet	Organizatat përdorin teknologji të mësimit digjital për të zgjeruar fushëveprimin dhe llojshmërinë e proceseve për vlerësim formativ (vlerësimi për të nxënë), duke ua mundësuar mësimdhënësve të vlerësojnë jo vetëm njohuritë por edhe shkathtësitë dhe kompetencat (sidomos kompetencën digjitale).
Vlerësimi sumativ diversifikohet	Teknologjitë e mësimit digjital përdoren për të diversifikuar praktikën e vlerësimit sumativ (vlerësimi i të nxënit). Organizatat përdorin metodologjitë e testimit në linjë që mund të japin komente të menjëhershme, madje në kohë reale për studentë dhe mësimdhënës që po ashtu mund të lejojnë më shumë fleksibilitet në planifikimin e testeve.
Vetë-vlerësimi dhe vlerësimi midis studentëve promovohet	Një mjedis për vlerësimin ku ka nivel të lartë besimi midis personelit/studentëve inkurajohet brenda organizatës dhe personeli dhe studentët inkurajohen që të kërkojnë dhe të japin reagime në mënyrë rutinore. Praktikë efektive dhe të sakta të vetëvlerësimit dhe vlerësimit midis studentëve konsiderohen si kompetenca më vete , dhe teknologjitë e mësimit digjital mundësojnë integrimin e këtyre praktikave në organizatë për vlerësime formative, sumative dhe joformale.
Inkurajohen dhe priten reagime të pasura, të personalizuar dhe kuptimplote	Organizata inkurajon personelin që të shfrytëzojë potencialin e teknologjive të mësimit digjital për të ofruar reagime të pasura, të personalizuar dhe me kuptim për studentët dhe për të dokumentuar dhe komunikuar progresin e të nxënit të secilit nxënës në mënyra të reja dhe më efektive si e-portfoliot, simulimet adaptive dhe sistemet e mençura të mësimdhënies.
Mësimi formal, informal dhe joformal njihen	
Teknologjitë e mësimit digjital u mundësojnë individëve të mësojnë ku të duan dhe kur të duan. Mësimi informal dhe joformal që ndodhë jashtë mjediseve formale njihet dhe vlerësohet nga organizatat mësimore.	
Mësimi i mëparshëm, i bazuar në përvojë dhe mësimi i hapur njihen dhe akreditohen	Organizata mësimore ka politika për njohjen dhe akreditimin e mësimit të mëparshëm, të bazuar në përvojë dhe mësimit të hapur , duke përfshirë mësimin në mjedise informale dhe joformale që mund të verifikohen në mënyrë të arsyeshme. Këto politika rishikohen dhe përmirësohen në mënyrë sistematike, bazuar në zhvillimet pedagogjike dhe teknologjike (p.sh. Open Badges).
Dizajni i mësimit mbështetet nga analitika	
Përdorimi i teknologjive të mësimit digjital potencialisht vë në dispozicion një sasi të madhe të të dhënave për proceset e mësimit. Organizatat mësimore përdorin analitikën e të nxënit për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave për studentët dhe kontekstet e mësimit për përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe për planifikimin e kurrikulës ose programit dhe për vendimmarrje.	

Analitikës së të nxënit i ipet konsideratë strategjike	Organizata i ka dhënë konsideratë strategjike zbatimit të analitikës së të nxënit , me synim optimizimin e rezultateve të të nxënit individual dhe grupor dhe të performancës organizative.
Ekziston një kodi i praktikës për analitikën e të nxënit	Para zbatimit të analitikës së të nxënit, organizata ka adoptuar një kod të praktikës dhe procese për mbledhjen e sigurt, validimin, ruajtjen, grumbullimin, analitikën dhe raportimin e të dhënave të studentëve .
Mësimi mbështetet përmes analitikës së të nxënit	Organizata ka zbatuar aspekte të ndryshme të analitikës së të nxënit, duke përfshirë analitikën për të ofruar reagim personal në kohë reale për studentët (duke ndikuar kështu në procesin e tyre të menjëhershëm të të nxënit) dhe analitikën që grumbullon të dhënat me qëllimin e përmirësimit të proceseve të mësimin në të ardhmen ose mbështetjen e mësimin privat ose ndërhyrjet për përmirësim nga personeli .
Menaxhimi i cilësisë dhe dizajni i kurrikulës/programit mbështetet përmes analitikës së të nxënit	Të dhënat lidhur me progresin individual dhe arritjet mbledhen dhe analizohen në nivel të organizatës për të mbështetur proceset, duke përfshirë menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë , dizajnimin dhe rishikimin e kurseve, dhe ndërhyrjet e përshtatura për të përmirësuar aftësinë për të mbajtur mend dhe rezultatet në përgjithësi.

3.5 Elementi tematik: përmbajtja dhe kurrikula

Kurrikula rishikohet ose interpretohet (varësisht nga shkalla e autonomisë që ka organizata në lidhje me këto ndryshime) dhe përditësohet rregullisht për të shfrytëzuar potencialin e teknologjive të mësimi digjital dhe përmbajtjes digjitale për të modernizuar mësimdhënien, mësimnxënien dhe praktikën e vlerësimit dhe për të përmirësuar fushëveprimin e rezultateve të të nxënës.

Elementi tematik *Përmbajtja dhe kurrikula* ka nga dy nën-elemente dhe njëmbëdhjetë përshkrues të paraqitur më poshtë.

Tabela 9: Nën-elementet dhe përshkruesit e Përmbajtjes dhe kurrikulës

Përmbajtja digjitale dhe OER-ja promovohen dhe përdoren gjerësisht	
Organizata pret, lehtëson dhe inkurajon përdorimin e përmbajtjes digjitale që është e përshtatshme, cilësore dhe e përshtatur, që është e qasshme kudo, për të përmbushur nevojat e personelit dhe studentëve kudo dhe kurdo që ndodhë mësimdhënia dhe mësimnxënja.	
Personeli dhe studentët janë krijuesit e përmbajtjes	Organizata inkurajon dhe mbështet personelin dhe studentët që të jenë krijuesit dhe pranuesit e përmbajtjes digjitale specifike për lëndën dhe asaj ndër-kurrikulare , për përdorim në fushat formale dhe informale të kurrikulës.
Depot e përmbajtjes përdoren gjerësisht dhe në mënyrë efektive	Personeli dhe studentët zhvillojnë aftësitë e tyre në identifikimin dhe përdorimin e depove të përmbajtjes relevante për programet e tyre të studimit dhe shtimin e vlerës së komunitetit në këto depo përmes shënimeve dhe komenteve pjesëmarrëse .
Pronësia intelektuale dhe të drejtat e autorit respektohen	Organizata ka politika dhe procedura për të siguruar që palët të jenë të mirë-informuara për pronësinë intelektuale dhe rregullat e të drejtave të autorit gjatë gjetjes së burimeve, përdorimit të tyre, kombinimit ose krijimit të përmbajtjes digjitale.
Mjetet dhe përmbajtjet digjitale janë të licencuara siç kërkohet	Organizata ka politika dhe procedura lidhur me licencat për përmbajtjen (p.sh. e-librat, revistat), softuerët, aplikacionet, platformat dhe burimet e tjera arsimore të marra nga publikuesit/ofruesit komercial.
Burimet arsimore të hapura promovohen dhe përdoren	Organizata promovon në mënyrë aktive përdorimin/ripërzierjen/krijimin e Burimeve arsimore të hapura (OER) dhe licencimin e Creative Commons për të mbështetur kurrikula të modernizuara dhe për t'u ofruar studentëve mundësi për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre dhe për të arritur rezultatet e të nxënës.
Kurrikula ridizajnohet ose riinterpretohet për të reflektuar mundësitë pedagogjike që sjellin teknologjitë digjitale	
Kurrikula ridizajnohet në mënyrë të përsëritur (ose riinterpretohet sipas nevojës) në aspektin e përmbajtjes, qasjes pedagogjike dhe planeve për angazhimin e studentëve. Studentët mund të përfshihen si bashkëdizajnues të kurrikulës dhe janë shumë të angazhuar si nxënës të autodirigjuar.	
Mësimi i bazuar në lëndë riimagjinohet për të krijuar qasje më të integruara	Organizata mësimore ka procese për riimagjinimin dhe ridizajnimin e mësimi të bazuar në lëndë për të akomoduar qasje më të integruara (ndërdisiplinore dhe transdisiplinore) dhe për të ofruar mësim dhe vlerësim me studentin në qendër. Me mbështetjen e një qasjeje të tillë, teknologjitë e mësimi digjital lehtësojnë përzgjedhjen, krijimin dhe organizimin tematik të përmbajtjes së pasur multimodale që u mundëson studentëve të analizojnë dhe të kuptojnë idetë komplekse nga perspektiva të ndryshme.
Koha dhe vendi i mësimi riplanifikohen	Ofrohen orare fleksibile dhe të përshtatura për t'u dhënë personelit dhe studentëve më shumë mundësi për angazhim në mësim efektiv, duke përfshirë aktivitete individuale dhe grupe në kampus dhe jashtë tij (në shkollë dhe jashtë saj). Teknologjitë e mësimi digjital ofrojnë mundësi të reja për mësim kudo dhe menaxhim të përparuar të orarit.

Ofrimi në linjë është realitet	Organizata është e zotuar të zhvillojë dhe ofrojë kurse të tëra ose programe plotësisht në linjë , si mjete të hapjes së qasjes ndaj grupeve të reja më parë të papërfaqësuar të studentëve, duke ofruar në të njëjtën kohë fleksibilitet më të madh për grupet ekzistuese .
Mësimi në kontekste autentike promovohet	Novacioni në kurrikulë dhe dizajnimin e programit merr parasysh shfrytëzimin e potencialit të teknologjive të mësimit digjital për ta angazhuar personelin dhe studentët në kontekste autentike ku ata mund të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e tyre të mëparshme, shkathtësitë e kërkimit dhe të menduarit e pavarur. Duke bërë këtë, ata mund të adresojnë sfidat që shkojnë përtej njohurive tradicionale të lëndës, duke u kërkuar të demonstrojnë shkathtësi transversale, kompetenca kyçe dhe, në veçanti, kompetencë digjitale.
Ofrimi i mësimit digjital është i dukshëm në fushat e kurrikulës	Rishikimi periodik i kurrikulës bëhet në nivel të organizatës me synim integrimin dhe përdorimin në mënyrë efektive të teknologjive të mësimit digjital për të mbështetur mësimnxënien dhe mësimdhënien .
Kompetenca digjitale e studentëve zhvillohet në tërë kurrikulën	Kompetenca digjitale e studentëve vazhdimisht inkurajohet, zhvillohet dhe vlerësohet në mjedise të ndryshme të të nxënës dhe në tërë kurrikulën .

3.6 Elementi tematik: bashkëpunimi dhe rrjetëzimi

Organizata mbështet një kulturë bashkëpunimi dhe komunikimi dhe ka procese dhe politika që u mundësojnë personelit dhe studentëve të angazhohen me palët e brendshme dhe të jashtme, të ndajnë përvojat e tyre dhe të mësojnë në mënyrë efektive brenda dhe jashtë kufijve të organizatës.

Elementi tematik *Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi* ka nga tri nën-elemente dhe gjashtëmbëdhjetë përshkrues të paraqitur më poshtë.

Tabela 10: Nën-elementet dhe përshkruesit e Bashkëpunimit dhe rrjetëzimit

Rrjetëzimi, ndarja dhe bashkëpunimi promovohen	
Mësimi në epokën digjitale mbështetet në komunikimin shumëdimensional, rrjetëzim dhe ndarje të informacioneve me ekosistemin e brendshëm dhe të jashtëm të njohurive. Organizata ofron mjetet e nevojshme, infrastrukturën dhe sistemet e mbështetjes për të zhvilluar një kulturë të mësimi të lidhur që shtrihet përtej mureve institucionale dhe promovon llojin e mësimi në çdo kohë dhe kudo, të nevojshëm për zhvillimin e mjediseve digjitale të të nxëniti.	
Bashkëpunimi në rrjet i personelit për të marrë ekspertizë dhe për të ndarë përmbajtjet është normë	Organizata promovon në mënyrë aktive dhe pret që personeli të angazhohet me rrjete, portale dhe komunitete të praktikës profesionale/të bazuara në disiplinë që promovojnë ekselencë, cilësi dhe qasje në përmbajtje arsimore dhe njohuri për shfrytëzimin e teknologjive të mësimi digjital në kontekste të ndryshme. Përmes këtij angazhimi, personeli po ashtu mund të qaset dhe të kontribuojë në kërkime dhe ekosistem të të nxëniti më të gjerë dhe të bazuar në dëshmi.
Përpjekjet për këmbimin e njohurive vlerësohen	Aktivitetet e rrjetëzimit, bashkëpunimit dhe këmbimit të njohurive , përfshirë ato të ndërmjetësuar nga platformat në linjë, njihen si rezultate të të nxëniti relevante profesionale.
Studentët angazhohen në rrjetëzim efektiv	Studentët inkurajohet të angazhohen me rrjete relevante sociale/profesionale dhe komunitete të interesit/praktikës për t'u lidhur me ide, interesa dhe persona të tjerë. Teknologjitë digjitale dhe platformat sociale/profesionale të medieve përdorën në tërë organizatën për rrjetëzim efektiv, ndërveprim dhe bashkëpunim dhe për të krijuar një mjedis të të nxëniti më sfidues duke hapur dhe zgjeruar në këtë mënyrë perspektivat.
Pjesëmarrja në aktivitete dhe evente të këmbimit të njohurive promovohet	Organizata inkurajon, lehtëson dhe pret nga personeli dhe studentët që të organizojnë dhe/ose të marrin pjesë në aktivitete dhe ngjarje të këmbimit të njohurive (ballë për ballë, në linjë ose të kombinuara) për përhapjen e ndërsjellë të përvojave të të nxëniti me akterë në ekosistemin e jashtëm të njohurive.
Bashkëpunimi i brendshëm dhe këmbimi i njohurive priten	Organizata ka sisteme të krijuara, të mbështetura nga mjete dhe platforma digjitale relevante, për t'i bërë bashkë palët e brendshme të interesit (personelin dhe studentët), për të ndërtuar sinergji, për të shfrytëzuar njohuri dhe burime të brendshme dhe për të ndarë kërkime dhe praktika efektive përmes strukturave dhe ekipeve ndër-funksionale dhe ndërdisiplinore.
Përdoret një qasje strategjike e komunikimit	
Strategjitë e komunikimit të organizatës mbështeten nga një prani digjitale dinamike e karakterizuar me procese të hapura të komunikimit dhe ndarje të përvojave. Teknologjitë digjitale dhe platformat sociale/profesionale të medieve që sigurojnë komunikimin me palët e interesit dhe komunitetin e gjerë aplikohen dhe përdoren. Këto plotësojnë mjetet e tjera të komunikimit (p.sh. ballë-për-ballë) dhe mundësojnë komunikim të dyanshëm të sigurt dhe efektiv brenda organizatës dhe përtej saj.	
Ekziston një strategji e qartë e komunikimit	Organizata ka një strategji të qartë të komunikimit , që identifikon dhe përdor sisteme, kanale komunikimi të duhura për qëllime dhe grupe të synuara të ndryshme, duke përfshirë një sajt të uebit, media sociale dhe platformë të të nxëniti.

Një prani dinamike në linjë është e dukshme	Organizata ka një prani digjitale dinamike (sajte uebi, rrjete sociale) , që përditësohet rregullisht dhe përdoret nga të gjitha palët e interesit si qendër për mbështetjen dhe hapjen e bashkëpunimit, ndarjes, komunikimit dhe mësimit në linjë.
Zhvillohen partneritete	
Angazhimi dhe bashkëpunimi me ekosistemin e jashtëm të njohurive dhe palët e tij mund të hapë marrëdhënie të reja dhe të gjenerojë burime me vlerë në aspektin e mundësive për zhvillimin e ekspertizës dhe përvojave të të nxënit në tërë organizatën. Në këtë kontekst, organizata mësimore zhvillon dhe mban kontakte dhe zhvillon marrëdhënie me partnerë lokalë, rajonalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë të orientuar drejt punës bashkëpunuese dhe ndarjes së burimeve dhe ekspertizës, duke shfrytëzuar si rrjedhim potencialin e teknologjive të mësimit digjital.	
Një zotim për këmbim të njohurive përmes partneriteteve është i dukshëm	Organizata është e zotuar për bashkëpunim dhe këmbim të njohurive përmes partneriteteve me organizatat e tjera mësimore, organizatat e sektorit privat dhe publik (duke përfshirë ato në sektorët e teknologjisë/medieve digjitale) dhe komunitetin e gjerë.
Personeli dhe studentët stimulohen për t'u përfshirë në mënyrë aktive në partneritete	Organizata inkurajon dhe mbështet personelin dhe studentët për të marrë pjesë në mënyrë aktive në partneritete me organizatat e jashtme, të lehtësuara dhe mbështetura si duhet përmes përdorimit të mjeteve dhe platformave digjitale.

3.7 Elementi tematik: infrastruktura

Ky element i DigCompOrg i referohet rolit jetik të infrastrukturës në mundësimin dhe lehtësimin e praktikave novatore dhe në zgjerimin e kufijve të [hapësirave të të nxënës](#) (fizike dhe virtuale) në atë formë që të përfshijnë disa ose të gjitha dimensionet e shumëfishta të hapjes dhe fleksibilitetit (*çdo individ/grup që mëson kudo, në çdo kohë, duke përdorur cilëndo pajisje, me mentorimin e ofruar nga cilido*). Qasjet që përfshijnë tërë organizatën në dizajnimin, përshtatjen dhe/ose riorganizimin e hapësirave virtuale dhe fizike të të nxënës reflektojnë vizionin e organizatës për të modernizuar praktikën për arritjen e rezultateve më përfshirëse të të nxënës. Mbështetja e këtyre zhvillimeve është shtylla kryesore e shërbimeve digjitale, të cilat duhet të jenë të besueshme, të sigurta dhe të shkallëzuara.

Elementi tematik *Infrastruktura* ka nga dy nën-elemente dhe dymbëdhjetë përshkrues të paraqitur më poshtë.

Tabela 11: Nën-elementet dhe përshkruesit e Infrastrukturës

Hapësirat fizike dhe virtuale të të nxënës janë të dizajnuara për mësimin në epokën digjitale Mënyra me të cilën hapësirat e të nxënës fizik dhe virtual janë të dizajnuara mund të ofrojnë një mesazh pa fjalë për modelin dominues të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe mund të formësojë dhe ndikojë në praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies që përdoren. Si rrjedhim, organizata mësimore siguron që t'i kushtohet vëmendje e duhur dizajnit dhe organizimit të hapësirave të të nxënës që përdorimi i tyre të jetë në harmoni me aktivitetet e synuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies.	
Hapësirat fizike të të nxënës optimizojnë mundësitë e mësimin në epokën digjitale	Hapësirat fizike të të nxënës janë dizajnuar/ri-rregulluar dhe mobiluar për të shfrytëzuar dhe optimizuar mundësitë e teknologjive të mësimin digjital , duke dhënë qasje të një gamë e gjerë e mjeteve digjitale relevante, të përmbajtja dhe shërbimet në mjedise të të nxënës që mund të konfigurohen në mënyrë fleksibile .
Hapësirat virtuale të të nxënës optimizohen	Dizajnimi (ose përshtatja) i hapësirave virtuale të të nxënës (VLE-të dhe platformat mësimore) siç duhet reflekton modelin e synuar pedagogjik dhe mundëson një përvojë personeli/student që plotëson dhe është konsistente me atë që përjetohet në mjediset ballë për ballë. Hapësirat virtuale të të nxënës po ashtu janë të dizajnuara (ose përshtatura) për të optimizuar përdorimin, qasjen dhe përvojën e përdoruesit .
Infrastruktura digjitale planifikohet dhe menaxhohet Organizata ka ekspertizën dhe proceset e nevojshme për të siguruar identifikimin efektiv, përzgjedhjen dhe aplikimin në mbarë organizatën të një game të teknologjive të mësimin digjital të duhura për shkallën dhe nevojat e saj. Shërbimet e përparme duhet të operojnë në mënyrë të vazhdueshme sa i përket personelit dhe studentëve. Që kjo të ndodhë, shtylla bazë dhe shërbimet e TIK-ut (rrjetet, portalet, Wi-Fi, reja kompjuterike) duhet të jenë të pranishme kudo.	
Ekziston një Politikë e përdorimit të pranueshëm	Përdorimi i teknologjive, përmbajtjes, platformave dhe shërbimeve digjitale nga personeli dhe studentët është i rregulluar me një Politikë të përdorimit të pranueshëm të adoptuar zyrtarisht nga organizata dhe e cila u është komunikuar të gjithë përdoruesve.
Ekspertiza teknike dhe pedagogjike mbështet investimet në teknologji digjitale	Organizata ka qasje në ekspertizë pedagogjike dhe teknike (nga brenda dhe/ose jashtë) për të mbështetur planifikimin dhe vendimmarrjen për investime në teknologji, burime dhe shërbime .
Një gamë e teknologjive të mësimin digjital mbështet mësimin në çdo kohë/në çdo vend	Organizata ka një sërë teknologjish të mësimin digjital, mjete, aplikacione, përmbajtje dhe shërbime dhe ndërmerr hapat e duhur për të siguruar që ato të mund të qasen nga personeli dhe studentët në çdo vend/në çdo kohë (p.sh. në mjediset formale/informale dhe/ose një më një).
Qasjet Sill pajisjen tënde (SPT) mbështeten	Personeli dhe studentët mund të përdorin pajisjet e tyre dhe mund t'i lidhin këto me shërbimet e ofruara nga organizata . Një politikë SPT përcakton parametrat për përdorimin e pajisjeve vetanake.

Rreziqet lidhur me pabarazinë dhe përfshirjen digjitale adresohen	Me rritjen në numër të pajisjeve digjitale dhe lidhjes, organizata është e ndjeshme ndaj rrezikut të rëndimit të pabarazive të përjetuara nga studentët me kushte jo të mira socio-ekonomike , dhe merr hapa për të siguruar që të ketë masa speciale për të mbuluar nevojat e këtyre studentëve.
Mbështetja teknike dhe e përdoruesit është e dukshme	Mbështetja teknike dhe e përdoruesit është e planifikuar dhe e integruar në infrastrukturën digjitale për të siguruar performancë, mirëmbajtje dhe ndëroperim dhe për t'u ofruar studentëve dhe stafit qasje të vazhdueshme në teknologjitë, përmbytjen dhe shërbimet digjitale që kërkojnë. Një Marrëveshje e nivelit të shërbimit mund të përdoret për të përkufizuar fushëveprimin e shërbimeve dhe mbështetjes që mund të ofrohet (nga brenda ose nga ofruesit e shërbimit të jashtëm).
Teknologjitë ndihmëse adresojnë nevojat e veçanta	Teknologjitë ndihmëse dhe përmbytje digjitale të përshtatshme përdoren në tërë organizatën për të adresuar nevojat speciale të studentëve që kërkojnë mbështetje shtesë dhe të diferencuar për nxënie.
Masat për të mbrojtur privatësinë, konfidencialitetin dhe sigurinë janë të qarta	Organizata ka politika, procedura dhe masa mbrojtëse të duhura për të siguruar mbrojtjen e privatësisë individuale, konfidencialitetit dhe përdorimin e sigurt të teknologjive të mësimi digjital dhe të të dhënave . Këto përfshijnë obligimet ligjore që lidhen me Mbrojtjen e të dhënave dhe licencat, politikat për Analitikën e të nxënit dhe udhëzimet formale për personelin dhe studentët për privatësinë, konfidencialitetin dhe sigurinë në mjediset në linjë.
Planifikim efektiv i prokurimit është i dukshëm	Planifikimi i prokurimit merr parasysh kërkesat e përgjithshme dhe ato specifike (p.sh. ato specifike për disiplinën ose softuerët profesionalë ose stacionet e punës të specializuar/të nivelit të lartë) dhe bën aranzhimet e nevojshme, duke përfshirë, për shembull, fleksibilitetin përmes vizualizimit të desktopit. Vendimet për prokurimin e rrjeteve, pajisjeve dhe softuerëve mbështeten në <u>Modelin e kostos së tërë jetës</u> .
Ekziston një plan operacional për rrjetin bazë dhe shërbimet e TIK-ut	Organizata ka një plan operacional të zbatueshëm për prokurimin, mirëmbajtjen, ndëroperimin dhe sigurinë e rrjetit bazë dhe shërbimeve të TIK-ut të përshtatshme për shkallën dhe nevojat e saj.

4. Diskutim

Të shtatë elementet e shtjelluara të DigCompOrg aplikohen për organizatat arsimore nga të gjitha sektorët, pra shkollat fillore, të mesme dhe profesionale si dhe institucionet e arsimit të lartë, si universitetet, kolegjet universitare dhe shkollat politeknike. Megjithatë, ka dallime të konsiderueshme (jo më pak në aspektin e shkallës) në mes organizatave arsimore nga sektorët e ndryshëm arsimorë. Që DigCompOrg të operacionalizohet, elementet, nën-elementet dhe përshkruesit duhet të përshtaten që të përkojnë me veçantitë e sektorëve specifikë të arsimit. Me fjalë të tjera, **për secilin sektor të arsimit ka mundësi të ketë elemente shtesë** që duhet të merren parasysh e që janë unikë lidhur me atë se çfarë do të thotë të jesh një organizatë kompetente në sferën digjitale në atë sektor.

Për shembull, organizatat e arsimit të lartë kanë më shumë autonomi se shkollat dhe po ashtu kanë obligim për kërkime dhe novacion. Si rrjedhim, në këtë rast, një nën-element për kërkimin, zhvillimin, novacionin (KZhN) mund të shtohet në DigCompOrg; e njëjta vlen për bursat për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Shembuj të nën-elementeve që mund të shtohen përfshijnë:

- Kërkimi dhe novacioni pedagogjik përfshihen në strategjitë e KZhN-së: kërkimi, zhvillimi dhe novacioni lidhur me mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin është pjesë integrale e strategjisë së përgjithshme të organizatës për kërkime dhe/ose novacion.
- Mbështeten bursat për mësimdhënie dhe mësimnxënie²³: strategjia e organizatës mbështet në mënyrë aktive ofrimin e bursave për mësimdhënie dhe mësimnxënie brenda lëndëve/domeneve për të siguruar përditësimin e vazhdueshëm të praktikës profesionale të mësimdhënies.

Këto elemente shtesë mund të ndikojnë tek elementët e tjerë të DigCompOrg, meqë **gjithçka është e lidhur**. Për shembull, në rastin e organizatave të arsimit të lartë, investimet në infrastrukturën fizike dhe digjitale konsiderohet se përcaktohen nga një kombinim i kërkesave që përfshijnë kërkimin dhe novacionin përveç mësimdhënies/mësimnxënies. Po ashtu, teknologjitë digjitale mund të luajnë rol kyç në nxitjen e lidhjeve midis kërkimit brenda organizatës dhe ekosistemit të gjerë të njohurive përmes rrjetëzimit dhe partneriteteve.

Elementet, nën-elementet dhe përshkruesit e DigCompOrg në seksionet e mëparshme nuk janë të prezantuara sipas ndonjë hierarkie, sepse **të gjitha elementet janë të ndërlidhura**. Elementet ndër-sektoriale të kornizës DigCompOrg reflektojnë një konvergencë të temave gjerësisht të pranueshme në literaturë dhe mund të identifikohen po ashtu në një pjesë të madhe të kornizave dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit të analizuar, edhe pse ajo përmbajtje ose ato domene të aplikimit mund të ndryshojnë nga një kornizë në tjetrën. DigCompOrg shtrihet përtej një sinteze të mendimit dhe praktikës aktuale që lidhet me korniza/pyetësorë të vetë-vlerësimit për të ofruar **një bazë përfshirëse të mbështetur konceptualisht për operacionalizimin e vetë-reflektimit dhe vetë-vlerësimit brenda organizatave arsimore** që duan të zhvillojnë edhe më tej kapacitetin e tyre digjital.

Ekspertët dhe palët e interesit të përfshirë në DigCompOrg e shohin atë potencialisht si një mjet përfshirës dhe ndër-sektorial. Në tërësinë e saj, korniza DigCompOrg reflekton kompleksitetin e integritet të mësimin digjital në tërë organizatën. Organizatat arsimore, sidomos ato të shkallës më të vogël ose në një fazë të hershme të maturimit digjital, megjithatë, mund të vërejnë se një qasje rritëse mund të jetë e përshtatshme për nevojat e tyre. Me fjalë të tjera, ata mund të jenë të interesuara fillimisht të zhvillojnë disa por jo të gjithë elementet, nën-elementet dhe përshkruesit e DigCompOrg. Prandaj **organizatat arsimore, ndërmjetësit ose zhvilluesit e nismës mund të zgjedhin si opsion ta përdorin DigCompOrg në mënyrë fleksibile dhe ta përshtatin për nevojat dhe specifikat e tyre**. Natyra e përgjithshme e DigCompOrg lejon që ajo të ndahet në pjesë më të vogla dhe të përshtatet për rrethana ose nevoja të veçanta të zbatimit pa humbur ndërlidhjen e elementeve.

²³ Shih për shembull, <http://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/bitstream/JRC94955/jrc94955.pdf>

Për më tepër, një organizatë arsimore mund të **përdorë DigCompOrg në kombinim me kornizat dhe mjetet e tjera** për të plotësuar perspektivën organizative. Për shembull, një organizatë mund të përdorë edhe kornizën DIGCOMP (Ferrari, 2013) ose Kornizën e UNESCO-s për kompetencën digjitale për mësimdhënësit (UNESCO, 2011) për të zhvilluar kompetencën digjitale të personelit dhe studentëve.

DigCompOrg ka për synim të jetë përshkruese dhe jo normative. Për shembull, çështjet e të drejtave të autorit dhe sigurisë referohen si elemente të DigCompOrg por në mënyrë neutrale pa dhënë rregulla ose udhëzime të sakta. Nuk synohet të bëhen të qarta ose të përshkruhen përgjigjet që priten nga organizata arsimore dhe palët e saj të interesit. Nisma të caktuara veprimi kanë për fushëveprim përkufizimin e elementeve, nën-elementeve dhe përshkruesve të DigCompOrg në terma më përshkrues, nëse zgjedhin ta bëjnë këtë, në pajtim me specifikat dhe nevojat e tyre.

Një sfidë e veçantë që mund të pritet në zbatimin e mëtejshëm të këtij propozimi është që zhvillimet teknologjike po ndodhin shumë shpejt dhe është e vështirë të përshkruhet në mënyrë precize trajektorja për zhvillimin e teknologjive të mësimi digjital. Për shembull, deri pak kohë më parë, nuk njihej mundësia e përdorimit të analitikës ose medias sociale për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për këtë arsye, DigCompOrg do të duhet të përfshijë një proces për **rishikim që merr parasysh implikimet e zhvillimeve të reja teknologjike** dhe ndikimin e tyre të mundshëm në praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

DigCompOrg synon të fokusohet kryesisht në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim dhe aktivitete të ndërlidhura të mbështetjes së mësimi të ndërmarra nga një organizatë. Si e tillë, nuk ka për qëllim të adresojë gamën e plotë të sistemeve administrative dhe atyre të menaxhimit të informatave që përdoren nga organizata.

Për më tepër, DigCompOrg përfshin elemente si 'Praktikat e lidërshiptit dhe qeverisjes' dhe 'Infrastruktura' që mund të konsiderohen si përgjegjësi organizative. Elementet e tjera si 'Praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies' i referohen më shumë përgjegjësi individuale. Një gjë e tillë nuk është paradoks, një organizatë arsimore kompetente në sferën digjitale i duhet një kombinim i lidërshiptit dhe qeverisjes së fuqishme (për vizion dhe **strategji nga lart-poshtë**) dhe në të njëjtën kohë personeli dhe palët të interesit individualisht të afta për të marrë përgjegjësi për veprimet e inicuar vetë (**përpjekje dhe nisma nga poshtë-lart**). (Kampylis et al., 2013). Kjo qasje është e dukshme edhe në disa nga pyetësorët e vetë-vlerësimit të analizuar (p.sh. Speak Up NRS, eLEMER, HEInnovate), ku disa perspektiva për gjendjen në nivel të organizatës konsiderohen përmes inputeve të disa palëve të interesit dhe jo vetëm përmes liderëve të organizatës.

5. Vërejtjet përmbyllëse dhe puna në të ardhmen

DigCompOrg nuk është një temë e trajtuar *ab initio* – ajo është zhvilluar si një meta-kornizë përfshirëse që mund të përdoret si një:

- referim për të frymëzuar zhvillimin e mëtejshëm të kornizave dhe pyetësorëve ekzistues të vetë-vlerësimit;
- bazë për zhvillimin e kornizave të reja konceptuale specifike për sektor;
- bazë për zhvillimin e pyetësorëve të vetë-vlerësimit;
- mjet përmes të cilit politikëbërësit mund të promovojnë në mënyrë më efektive integrimin e teknologjive digjitale në sistemet e A&T.

DigCompOrg është një meta-kornizë konceptuale holistike që ofron një udhëzues referimi për nismat ekzistuese të kornizave/pyetësorëve të vetë-vlerësimit dhe një model për vetë-vlerësim nga organizatat arsimore për integrimin dhe përdorimin efektiv nga ana e tyre të teknologjive digjitale. DigCompOrg ka potencialin të mbështetë transparencën dhe krahasueshmërinë lidhur me nismat nëpër Evropë dhe, duke e bërë këtë, mund të luajë një rol në adresimin e fragmentimit dhe zhvillimit të pabarabartë midis Shteteve anëtare dhe brenda tyre.

DigCompOrg mund të përdoret po ashtu si një mjet i referimit për të krahasuar kornizat dhe nismat ekzistuese, për të parë se cilat elemente, nën-elemente dhe përshkrues janë marrë parasysh nga një kornizë ose pyetësor vetëvlerësimi ekzistues aktual. DigCompOrg mund të përshtatet dhe përdoret nga organizatat arsimore si mjet zhvillimi për integrimin progresiv të teknologjive të mësimi digjital për rezultate më të mira lidhur me lëndët akademike, shkathtësitë jokognitive dhe kompetencat kyçe. Për më tepër, mund të përdoret nga Shtetet anëtare për të përshtatur mbështetjen për organizatat arsimore që duan të zhvillojnë ose rritin kapacitetin e tyre digjital.

Korniza DigCompOrg e propozuar këtu është rezultat i një procesi të kërkimit me një metodë të përzier, por ajo mbetet një kornizë konceptuale, sepse nuk është pilotuar e as nuk është zbatuar ende në mjedise reale. Siç u diskutua, hap pasues në kontekstin e studimit InnovativEdu është zhvillimi i një pyetësi të vetë-vlerësimit bazuar në përshkruesit e DigCompOrg. Lista e përshkruesve të DigCompOrg është përfshirëse por jo shteruese. Synimi ishte të zhvilloheshin përshkrues që janë të aplikueshëm për të gjithë sektorët arsimorë që nga arsimi fillor tek ai terciar dhe që mund të operacionalizohen në aspektin e pyetjeve/deklaratave në pyetësin e vetë-vlerësimit. Janë marrë parasysh po ashtu edhe dëshmitë ose treguesit që do ta mbështetnin secilin përshkrues. Në kontekstin e një studimi përcjellës, pyetësi i propozuar i vetë-vlerësimit mund të përshtatet për nevojat e caktuara të një sektori arsimor specifik dhe mund të testohet në mjedise reale. Në këtë mënyrë, si korniza konceptuale (DigCompOrg) ashtu edhe pyetësi i vetë-vlerësimit i ndërlidhur mund të përshtaten dhe rafinohen sipas komenteve nga përdoruesit.

Si përfundim, ne dimë se teknologjitë digjitale po përfshihen në mënyra interesante dhe premtuese në të gjitha nivelet e sistemeve tona të arsimit dhe trajnimeve, arsimin fillor, të mesëm, pas atij të mesëm, profesional dhe të lartë. Për të konsoliduar progresin dhe për të siguruar arsim të shkallës dhe të qëndrueshëm, institucionet duhet të rishikojnë strategjitë e tyre organizative dhe të rritin kapacitetin e tyre për novacion dhe shfrytëzim të potencialit të teknologjive dhe përmbajtjeve digjitale të reja dhe në zhvillim. Siç thotë Kentaro Toyama ²⁴, "efekti parësor i teknologjisë është rritja e kapacitetit njerëzor, prandaj në arsim, teknologjitë rritin cilindo kapacitet pedagogjik që tashmë është në dispozicion aty". Kapaciteti digjital/pedagogjik i organizatave arsimore mund të zhvillohet ose të rritet me përdorimin e mjeteve si DigCompOrg i propozuar këtu, i cili do t'u lejojë atyre të reflektojnë për gjendjen e tyre të zhvillimit dhe kompetencës në përdorimin e teknologjive të mësimi digjital dhe të planifikojnë për përmirësime të mëtejme.

²⁴ <http://www.theatlantic.com/education/archive/2015/06/why-technology-alone-wont-fix-schools/394727/>

Referencat

- Bocconi, S., Kampylis, P., & Punie, Y. (2013). Innovating teaching and learning practices: Key elements for developing Creative Classrooms in Europe. *eLearning Papers, Special edition 2013*, 8-20.
- European Commission. (2013). Opening up Education: Innovative teaching and learning for all through new Technologies and Open Educational Resources [COM(2013) 654 final]. Qasur më 10 qershor 2015, nga http://ec.europa.eu/education/news/doc/openingcom_en.pdf
- European Commission. (2015). Draft 2015 Joint Report of the Council and the Commission on the implementation of the Strategic framework for European cooperation in education and training (ET2020) - New priorities for European cooperation in education and training, {SWD(2015) 161 final}. Qasur më 08 shtator 2015, nga <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2015/EN/1-2015-408-EN-F1-1.PDF>
- European Network of Education Councils. (2014). *Learning in the Digital Age - Report of the seminar of the European Network of Education Councils, Athens, 5-6 May 2014 with the support of the European Commission DG Education and Culture*. Brussels: European Network of Education Councils (EUNEC) Secretariat. Qasur më 12 qershor 2015, nga <http://www.eunec.eu/sites/www.eunec.eu/files/event/attachments/report.pdf>
- Ferrari, A. (2013). DIGCOMP: A Framework for Developing and Understanding Digital Competence in Europe. In Y. Punie & B. n. Brecko (Eds.): JRC-IPTS.
- Kampylis, P., Law, N., Punie, Y., Bocconi, S., Brecko, B., Han, S., . . . Miyake, N. (2013). ICT-enabled innovation for learning in Europe and Asia: Exploring conditions for sustainability, scalability and impact at system level. Qasur më 05 qershor 2015, nga Publications Office of the European Union EN 26199 <http://ipts.jrc.ec.europa.eu/publications/pub.cfm?id=6362>
- Kennisnet. (2013). Four in Balance Monitor 2013 - ICT in Dutch primary, secondary and vocational education. Zoetermeer, The Netherlands: Kennisnet Foundation. Qasur më 20 korrik 2015, nga http://archief.kennisnet.nl/fileadmin/contentelementen/kennisnet/Over.kennisnet/Vier_in_balans/Four_in_balance_2013_12.pdf
- Kampylis, P., Bocconi, S., & Punie, Y. (2012). Towards a mapping framework of ICT-enabled innovation for learning. Luxembourg: Publications Office of the European Union. EUR 25445 EN.
- UNESCO (2011). UNESCO ICT Competency Framework for Teachers. Qasur më 10 korrik 2015, nga <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002134/213475e.pdf>

Lista e shkurtesave dhe përkufizimet

Politika e përdorimit të pranueshëm	Një Politikë e përdorimit të pranueshëm (PPP) është një dokument që përshkruan një grup të rregullave që duhet të ndiqen nga përdoruesit ose klientët e një grupi të burimeve informatike, që mund të jetë një rrjet i kompjuterëve, sajt i uebit ose sistem me përmasa të mëdha. PPP-ja tregon qartë se çfarë lejohet dhe nuk lejohet të bëjë përdoruesi me këto burime. Burimi: https://www.techopedia.com/definition/2471/acceptable-use-policy-aup
Teknologjia ndihmëse	<i>Teknologjia ndihmëse</i> (TN) është një term i përgjithshëm që përdoret për t'iu referuar një grupi të pajisjeve softuerike ose haduerike me të cilat personat me aftësi të kufizuara mund të qasen në kompjuterë. Ato mund të jenë pajisje të zhvilluara dhe tregtuara në mënyrë specifike ose produkte komerciale që janë modifikuar. Teknologjia ndihmëse mund të përfshijë pajisje si tastiera dhe miu alternativ, softuerë me njohje të zërit, softuerë për zmadhimin e monitorit, <i>joystick</i> me disa ndërprerës dhe mjete ndihmëse komunikimi nga tekst në të folur. Burimi: http://www.webopedia.com
Mësimi autentik (mësimi në kontekste autentike)	Mësimi autentik zakonisht fokusohet në probleme komplekse të botës reale dhe zgjidhjen e tyre, duke përdorur ushtrime të lojës me role, aktivitete të bazuara në probleme, raste studimi dhe pjesëmarrje në komunitetet virtuale të praktikës. Burimi: Educause, https://net.educause.edu/ir/library/pdf/eli3009.pdf
Pika e referencës	Standard ose grup i standardeve të përdorura si pikë reference për vlerësimin e performancës ose nivelit të cilësisë. Pikat e referencës mund të formulohen nga përvoja e vetë organizatës ose nga përvoja e organizatave të tjera në të njëjtën fushë. Përshtatur nga www.businessdictionary.com
Sill pajisjen tënde (SPT)	SPT-ja reflekton një përgjigje pragmatike ndaj realitetit të sotëm kur studentët ka mundësi të kenë një ose më shumë pajisje të lidhura me internet në dispozicionin e tyre për përdorim ekskluziv nga ana e tyre (telefon i mençur, laptop, tablet). Duke ua lejuar studentëve të përdorin këto pajisje për qëllime studimi sa janë në shkollë (ose në institucionet e arsimit terciar), një regjim një me një (një pajisje për student) mund të arrihet pa qenë nevoja që organizata vetë të bëjnë investime të kushtueshme në pajisje të ngjashme.
Zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP)	ZHVP-ja është mjeti përmes të cilit pjesëtarët e profesioneve mbajnë, përmirësojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre dhe zhvillojnë cilësitë personale të nevojshme në jetën e tyre profesionale, zakonisht përmes një sërë programesh trajnimi të shkurta dhe të gjata, disa prej të cilave kanë opsionin e akreditimit. Ky edukim i vazhdueshëm që lidhet me punën dhe trajnimet përkatëse i referohet të gjitha aktiviteteve të edukimit dhe trajnimit sistematik ku marrin pjesë personat për të përfutur njohuri dhe/ose për të mësuar shkathtësi të reja për një punë aktuale ose të ardhshme. Përshtatur nga http://www.umultirank.org/#!/glossary?trackType=home&sightMode=undefined&section=undefined
Creative Commons	Creative Commons është një organizatë jofitimprurëse që mundëson ndarjen dhe përdorimin e kreativitetit dhe njohurive përmes mjeteve ligjore falas. Licencat e të drejtave të autorit të ofruara falas dhe të lehta përdorim ofrojnë një mënyrë të thjeshtë, të standardizuar për të dhënë lejen publike për të ndarë dhe për të përdorur punën krijuese të një individi — sipas kushteve që ata zgjedhin. Përshtatur nga http://creativecommons.org/about
Kurrikula	Aktivitetet e zbatuara për të dizajnuar, organizuar dhe planifikuar një veprim arsimit ose trajnimit, përfshirë përkufizimin e objektivave të të nxënësve, përmbajtjen, metodat (përfshirë vlerësimin) dhe materialet, si dhe organizimet për trajnimin e mësimeve dhe trajnerëve. Burimi: Cedefop http://www.cedefop.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/4106 Kurrikula, në kontekstin e DigCompOrg, i referohet po ashtu 'kurseve' ose 'programeve' të ofruara nga institucionet arsimore terciare ose organizatat për trajnime.

Plan i zbatimit të kapacitetit digjital	Disa i referohen këtyre planeve si 'Strategji e mësimi digjital', 'Strategjia e eMësimi' etj. Por mesazhi kryesor këtu është që (i) duhet të ketë një plan të tillë; dhe (ii) duhet të jetë e qartë se ku përkon ai në kontekstin e gjerë institucional.
Kompetenca digjitale	Kompetenca digjitale mund të përkufizohet si përdorimi me besim, kritik dhe kreativ i TIK-ut për të arritur qëllimet që lidhen me punën, punësimin, mësimin, argëtimin, përfshirjen dhe/ose pjesëmarrjen në shoqëri. Burimi: Korniza DigComp Framework http://ftp.jrc.es/EURdoc/JRC83167.pdf
Përmbajtja digjitale	Përmbajtja digjitale është një term 'përmbledhës' që përfshin <i>burimet</i> me tekst dhe ato audiovizuale (tani në format digjital) dhe median ndërvepruese (lojërat/aplikacionet celulare, simulimet, vizualizimet).
Përfshirja digjitale	I referohet angazhimit efektiv dhe të qëndrueshëm të një individi me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) në mënyra që lejojnë pjesëmarrjen e plotë në shoqëri në aspektin e mirëqenies ekonomike, sociale, kulturore, qytetare dhe personale. Një shoqëri përfshirëse në aspektin digjital është një shoqëri ku të gjithë individët, pavarësisht parapavisë së tyre socio-kulturore dhe socio-ekonomike, kanë mundësi të barabarta për t'u angazhuar me TIK-un në atë mënyrë që të ndalohet, ose edhe të zbrapsset, tendenca për rritje në pabarazinë shoqërore. Përshtatur nga përkufizimi i Ellen Helsper në punimin "Digital Inclusion in Europe: Evaluating Policy and Practice" [Përfshirja digjitale në Evropë: Vlerësimi i politikave dhe praktikës]. www.ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=11614&langId=en
Teknologjitë e mësimi digjital	I referohet gamës në zgjerim të pajisjeve të pavarura ose të mundësuar përmes internetit të përdorura nga mësimdhënësit dhe/ose studentët gjatë praktikave të tyre të përditshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe përfshin softuerët, platformat dhe shërbimet. Pajisjet përfshijnë kompjuterët, laptopët, tabletët, telefonat e mençur, kamerat, teknologjitë e përfshira në veshje (wearables), projektorët, tabelat inteligjente, printerët 2D, 3D, skanerët dhe pajisjet e tjera periferike. Softuerët përfshijnë aplikacione të përgjithshme, të specializuara dhe specifike për arsimin, lojëra, 'aplikacione' dhe mjete (të orientuara kah një detyrë e caktuar dhe për komunikim). Platformat përfshijnë VLE/LMS (Mjediset virtuale të të nxënësve/Sistemet e menaxhimit të mësimi), mediat sociale, portalet e uebit dhe depot e përmbajtjes. Shërbimet përfshijnë lidhjen me internet të brezit të gjerë, sigurinë (fjalëkalimet, privatësinë) dhe ruajtjen dhe menaxhimin e skedarëve. Sinonimet: Teknologjia arsimore, TIK dhe arsimi, Mësimi i përmirësuar me teknologjinë (TEL)
Mësimi në epokën digjitale	Mësimi në epokën digjitale (ose Mësimi për një epokë digjitale) njih faktin se, gati pa përjashtim, jeta, puna, studimi dhe argëtimi ndodhin sot për të gjithë qytetarët në një botë shumë të lidhur me internetin, të përhapur kudo dhe të ndërmjetësuar në mënyrë digjitale. Mësimi në dhe për këtë epokë digjitale paraqet një sfidë të re për mësimdhënësit dhe studentët e tyre.
Organizata arsimore kompetente në sferën digjitale	I referohet përdorimit efektiv të teknologjisë digjitale nga organizatat arsimore dhe personeli i tyre për të ofruar një përvojë interesante për studentët dhe për të arritur një kthim të mirë në investime në teknologjinë digjitale. Përshtatur nga nisma Jisc Digital Capability: https://www.jisc.ac.uk/rd/projects/building-digital-capability
Organizata arsimore	Termi ka disa kuptime sipas mjediseve në të cilat aplikohet dhe shpesh përdoret në vend të termit 'institucion arsimor' (p.sh. Komisioni Evropian, 2013b). Në kontekstin e studimit InnovativEdu, termi <i>organizatë arsimore</i> i referohet kryesisht shkollave fillore, të mesme dhe profesionale, si dhe institucioneve të arsimit të lartë si universiteteve, kolegjeve universitare dhe shkollave politknike.
Mësimi i bazuar në përvojë	Mësimi i bazuar në përvojë angazhon studentët në mendim kritik, zgjidhje të problemeve dhe vendimmarrje në kontekste që janë relevante personalisht për ta. Kjo qasje ndaj mësimi po ashtu përfshin krijimin e mundësive për sesione informative dhe për konsolidimin e ideve dhe shkathtësive përmes reagimeve, reflektimit dhe aplikimit të ideve dhe shkathtësive në situata të reja. Burimi: UNESCO http://www.unesco.org/education/tlsf/mods/theme_d/mod20.html

Mësimi formal, informal dhe joformal	<i>Formal</i> është mësimi që ndodh në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar (në një institucion arsimor, të trajnimit ose në vendin e punës) dhe shprehimisht përcaktohet si mësim (në aspektin e objektivave, kohës dhe burimeve). Mësimi formal është i qëllimshëm nga këndvështrimi i nxënësit. Zakonisht përfundon me validim dhe certifikim. <i>Informal</i> është mësimi që rezulton nga aktivitetet ditore lidhur me punën, familjen ose argëtimin. Nuk është i organizuar apo i strukturuar për sa i përket objektivave, kohës ose mbështetjes për mësim. Mësimi informal në shumicën e rasteve nuk ka ndonjë qëllim të caktuar nga perspektiva e nxënësit. Rezultatet e mësimi informal nuk përfundojnë zakonisht me certifikim, por mund të validohen dhe certifikohen në kuadër të njohjes së skemave të mëparshme të mësimi. Mësimi informal njihet po ashtu edhe si mësimi i bazuar në përvojë ose mësimi i rastit. <i>Joformal</i> është mësimi që përfshihet në aktivitete të planifikuara jo shprehimisht të caktuara si mësim (në aspektin e objektivave të mësimi, kohës së mësimi ose mbështetjes së mësimi). Mësimi joformal është i qëllimshëm nga këndvështrimi i nxënësit. Rezultatet e mësimi joformal mund të validohen dhe përfundojnë me certifikim. Mësimi joformal përshkruhet zakonisht si mësim gjysmë i strukturuar. Burimi: Cedefop http://www.cedefop.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/4106
Vlerësimi formativ	Vlerësimi formativ i referohet një sërë metodash të ndryshme që mësimdhënësit përdorin për të bërë vlerësimet në proces të të kuptuarit nga ana e studentëve, të nevojave të mësimi dhe progresit akademik gjatë një mësimi, njësie ose kursi. Qëllimi i përgjithshëm i vlerësimit formativ është mbledhja e informacioneve të detajuara që mund të përdoren për të përmirësuar udhëzimet dhe të nxënësit e studentit <i>gjatë kohës që mësimi ndodh</i>. Burimi: Fjalori i Reformës arsimore http://edglossary.org/formative-assessment/
Qeverisja	Ka të bëjë me strukturat, funksionet, proceset dhe traditat organizative që janë zbatuar për të siguruar që organizata të funksionojë për të arritur objektivat e saj në mënyrë efektive dhe transparente. Është korniza e llogaridhënies ndaj përdoruesve, palëve të interesit dhe komunitetit. Përshtatur nga Banka Botërore: http://siteresources.worldbank.org/EXTGLOREGPAPROG/Resources/q_rpp_sourcebook_chap12.pdf
TIK	Shih: teknologjitë digjitale
Mësimi informal	Shih: Mësimi formal, informal dhe joformal
Novacioni, novacioni në arsim	Novacioni përfshin ndryshimet e bëra në diçka ekzistuese, sidomos duke prezantuar metoda, ide ose produkte të reja. Burimi: Fjalori i Oxford
Integrimi dhe përdorimi efektiv i teknologjive të mësimi digjital	Termi <i>integrim</i> përdoret për të përshkruar përdorimin e teknologjive të mësimi digjital në një mënyrë 'të natyrshme' dhe të gjithëpërfshirë brenda organizatës dhe përtej kufijve të saj për arritjen e misionit dhe vizionit të saj bazë për një arsim cilësor. Termi <i>efektiv</i> i referohet prodhimit të efekteve të planifikuara, dëshiruara ose vendimtare nga përdorimi i teknologjive të mësimi digjital, për shembull, aftësia për të përcaktuar dhe për të arritur më shumë rezultate gjithëpërfshirëse të të nxënësit që përndryshe do të ishte më e vështirë të arriheshin ose nuk do të arriheshin fare pa teknologjitë në fjalë (shih edhe rezultatet e të nxënësit më poshtë).
Analitika e të nxënësit	Analitika e të nxënësit është matja, mbledhja, analiza dhe raportimi i të dhënave për nxënësit dhe kontekstet e tyre, me qëllim të kuptimit dhe optimizimit të mësimi dhe mjediseve ku mësimi ndodh. Burimi: Përkufizimi i përdorur në Konferencën e parë ndërkombëtare për Analitikën e të nxënësit. http://edutechwiki.unige.ch/en/Learning_analytics
Rezultatet e të nxënësit	Rezultatet e të nxënësit përkufizohen si njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat që personat kanë përvetësuar si rezultat i të nxënësit dhe mund t'i demonstrojnë nëse është e nevojshme në një proces të njohjes. EQF-ja përkufizon rezultatet e të nxënësit si deklaratatë të asaj që nxënësi di, kupton dhe mund të bëjë pas përfundimit të një procesi të mësimi.

	(Komisioni Evropian, 2006). http://www.eucen.eu/sites/default/files/OECD_RNFIFL2010_Werquin.pdf Termi 'gjithëpërfshirës' përdoret për të theksuar se teknologjitë digjitale kanë potencialin të zgjerojnë rezultatet e të nxënësve – pra, jo vetëm t'i bëjnë ato ekzistuese më efikase ose efektive. Prandaj, 'teknologjitë digjitale' krijojnë mundësi të reja për të shtuar përtej atyre ekzistuese – si rrjedhim, janë më 'gjithëpërfshirëse'.
Hapësirat e të nxënësve	Kuptimi nga ana jonë i hapësirave të të nxënësve është zgjeruar konsiderueshëm në vitet e fundit. Studentët gjithnjë e më shumë po përdorin teknologji digjitale të ndërlidhura, dhe këtë e bëjnë brenda dhe jashtë klasave tradicionale, studiove, punëtorive, laboratorëve ose bibliotekave. Konsiderimi i hapësirave të të nxënësve mbulon mjediset konkrete dhe mjediset në linjë ku studentët tani studiojnë dhe teorinë e mësimit dhe ato pedagogjike që mbështesin një diversitet të praktikave. Përshtatur nga Educause: http://www.educause.edu/research-and-publications/books/educating-net-generation/learning-spaces
Menaxhimi	Ka të bëjë me operimet e përditshme brenda kontekstit të strategjive, politikave, proceseve dhe procedurave që janë vendosur nga organi qeverisës. Ndërsa qeverisja ka të bëjë me "të bësh gjënë e duhur", menaxhimi ka të bëjë me "të bësh gjërat siç duhet". Përshtatur nga Banka Botërore: http://siteresources.worldbank.org/EXTGLOREGPARGPROG/Resources/rpp_sourcebook_chap12.pdf
Misioni	Një deklaratë e misionit përcakton gjendjen ose qëllimin e tanishëm të organizatës dhe i përgjigjet tri pyetjeve se pse një organizatë ekziston: ÇFARË bën ajo; për KË e bën; dhe SI e bën atë të bën. Burimi: Psychology Today. Vision and mision – What's the difference and why does it matter? [Vizioni dhe misioni - Cili është dallim dhe pse ka rëndësi?] https://www.psychologytoday.com/blog/smartwork/201004/vision-and-mission-whats-the-difference-and-why-does-it-matter
Mësimi joformal	Shih: Mësimi formal, informal dhe joformal
Open Badges	Open Badges lejon individët që të verifikojnë shkathtësitë, interesat dhe arritjet e tyre përmes organizatave kredibile. Sistemi bazohet në një standard të hapur dhe individët mund të kombinojnë disa stema (badges) nga emetues të ndryshëm për të treguar historinë e plotë të arritjeve të tyre - si në linjë edhe jashtë saj. Përshtatur nga: http://openbadges.org
Arsimi i hapur	Termi 'Arsim i hapur' ka disa interpretime. Hapja mund t'i referohet qasjes së gjerë në mundësi arsimore dhe burime arsimore (në veçanti për grupet e nënpërfaqësuar, të pafavorizuara ose të marginalizuara). Fleksibiliteti i shtuar në aspektin e kohës, vendit dhe ritmit të studimit po ashtu është karakteristikë përcaktuese e hapjes, e harmonizuar me ambicie për të ofruar një kurrikulë dhe opsione studimi më të personalizuar/individualizuara, arsim në linjë dhe/ose më shumë mbështetje për mësim të personalizuar/të hapur/të përshtatur për studentët përmes përdorimit të analitikës së të nxënësve).
Burimet arsimore të hapura	Burimet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit në cilindo medium, digjital apo tjetër, që janë në domenin publik dhe janë publikuar me një licencë të hapur që lejon qasje pa pagesë, përdorim, përshtatje dhe rishpërndarje nga të tjerët pa kufizime apo me kufizime të limituara. Burimi: përkufizimi i UNESCO-s http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/access-to-knowledge/open-educational-resources/what-are-open-educational-resources-oers/
Hapja e arsimit	Komunikatë e Komisionit Evropian që prezanton një politikë për "stimulimin e mënyrave cilësore, novatore të mësimnxënies dhe mësimdhënies përmes teknologjive të reja dhe përmbajtjes digjitale". http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52013DC0654&from=EN

Vlerësimi midis studentëve (peer assessment)	Ky vlerësim u lejon instruktorëve që të ndajnë vlerësimin e detyrave me studentët e tyre. Bazohet në teoritë e mësimiit aktiv (Piaget, '71), mësimiit për të rritur (Cross, '81) dhe konstruksionizmit social (Vygotsky, '62). Burimi: Qendra Universitare Cornell për Ekselencë në mësimdhënie http://www.cte.cornell.edu/
Treguesit e performancës	Treguesit e performancës i referohet mjeteve përmes së cilave një objektiv mund të gjykohej nëse është arritur apo jo. Treguesit pralidhen me qëllimet dhe objektivat dhe shërbejnë si 'matës' për shkallën e suksesit në arritjen e qëllimit. Treguesit e performancës janë mjete sasiore dhe zakonisht shprehen si normë, raport ose përqindje. Burimi: EQAVET, http://www.eqavet.eu
Vetë-vlerësimi	<i>Vetë-vlerësimi</i> përfshin aftësinë për të gjykuar realisht performancën personale. Përkrahësit e vetë-vlerësimit sugjerojnë shumë përparësi, përfshirë ato në vijim: • Ofron reagim në kohë dhe efektiv dhe mundëson një vlerësim të shpejtë të nxënës të studentit. • U lejon instruktorëve që të kuptojnë dhe të ofrojnë një reagim të shpejtë për të nxënës. • Promovon integritetin akademik përmes vetë-raportimit të studentit për progresin e të nxënës. • Promovon shkathtësitë e praktikës reflektive dhe vetë-monitorimit. • Zhvillon mësimin e vetë-dirigjuar. • Rrit motivimin e studentit. • Përmirëson kënaqësinë e marrjes pjesë në një mjedis mësimi bashkëpunues. • U ndihmon studentëve që të zhvillojnë një sërë shkathtësish personale, të transferueshme për të përmbytur pritshmëritë e punëdhënësve të ardhshëm. Burimi: Qendra Universitare Cornell për Ekselencë në mësimdhënie http://www.cte.cornell.edu/
Pyetësi i vetë-vlerësimit	Në kontekstin e studimit InnovativEdu, termi pyetësor i vetë-vlerësimit i referohet një grupi të pyetjeve kyçe të aplikueshme për organizata arsimore nga sektorë të ndryshëm që duan të rishikojnë dhe të planifikojnë në mënyrë strategjike drejt integritetit dhe përdorimit efektiv të teknologjive digjitale.
Personeli	I referohet personelit në të gjitha kategoritë, të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në arsimin formal. Pozitat e punës përfshijnë 'mësimdhënës', 'mësues privat', 'akademik', 'ligjërues', 'trupë pedagogjike', 'trajner', 'mentor', 'këshillues' dhe role mbështetëse si 'bibliotekar', 'mbështetëse për TIK', 'mbështetëse për eMësimin' dhe pozitat në role menaxhimi/lidershipi, 'drejtorë shkollash', 'rektorë'.
Plani strategjik	Planifikimi strategjik është aktivitet menaxhimi i organizatës që përdoret për të caktuar prioritetet, për të fokusuar energjinë dhe burimet, për të forcuar operacionet, për të siguruar që punonjësit dhe palët e tjera të interesit janë duke punuar në drejtim të qëllimeve të përbashkëta, për të arritur marrëveshje rreth rezultateve të synuara dhe për të vlerësuar dhe rregulluar drejtimin e organizatës në një mjedis në ndryshim. Një <i>plan strategjik</i> është një dokument që përdoret për të komunikuar me organizatën qëllimet e organizatës, veprimet e nevojshme për të arritur ato qëllime dhe të gjitha elementet e tjera kritike gjatë planifikimit. Burimi: Instituti Balanced Scorecard http://balancedscorecard.org
Studentët	U referohet personave të çfarëdo moshe që janë të angazhuar në një proces arsimor <i>formal</i> (kurs ose program). Studentët shpesh quhen edhe 'nxënës', ndonëse ky term është potencialisht më i gjerë, sepse mund t'i referohet mësimiit formal dhe joformal.
Vlerësimi sumativ	Vlerësimet sumative përdoren për të vlerësuar të nxënës të studentëve, përvetësimin e shkathtësive dhe arritjen akademike në fund të një periudhe të caktuar të udhëzimeve, zakonisht në fund të projektit, njësisë, kursit, semestrit, programit ose vitit shkollor. Rezultatet e vlerësimit sumativ shpesh regjistrohen si pikë ose nota dhe më pas reflektohen në regjistrin akademik të përhershëm të studentit.

Mësimdhënësi	Burimi: Fjalori i Reformës arsimore http://edglossary.org/summative-assessment/ Termi i përgjithshëm 'mësimdhënësi' synohet për të mbuluar të gjithë sektorët arsimorë. Sektorët, pa përfshirë shkollat fillore dhe të mesme, mund ta identifikojnë këtë rol si 'instruktor', 'ligjërues' ose profesor.
Vizioni	Vizioni përcakton gjendjen optimale të dëshiruar në të ardhmen – një imazh mendor i asaj që organizata dëshiron të arrijë me kohë; ofron udhëzime dhe frymëzim lidhur me atë që organizata fokusohet të arrijë pas pesë, dhjetë ose më shumë viteve. Burimi: Psychology Today. Vision and mision – Whats the difference and why does it matter? [Vizioni dhe misioni - Cili është dallim dhe pse ka rëndësi?] https://www.psychologytoday.com/blog/smartwork/201004/vision-and-mission-whats-the-difference-and-why-does-it-matter
Modeli i kostos së tërë jetës	Referohet edhe si <i>modeli i kostos së ciklit të jetës</i> ose një <i>modeli i kostos totale të pronësisë</i> . Lidhur me investimet në TIK, këto modele marrin parasysh të gjitha shpenzimet që kërkohen për atë kohë sa njësia e caktuar e pajisjes është në shërbim, duke përfshirë kostot e mirëmbajtjes dhe kostot e licencave bazë.

Lista e figurave

Figura 1: Metodologjia e përgjithshme për zhvillimin e DigCompOrg	8
Figura 2: Skema ndërlidhëse	10
Figura 3: Elementet kyçe dhe nën-elementet e DigCompOrg	18

Lista e tabelave

Tabela 1: Përmbledhje e kornizave dhe pyetësorëve të vetë-vlerësimit të analizuar	10
Tabela 2: Struktura e inventarit	11
Tabela 3: Fokusi, karakteristikat dhe mësimet e nxjerra nga analiza e detajuar.....	14
Tabela 4: Përmbledhje e DigCompOrg.....	18
Tabela 5: Nën-elementet dhe përshkruesit e Praktikave të lidërshpit dhe qeverisjes...	21
Tabela 6: Nën-elementet dhe përshkruesit e Praktikave të mësimdhënies dhe mësimnxënies	23
Tabela 7: Nën-elementet dhe përshkruesit e Zhvillimit profesional	25
Tabela 8: Nën-elementet dhe përshkruesit e Praktikave të vlerësimit	26
Tabela 9: Nën-elementet dhe përshkruesit e Përmbajtjes dhe kurikulës.....	28
Tabela 10: Nën-elementet dhe përshkruesit e Bashkëpunimit dhe rrjetëzimit	30
Tabela 11: Nën-elementet dhe përshkruesit e Infrastrukturës	32

Shtojca 1: Ekspertët që kontribuuan në zhvillimin e DigCompOrg

Emri	Mbiemri	Ekspertiza	Përfshirë në
Igor	Balaban	Universiteti i Zagrebit, Fakulteti për Organizim dhe Informatikë	ePOBMM
Anja	Balanskat	European Schoolnet	FCMM
Helen	Beetham	Konsulente për arsimin e lartë	Jisc
Stefania	Bocconi	Këshilli Kombëtar për Kërkime në Itali, Instituti për Teknologji në Arsim	SCALE CCR
Alessandro	Brolpito	Fondacioni Evropian për Trajnime	
Sarah	Davies	Jisc	Jisc
Georgi	Dimitrov	DG EAC	HEInnovate
Anastasia	Ekonomou	Instituti për Arsim Qipro	Ae-MoYS
Bruno	Emans	Konsulent	Vensters
Seán	Gallagher	PDST technology in education	e-Learning Roadmap
Marianna	Halonen	Microsoft në arsim	Microsoft SRT
Marta	Hunya	Instituti për Kërkime dhe Zhvillim në Arsim Hungari	eLEMER
Jan	Hylen	Konsulent	LIKA
Anne	McMorrough	Profesoreshtë në arsim, Instituti i Marino-s për arsim, Irlandë	SCALE CCR
Carlos Javier	Medina Bravo	Ministria e Arsimit në Spanjë, Njësia e Teknologjive në Arsim	
Maartje	Meuwissen	Schoolinfo	Vensters
Serge	Ravet	ADPIOS	ePOBMM
Gabriel	Rubio Navarro	Universiteti publik i Navarrës (UPNA), Spanjë	
Danijela	Scepanovic	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit teknologjik në Serbi	
Hanne	Shapiro	Instituti Teknologjik në Danimarkë	
Morten	Søby	Qendra për TIK në Arsim në Norvegji	School Mentor
Jarmo	Viteli	Universiteti i Tampere, Finlandë	Opeka

Shtojca 2: Matrica e analizës së detajuar

Drafti i 1-rë i DigCompOrg	Kurrikula dhe përmbajtja	Vlerësimi dhe ndikimi	Praktikat e të nxënit	Praktikat e mësimdhënies dhe zhvillimi profesional	Lidershipi dhe planifikimi strategjik	Hapja dhe rrjetëzimi	Infrastruktur a teknologjike dhe fizike	Të tjera / Specifike për sektor
Drafti përfundimtar i DigCompOrg	Përmbajtja dhe kurrikula	Praktikat e vlerësimit	Praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies		Praktikat e lidërshiptit dhe qeverisjes	Komunikimi dhe rrjetëzimi	Infrastruktura	Specifike për sektor
SCALE CCR	Përmbajtja dhe kurrikula	Vlerësimi	Praktikat e të nxënit	Praktikat e mësimdhënies	Lidershipi dhe vlerat e organizatës	Lidhshmëria	Infrastruktura	
HEInnovate		Matja e ndikimit	Zhvillimi i ndërmarrësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	Zhvillimi i ndërmarrësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	Kapaciteti organizativ, personat dhe stimujt, lidërshiptit dhe qeverisja	IAL-të ndërmarrësore si një institucion i internacionalizuar ; marrëdhëniet biznesore/të jashtme për këmbimin e njohurive		Mënyra për ndërmarrësit
Jisc					Arkitektura e ndërmarrjes Lidërshiptit strategjik Qeverisja e TIK	Komunikimet dhe angazhimi; Shërbimet e ndara	Shërbimet e TIK-ut	
ePOBMM	Dizajnimi i kurrikulës (në mësimnxënie)	Vlerësimi; ePortfoliot	Të nxënit; personat – nxënës	Personat - personeli mësimdhënës			Teknologjitë; ePortfoliot-teknologjitë; Teknologjia Open Badges (tbd)	Open Badges

FCMM	Burimet arsimore (Teknologjia mbështetëse); Rezultatet arsimore (Objektivat e të nxënit)	Menaxhimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimit	Proceset arsimore (Pedagogjia; Roli i nxënësit);	Ndërtimi i kapaciteteve – Proceset arsimore (Pedagogjia; Roli i nxënësit);	eMaturia organizative Menaxhimi i mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit	Bashkëpunimi mësimdhënës-student	Mjetet dhe burimet	
Microsoft SRT		Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi	Mësimdhënia, Mësimnxënia dhe Vlerësimi	Ndërtimi i kapaciteteve Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi	Lidershipi dhe kultura e inovacionit Lidershipi dhe kultura e inovacionit	Punëtoria 5 – ndarja e ideve	Mjedisi i të nxënit	
eLEMER			Nxënësit dhe të nxënit	Mësimdhënësit dhe mësimdhënia	Menaxhimi		Infrastruktura	
Opeka				Shkathtësitë e TIK-ut	Kultura e mësimin digjital		Pajisjet dhe softuerët	
School mentor				Praktika pedagogjike, kompetenca digjitale	Organizimi; Administrata dhe kushtet e kornizës; Ndërlidhja dhe planifikimi	(në organizatë: komunikimi dhe komunikimi i jashtëm)	Burimet e shkollës	
LIKA			Përdorimi (Administrata; mësimdhënësi pedagogjike; studenti)	Përdorimi (Administrata; mësimdhënësi pedagogjike; studenti); (Personeli i shkollës digjitale) Kompetencat	Lidershipi: vizioni dhe puna strategjike, organizata, procedurat dhe udhëzimet, TI-ja udhëheqëse, buxheti, Monitorimi		Infrastruktura	Ndikimi
Ae-MoYS	TIK-u në kurrikulë			Zhvillimi profesional	Kultura e TIK-ut në shkollë Lidershipi dhe vizioni		Burimet dhe infrastruktura	

<u>e-Learning Roadmap</u>	TIK-u në kurrikulë			Zhvillimi profesional	Kultura e e-Mësimi Lidershipi dhe Planifikimi		Infrastruktura e TIK-ut	
<u>NAACE SRF</u>	Përdorimi I TIK-ut në kurrikulë	Vlerësimi i kapacitetit digjital	Mësimdhënia dhe Mësimnxënia	Zhvillimi profesional Mësimdhënia dhe mësimnxënia	Lidershipi dhe Menaxhmenti		Burimet	(fillimisht edhe: Zgjerimi i mundësive për nxënie; Ndikimi në rezultatet e të nxënit
<u>Speak Up NRP</u>	Përmbajtja digjitale	Vlerësimi në linjë		Mësimnxënia në linjë/ zhvillimi profesional	Planifikimi strategjik	Media sociale	Qëndrimi dhe përdorimi i teknologjisë Qasja në internet	Mësimnxënia përmes celularit; shkathtësitë e shekullit 21/eksplorimi i karrierës

Shtojca 3: Faktet e strukturuar të kornizës/pyetësorëve të vetë-vlerësimit të analizuar

Microsoft Innovative Schools Toolkit and Self-reflection tool (Paketa e mjeteve e Microsoft për shkollat novatore dhe mjeti i vetë-reflektimit) Informacionet e ofruara nga Marianna Halonen	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e kornizës?	Microsoft Innovative Schools Toolkit http://www.is-toolkit.com
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Microsoft Corporation, Mark Sparvell
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Microsoft
Cili është historiku? A ka kornizë pararendëse? A ka pyetësor/mjet në linjë të ndërlidhur?	Mbështetja e shkollave në procesin e menaxhimit të ndryshimit
Cilat janë datat e fillimit dhe përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	2009 deri më sot
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	
Cila është tema e saj (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër; përmendni sektorët arsimorë të mbuluar etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikatat pedagogjike; tjetër)?	Fokusi në procesin e menaxhimit të ndryshimit dhe integrimin e TIK-ut në arsim
Pse është zhvilluar korniza? Kush pritet ta përdorë dhe si? A ka mbështetje apo relevancë për politikatat?	Drejtorët e shkollave dhe mësimmshënësit në procesin e transformimit të arsimit
Cilat janë fushat/dimensionet kyçe të kornizës? Cilat janë nënfushat (nëse ka)?	Fushat kyçe të kornizës • Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi • Liderhipi dhe kultura e inovacionit • Ndërtimi i kapaciteteve • Mjedisi i të nxënësve
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	http://pilnetwork.blob.core.windows.net/public/Creating%20Innovative%20Schools.pdf

Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	Mjet i vetë-reflektimit http://www.is-toolkit.com/selfreflection/index.php?id=1
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Microsoft Corporation, Mark Sparvell
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e tij?	Microsoft
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka mjet pararendës?	Mjet i menaxhimit strategjik për të krijuar një vizion për transformimin e arsimit
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	2010
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Në linjë
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm /tjetër etj.)? Cili është fokusi (p.sh.	Mjet i vetë-reflektimit. Fokusi është në mësimin në shekullin 21 dhe integrimin e TIK-ut në arsim

integrimit i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikat pedagogjike; tjetër)?	
Kush e plotëson pyetësin dhe kur?	Drejtorët e shkollave një herë në vit
Sa pyetje ka në tërë pyetësin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasosh rezultatet e tua me ato të mëhershmet?	Jo
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësi/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	Ata që i plotësojnë pyetësit
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	-
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për organizatat arsimore/individët për plotësimin ose mosplotësimin e këtij pyetësi/mjeti në linjë?	-
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore/veprim (rajonale/kombëtare/evropiane)?	Jo
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme (K12)
A ka një proces për përditësimin e pyetësit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	Jo
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Innovative Teaching and Learning Research www.itlresearch.com
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	Partners in Learning School Research www.pilsr.com

Future Classroom Maturity Model (Modeli i maturimit të klasave të së ardhmes) Informacionet e ofruara nga Anja Balanskat	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e kornizës?	Future Classroom Maturity Model
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	European Schoolnet, kontakti [varet se kush i kërkon dhe ku publikohen këto informacione]
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Zhvillimi: EUN, Futurelab MB (tani përfshirë në Fondacionin Kombëtar për Kërkime në Arsim), financuar nga DG CONNECT. Zbatimi: MeA në projektin iTEC, SMART, Promethean
Cili është historiku? A ka kornizë pararendëse? A ka pyetësor/mjet në linjë të ndërlidhur?	Ka origjinën në modelin e maturimit Becta të zhvilluar në vitet 90-ta nga Universiteti i Nottingham, shih http://fcl.eun.org/documents/10180/14691/2.4+-+Maturity+Model+Background.pdf/6c708c00-29c6-4b6f-8ace-221dce95f5e7 Gjithashtu kemi komisionuar një raport në iTEC për skema të ngjashme në mbarë botën, p.sh. Norvegji, NAACE ICT Mark.
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	Filloi në 2010, përfundoi zyrtarisht në gusht 2014, por u mbajt nga EUN si pjesë e Klasave të së ardhmes.
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Dokumentet e iTEC, p.sh. plani i shfrytëzimit; dokumentet paraprijëse http://fcl.eun.org/documents/10180/14691/2.4+-+Maturity+Model+Background.pdf/6c708c00-29c6-4b6f-8ace-221dce95f5e7 Udhëzues referimi: http://fcl.eun.org/documents/10180/14691/2.2+FCMM+reference+guide.pdf/5fe0addb-3934-436c-aba3-8693bf90a95a?version=1.0 FCMM është në linjë në http://fcl.eun.org/toolkit brenda paketës së mjeteve për Klasat e së ardhmes. Qasja direkte: http://fcl.eun.org/toolset2 . Kërkohet regjistrimi për përdorimin e formularëve në linjë.
Cila është tema e saj (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër; përmendni sektorët arsimorë të mbuluar etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikat pedagogjike; tjetër)?	Një mjet falas i vetë-rishikimit që u mundëson shkollave fillore dhe të mesme dhe mësimdhënësve të tyre që të vlerësojnë nivelin e tyre të maturimit lidhur me atë se sa efektiv ka qenë përdorimi i TIK-ut për mbështetjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fokusi i saj është në novacion, ndryshime, pedagogji, teknologji mbështetëse, zhvillim profesional dhe institucional.
Pse është zhvilluar korniza? Kush pritet ta përdorë dhe si? A ka ndonjë mbështetje nga politika apo relevancë për politikën?	Është zhvilluar si mjet për të ndihmuar shkollat që të matin nivelin e tyre të novacionit me teknologji dhe për të krijuar dhe zbatuar skenarë të nxëniet në të ardhmen që bazohen në pikat e tyre të forta dhe të dobëta, dhe tendencat kontekstuale, mundësitë dhe sfidat. Paketa e mjeteve është për shkollat (dhe palët e tyre të interesit) dhe mësimdhënësit individualë dhe është në gjuhën angleze. Mbështetet nga 13 ministri të arsimit në projektin iTEC dhe është zhvilluar me miratimin e të 30-tave në rrjetin European Schoolnet. Mbështetja e tyre bazohet në përdorimin e dëshmuar të saj për mbështetjen e novacionit dhe reformave dhe ndryshimeve në shkolla.
Cilat janë fushat/dimensionet kyçe të kornizës? Cilat janë nënfushat (nëse ka)?	Ka pesë faza progresive, niveli 1 deri në 5 (1: Këmbimi 2: Pasurimi 3: Zgjerimi 4: Shtrirja 5: Fuqizimi). Ndërsa një shkollë lëviz nga një fazë në tjetrën, matura e shkollës, në aftësinë e saj për të qenë novatore në mësimnxënien dhe mësimnxënien e mbështetur me anë të teknologjisë, rritet. Skenarët e Klasave të së ardhmes përdoren për të krijuar një vizion të mësimdhënies dhe mësimnxënies që e çon shkollën drejt niveleve më të larta të maturimit të Klasave të së ardhmes. Pikë fillim për procesin e zhvillimit të skenarit është vetë-vlerësimi i përdorimit aktual të TIK-ut nga ana e shkollës

	dhe pozita e saj në modelin e maturimit. Ka dy mënyra për të përdorur modelin e maturimit qoftë si një ushtrim i vetë-rishikimit në një shkollë ose gjatë një punëtorie të skenarit të Klasave të së ardhmes. Qëllimi kryesor është identifikimi i veprimeve që shkolla duhet të ndërmarrë për të rritur nivelin e saj të maturimit të Klasave të së ardhmes. Pyetjet mbulojnë pesë fusha, të quajtura dimensione, lidhur me mësimnxënien dhe mësimdhënien (rolli i nxënësve, roli i mësimdhënësit, objektivat e të nxënësve dhe vlerësimi, kapaciteti i shkollës për të mbështetur novacionin, mjetet dhe burimet). Pasi të përfundohet, mjeti jep një indikacion për nivelin e maturimit në përgjithësi dhe për secilin dimension. Kjo krahasohet me mesatare kombëtare dhe ndërkombëtare. Më e rëndësishmja është se gjenerohet një raport diagnostikues që identifikon se çfarë duhet të përfshihet në një Skenar të Klasave të së ardhmes për ta ndihmuar shkollën që të kalojë në nivelin vijues të maturimit.
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	FCMM është OER, Creative Commons.

Planning and implementing e-learning in your school (Planifikimi dhe zbatimi i e-mësimit në shkollën tuaj) Informacionet e ofruara nga Seán Gallagher	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e kornizës?	Planning and implementing e-learning in your school - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	PDST technology in education (ish NCTE), Seán Gallagher, Madeleine Murray
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e tij?	Departamenti për Arsimit dhe Shkollësi (Irlandë) dhe shërbimet mbështetëse të ndërlidhura
Cili është historiku? A ka kornizë pararendëse? A ka pyetësor/mjet në linjë të ndërlidhur?	DES publikoi një strategji të TIK-ut për shkollat në vitin 2008 dhe të gjitha shkollat pritej të kishin një plan të e-Mësimit për integrimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie. U hartua manuali i e-Mësimit për të mbështetur shkollat në këtë drejtim. Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit në Irlandë janë të angazhuar në planifikimin e zhvillimit të shkollës. Përndryshe lëndë të dedikuara për Shkencën kompjuterike në kurrikulën e shkollave fillore ose në planprogramet pas fillores, ishte e nevojshme që të konsiderohej integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie në procesin e planifikimit të zhvillimit të shkollës. Udhëzuesi i e-Mësimit (e-Learning Roadmap) është një mjet planifikimi shoqëruar i dizajnuar për të ndihmuar shkollat që të identifikojnë se ku janë aktualisht lidhur me e-Mësimin dhe se kur duan që të arrijnë. - Shih më shumë në: http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Roadmap/#sthash.6gfygTK2.dpuf
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	Publikuar në vitin 2009, manuali i e-Mësimit do të rishikohet së bashku me Strategjinë digjitale për shkollat (2015-2020) që u lancua në Irlandë më 7 tetor 2015. Një nga rezultatet e Strategjisë digjitale është rishikimi i manualit dhe udhëzuesit të e-Mësimit për të shqyrtuar teknologjitë e reja dhe harmonizimin me prioritetet kombëtare për vetë-vlerësim, njohuri të shkrimit-leximit, numrave për shkollat.
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Ka dokumente të ndërlidhura për të gjitha fazat vijuese të procesit të planifikimit: Prezantohet procesi i planifikimit - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/Introduction.pdf Shkolla kryen një auditim për të filluar procesin e planifikimit - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/Getting-Started.pdf Formulohen prioritetet - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/Step-1-Review-Prioritise.pdf Zhvillohet plani - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/Step-2-Develop-plan.pdf Pastaj zbatohet dhe monitorohet - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/Step-3-Implement-and-monitor-plan.pdf Plani vlerësohet - http://www.pdsttechnologyineducation.ie/en/Planning/e-Learning-Handbook/Step-4-Evaluate-plan.pdf
Cila është tema e saj (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër; përmendni sektorët arsimorë të mbuluar etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikatat pedagogjike; tjetër)?	PDST technology in education në Manualin e e-Mësimit të Arsimit paraqet procesin e planifikimit për e-Mësimin në një shkollë dhe është zhvilluar në konsultim me nismat e planifikimit për zhvillimin e shkollës në nivel fillor dhe post-fillor (PPDS & SDPI/SLSS). Ofron një udhëzues hap pas hapi për zhvillimin e

	planit të e-Mësimit të shkollës dhe paraqet rolet dhe përgjegjësitë kryesore të gjitha palëve të përfshira në zhvillimin e planit
Pse është zhvilluar korniza? Kush pritet ta përdorë dhe si? A ka mbështetje apo relevancë për politikën?	Drejtorët e shkollave dhe mësime dhënësit koordinatore të TIK-ut pritet të jenë përdoruesit kryesorë.
Cilat janë fushat/dimensionet kyçe të kornizës? Cilat janë nënfushat (nëse ka)?	Fushat kyçe të kornizës: Lidershipi dhe planifikimi TIK-u dhe kurrikula Zhvillimi profesional Kultura e e-Mësimit Infrastruktura e TIK-ut
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	

Matrica e maturimit e ePortfolios dhe Open Badges (The ePortfolios & Open Badges Maturity Matrix) Informacionet e ofruara nga Serge Ravet dhe Igor Balaban	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e kornizës?	The ePortfolios & Open Badges Maturity Matrix http://bit.ly/mmpdf – pdf për shkarkim http://bit.ly/mmmdoc – GoogleDoc i hapur për komente
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Europortfolio është organizata drejtuese dhe personat e kontaktit janë Serge Ravet, serge.ravet@iosf.org / Igor Balaban, igor.balaban@foi.hr
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Autori kryesor është Serge Ravet me kontribute nga Helen Barrett, partnerët e nismës së Europortfolio (Lourdes Guàrdia; Marcelo Maina; Elena Barberà, Ivan Alsina, Birgit Wolf, Peter Baumgartner, Igor Balaban) dhe anëtarët e komunitetit të Europortfolio. Nuk ka ende zbatim ndonjëse një mjet ndërveprues i bazuar në matricë është duke u zhvilluar.
Cili është historiku? A ka kornizë pararendëse? A ka pyetësor/mjet në linjë të ndërlidhur?	Matrica e maturimit frymëzohet nga puna e bërë në Becta për e-maturimin, Korniza e vetë-rishikimit dhe Shenja TIK (Self Review Framework and ICT Mark (2006)) të transferuara tash te NAACE (rishikuar në vitin 2014), një matricë maturimi e mëparshme e ePortfolios e zhvilluar nga EIFEL (2007) dhe projekti australian i ePortfolios, nisma australiane e ePortfolios, paketa australiane e mjeteve për ePortfolio (2008) dhe puna nga Jisc, SURF. Seti i plotë i publikimeve do të publikohet në versionin final të matricës.
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	Jemi ende në versionin alfa. Puna ka filluar në mesin e vitit 2013. Versioni i parë i një mjeti në linjë për vetë-vlerësim duhet të jetë i gatshëm në vitin 2015.
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Ende jo
Cila është tema e saj (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër; përmendni sektorët arsimorë të mbuluar etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikatat pedagogjike; tjetër)?	Objektivi i matricës është t'i ndihmojë organizatat me integrimin e ePortfolios dhe Open Badges si mjete për transformimin e praktikave arsimore. Një pjesë e matricës nuk ka ndonjë referim direkt të ePortfoliot ose Stemat (Badges), por te elementet mbështetëse që lidhen me praktikatat pedagogjike dhe integrimin e TIK-ut.
Pse është zhvilluar korniza? Kush pritet ta përdorë dhe si? A ka ndonjë mbështetje apo relevancë për politikatat?	Korniza do të jetë baza e një mjeti të përdorur nga organizatat ose komunitetet për vetë-rishikim, rishikim bashkëpunues ose 360°. Mund të përdoret po ashtu për të planifikuar zhvillimin e mëtejshëm dhe për të matur progresin e arritur në lidhje me ato plane. Fokusi është në organizatat ose komunitetet, jo individët. Një kornizë e kompetencës do të adresojë individët.
Cilat janë fushat/dimensionet kyçe të kornizës? Cilat janë nënfushat (nëse ka)?	Fushat kryesore janë: Mësimi (pedagogjia), Teknologjia, ePortfoliot dhe Stemat e hapura (Open Badges).

Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?

Matrica e maturimit është një përpjekje për të treguar natyrën komplekse të mësimit në lidhje me:


- > dy kontekste: formal dhe informal;
- > tri hapësira: hapësirat e të nxënit, punuese dhe sociale;
- > katër komponentë: të nxënit, teknologjitë dhe kombinimi i tyre në ePortfolio dhe Open Badges; dhe
- > Pesë nivele të maturimit: të vetëdijshme, në proces eksplorimi, në proces zhvillimi, të integruara, transformative.


Objektivi i matricës nuk është të jetë normative, por të angazhojë organizatat për të reflektuar për praktikën e tyre. Duhet të kuptohet si një skicë nga e cila mund të dizajnohen matrica të përshtatura që i përgjigjen një konteksti të caktuar të një organizate ose komuniteti.

eLEMER Informacionet e ofruara nga Marta Hunya	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	eLEMER http://ikt.ofi.hu/ Versioni i kufizuar në anglisht: http://ikt.ofi.hu/english/
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Oktatáskutató és Fejlesztő Intézet / Instituti për Kërkime dhe Zhvillim në Arsim i Hungarisë – PhD Marta Hunya
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Njëjtë si më sipër
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka mjet pararendës?	Mjet për vetë-vlerësim formativ për shkollat (), që shërben gjithashtu si një mjet për monitorim në nivel vendi
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	Zhvillimi: 2010-11, zbatimi: 2011-14
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Bazë të dhënash në linjë
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm /tjetër? etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikat pedagogjike; tjetër)?	Mjet vetë-vlerësimi në nivel vendi për arsimin publik nga mosha 6 vjeç (klasa 1) deri në 19 vjeç (klasa 13). Fokusi: integrimi i TIK-ut me perspektivë për tërë shkollën, katër fusha: përdorimi në mësimnxënien, mësimdhënien; organizim dhe infrastrukturë.
Kush e plotëson pyetësin dhe kur?	Dy mënyra: 1) të dhënat e dakorduara paraprakisht plotësohen nga një person i vetëm. Ka mjete për mbledhjen e informacioneve nga mësimdhënësit dhe studentët; ose ata mund të caktojnë një komitet, ose në një takim të personelit ata mund të dakordohen dhe të plotësojnë pyetësin. 2) Metoda e mësipërme + përdorimi i pyetësorëve individualë në linjë (mësimdhënësit dhe nxënësit nga mosha 10). Këto të dhëna shfaqen automatikisht në formularin e vlerësimit si provë për vlerën e zgjedhur. Minimumi 2/3 e mësimdhënësve dhe 50% e nxënësve sugjerohet të përgjigjen. Të dhënat mund të dorëzohen dhe mbishkruhen në çdo moment. Në muajin shkurt çdo vit realizohet një fushatë dhe një foto çasti bëhet në fund të shkurtit.
Sa pyetje ka në tërë pyetësin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	100, të gjitha, 0-4, ku 0 nënkupton që nuk është e aplikueshme
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasoni rezultatet tuaja me ato të mëhershmet?	Po, po – për 3 vite
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësi/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	Shkolla ka qasjen e vet unike në të dhënat e tyre. Mund t'i printojnë ashtu që të mund t'i përdorin për qëllime zhvillimi, por edhe si bazë për planin ose strategjinë e tyre të zhvillimit të TIK-ut. Mjeti tregon ku qëndron shkolla në krahasim me mesataren e vendit. Hulamtuesit që janë të përfshirë kanë qasje në të gjitha të dhënat.
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	700 shkolla përgjigjen çdo vit. Gjysma e tyre kthehen çdo vit. Janë diku rreth 5800 shkolla në Hungari.
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për organizatat arsimore/individët për plotësimin ose mosplotësimin e këtij pyetësi/mjeti në linjë?	Jo, por jemi duke planifikuar.
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë	Jo

me ndonjë politikë arsimore/veprim (rajonale/kombëtare/evropiane)?	
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	100% sa i përket arsimit publik (me përjashtim të kopshteve).
A ka një proces për përditësimin e pyetësorit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	Po, çdo dy vjet
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Raporti vjetor gjithmonë publikohet në linjë në prill dhe maj, dhe publikimet e tjera, ligjëratat e konferencave çdo dy vite. Kishte 2 paraqitje në konferencat ndërkombëtare.
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	Do të donim të prezantonim titullin "shkolla novatore" si rimishërim i shkollave novatore të EUN-së, por nuk ka shumë kohë, energji dhe para, kryesisht nuk ka shumë vëmendje të politikave për realizimin me sukses.

Assessing the e-Maturity of your School (Vlerësimi i e-Maturimit të shkollës sate) Informacionet e ofruara nga Anastasia Economou	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	Assessing the e-Maturity of your School http://e-mature.ea.gr
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Pyetësori administrohet në kuadër të projektit Open Discovery Space, që bashkëfinancohet nga Komisioni Evropian me programin CIP-ICT PSP- 2011-5, Tema 2: përmbajtja digjitale, Objektivi 2.4: objektivi i eMësimi 2.4 Personat e kontaktit: Thanasis Hadzilacos, Open University Qipro
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e tij?	Partnerët e projektit Open Discovery Space (organizuar nga Ellinogermaniki Agogi në Greqi)
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka mjet pararendës?	Ky pyetësor bazohet në Mjetin e vetë-vlerësimit të zhvilluar si pjesë e Çmimit të shkollave digjitale, një nismë e NCTE Irlandë në bashkëpunim me IPPN, INTO dhe CESI (www.digitalschools.ie)
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të tij?	2011-2015
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Bazë të dhënash në linjë
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm/tjetër? etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikat pedagogjike; tjetër)?	Mjeti përbëhet nga një pyetësor që përdoret për qëllime kërkimi brenda kornizës së projektit "Open Discovery Space" dhe i adresohet personelit të shkollave nga shkollat nëpër Evropë, që ata të ilustrojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta në lidhje me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Termi TIK përdoret në këtë anketë për t'iu referuar përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në arsim në përgjithësi. Është menduar pra si një term ombrellë për të përfshirë të gjitha llojet e TIK-ut me theks në aplikacionet e e-Mësimi për mësimnxënie dhe mësimnxënie. Pyetësori është një mjet i vetë-vlerësimit dhe mbulon 5 fusha: 1. Lidershipi dhe vizioni Një shkollë mund të shfaqë dëshmi të: një politike të TIK-ut për tërë shkollën që paraqet një vizion dhe strategji dhe përcjell një qasje pozitive për përdorimin e TIK-ut në shkollën. Politika adreson lidhjen e kurrikulës, planifikimin për qasje të strukturuar të TIK-ut për të gjithë dhe siguri në internet. 2. TIK-u në kurrikulë Një shkollë mund të shfaqë dëshmi të: integritit të TIK-ut në kurrikulë në mësimnxënie dhe mësimdhënie dhe personeli e kupton se si TIK-u mund të përdoret në kurrikulë për të përmirësuar të nxënit e studentëve. 3. Kultura e TIK-ut në shkollë Një shkollë mund të demonstrojë: vetëdijësimin që TIK-u ka ndikim në cilësinë e mësimnxënies dhe mësimdhënies, qëndrimet dhe sjelljen e nxënësve dhe komunitetin e shkollës. 4. Zhvillimi profesional Një shkollë mund të demonstrojë: zotim për zhvillim të vazhdueshëm profesional në lidhje me TIK-un. 5. Burimet dhe infrastruktura

	Një shkollë mund të demonstrojë: përdorimin e burimeve të duhura të TIK-ut për të mbështetur mjedise të caktuara të të nxëniet dhe ka përdorur burimet e duhura të TIK-ut që reflektojnë planin për përmirësim në të të ardhmen dhe zhvillim të TIK-ut siç parashihet në politikën për shkollën. Secila shkollë mund të shikojë përmblendhjen e rezultateve për secilën kategori dhe të përdorë këto të dhëna për të zhvilluar një plan veprimi për shkollën. Plani i veprimit bazohet në një pyetësor tjetër në linjë që dorëzohet në sistem për të krijuar profilin e shkollës për portalin ODS (http://portal.opendiscoveryspace.eu/schools). 
Kush e plotëson pyetësorin dhe kur?	Mësimdhënësit që marrin pjesë në ODS si koordinatorë të shkollës duhet të kalojnë nëpër të gjitha pyetjet në secilën kategori, duke treguar se në çfarë mase shkolla e tyre i përmbushë kriteret. Për t'u përgjigjur sa më saktë që të jetë e mundur, është e këshillueshme të konsultohet Drejtori i shkollës, kolegët e tjerë dhe të dhënat në dispozicion të shkollës që mund të ndihmojnë për të ilustruar përdorimin e TIK-ut në shkollën e tyre. Para se t'u përgjigjen pyetjeve, nga ta kërkohet që të shkruajnë detajet e tyre (emrin e shkollës dhe një adresë emaili të kontaktit) që ekipi i ODS-së të mund t'i kontaktojë. Një grafik gjenerohet duke ilustruar performancën e shkollës në secilën kategori. Të gjitha informacionet mbesin konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime kërkimi.
Sa pyetje ka në tërë pyetësorin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	5 fusha me gjithsej 30 pyetje. Të gjitha janë të detyrueshme. 1. Liderhipi dhe vizioni 6 pyetje (shkalla po/jo) 2. TIK-u në kurrikulë 6 pyetje (shkalla 1-4 (pajtohem-nuk pajtohem, përqindjet)) 3. Kultura e TIK-ut në shkollë 8 pyetje (shkalla 1-4 (pajtohem-nuk pajtohem, përqindjet)) 4. Zhvillimi profesional 5 pyetje (shkalla 1-4 (pajtohem-nuk pajtohem, përqindjet)) 5. Burimet dhe infrastruktura 5 pyetje (shkalla po/jo)
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasoni rezultatet tuaja me ato të mëhershmet?	Rezultatet mund të ruhet dhe të qasen në çdo kohë. Rezultatet përditësohen në mënyrë automatike (nuk ka shënime të hyrjeve të mëparshme)
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësori/mjeti në linjë të krahasosh	Pyetësori i vetë-vlerësimit: të gjithë përdoruesit kanë qasje në rezultatet e tyre për mjetin e vetë-vlerësimit. Nuk ka qasje në rezultatet e tjera.

organizatën tënde/veten me të tjerët?	Pyetësi i Planit të veprimit: të gjithë përdoruesit kanë qasje në rezultatet e tyre për pyetësin e Planit të veprimit. Ka qasje për të parë edhe rezultatet e shkollave të tjera (edhe t'i redaktosh! – defekt në kod?) Në të njëjtën kohë këto informacione ndahen në portalin ODS tek profilet e shkollave (http://portal.opendiscovery.space.eu/schools).
	 The screenshot shows a 'Pilot school data sheet' for Kolossi Primary School 'Apostolos Loukas' in Cyprus. It includes school details like ID (CY003), website, email, and address. It also lists participating teachers (Maria Louisa Raoula, Ioanna Christopoulou, Paraskevi Symeon, Eleftheria Giagali) and participating students (150). A table shows scores for Leadership & Vision (100/100), ICT in the Curriculum (100/100), and ICT School Culture (100/100).
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	Ka 114 dorëzime për planin e veprimit të shkollës. Nuk ka shënime për dorëzimet e pyetësit të e-Maturimit.
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për organizatat mësimore/individët nëse plotësojnë ose jo pyetësin/mjetin në linjë?	Profili në komunitetin e shkollave të portalit ODS
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore/veprim (rajonale/kombëtare/evropiane)?	Projekti Open Discovery Space, që bashkëfinancohet nga Komisioni Evropian me programin CIP-ICT PSP-2011-5, Tema 2: përmbytja digjitale, objektivi 2.4: objektivi i eMësimi 2.4
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	Deri në fund të projektit në vitin 2015 në Qipro pritet që të marrin pjesë rreth 100 shkolla ndërsa nga e gjithë Evropa do të marrin pjesë 2000 shkolla
A ka një proces për përditësimin e pyetësit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	Nuk përshkruhet ndonjë proces i tillë
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Në portalin ODS tek pjesa <i>dokumentacioni</i> ka publikime, dokumente të dorëzuara, prezantime dhe materiale të tjera për shpërndarje që i referohen në përgjithësi ODS-së (jo në mënyrë specifike pyetësit të e-Maturimit)
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	

Jisc Strategic ICT Toolkit (Paketa e mjeteve për TIK strategjik) Informacionet e ofruara nga Sarah Davies	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	Jisc Strategic ICT Toolkit http://www.jisc.ac.uk http://www.jiscinfonet.ac.uk/tools/strategic-ict-toolkit/
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Jisc, Myles Danson
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Ekipi drejtues i përbërë nga Jisc, Fondacioni i Leadershipit për Arsimin e Lartë ²⁵ (LFHE) dhe Universiteti i Nottingham. Testime më të gjera në terren; Kolegji i qytetit të Glasgow, Universiteti Coventry, Kolegji Deeside, Universiteti Liverpool John Moores, Universiteti i Loughborough, Universiteti Manchester Metropolitan, Universiteti i Lancashire Qendror, Kolegji Universitar Falmouth, Universiteti i Gloucestershire, Universiteti i York
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka kornizë pararendëse?	Në vitin 2008, Jisc dhe LFHE identifikuan një mundësi për të ndihmuar institucionet e arsimit të lartë për përdorimin e tyre strategjik të TIK-ut. Në atë kohë kishte mospajtime midis liderëve të biznesit që rezultonin në integrim nënoptimal të TIK-ut në strategjitë e biznesit, zbatimin e tyre dhe përfitimet rezultuese nga investimi në TIK. Një ekip nga Universiteti i Nottingham mori përsipër të zhvillojë një paketë të mjeteve të vetë-analizës për të ndihmuar institucionet e arsimit të lartë që të analizojnë, vlerësojnë dhe zhvillojnë përdorimin strategjik nga ta të teknologjive informative. Përdorimi i TIK-ut konsiderohet i rëndësishëm për mbështetjen dhe ofrimin e biznesit bazë, megjithatë, një raport i Jisc/i komisionuar ²⁶ tregoi se institucionet e arsimit të lartë dallojnë gjerësisht në maturimin e përdorimit strategjik të TIK-ut. Jisc dhe LFHE morën përsipër këtë paketë të mjeteve për të mbështetur CIO-të, drejtorët e IS-së dhe udhëheqësit e lartë në arsimin e lartë për zhvillimin e zbatimit të TIK-ut të orientuar në mënyrë më strategjike. Projekti u bazua në përvojën, të dhënat dhe praktikatat ekzistuese të një mostre përfaqësuese të institucioneve të arsimit të lartë për zhvillimin e një pakete të mjeteve të vetë-analizës për ta stimuluar këtë mënyrë të kuptuarit dhe për të mbështetur zhvillimin institucional.
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të tij?	2010-2011
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Ka dy versione të mjetit të vetë-vlerësimit, të zhvilluara në MS Excel për të lejuar redaktimin institucional të frazeologjisë. Ka po ashtu një prani të uebit për të ndihmuar me zbatimin dhe analizën që përfshin: - Një bazë të informacioneve që ofron vetëdijesim për faktorët që ndikojnë në përdorimin strategjik të TIK-ut nga ana e një institucioni dhe si përfundim, vlerën që përfitohet nga aplikimi i tij. Kemi identifikuar këto fusha si 'mundësues' të TIK-ut strategjik - Një grup të rasteve studimore nga institucionet në sektorin e arsimit të lartë me modele të maturimit operacional, strategjik dhe transformacional. Ato ilustrojnë kontekstet e ndryshme të përcaktuara nga institucionet ku TIK-u ofron mbështetje operacionale, strategjike ose transformacionale. Universiteti i Nottingham, që realizoi këtë projekt, bëri kërkime, në fillim të vitit 2010, me 20 institucione të sektorin e arsimit të lartë

²⁵ <http://www.lfhe.ac.uk>

²⁶ http://jisc.ac.uk/media/documents/programmes/ios/lfhe_finalreport.pdf

	në MB Vetë mjetet e vetë-analizës në të dy perspektivat e maturimit institucional dhe prirja e një individi për TIK strategjik, e quajtur 'Njohuritë e strategjisë TIK në nivel individual'
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm /tjetër? etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikatat pedagogjike; tjetër)?	Mjet i vetë-vlerësimit për të krahasuar aftësitë institucionale (organizative) dhe individuale (menaxherët e lartë për biznes dhe TI) në disa 'mundësues të biznesit të teknologjisë strategjike'. Rezultatet ofrojnë të dhëna për pikat e forta dhe të dobëta, të cilat kur shqyrtohen me prioritet strategjike institucionale mundësojnë që të merren veprime për përmirësimin e çështjeve.
Kush e plotëson pyetësin dhe kur?	Udhëheqësit e biznesit dhe udhëheqësit e TIK-ut shpesh përmes grupimeve ekzistuese; anëtarët e ekipeve të menaxhmentit të lartë të institucioneve, të gjithë vendimmarrësit e lartë me përgjegjësi lokale për përdorimin strategjik të TIK-ut brenda fakulteteve të tyre, shkollave, departamenteve ose ekipeve dhe ekipi i menaxhmentit të lartë të TIK-ut.
Sa pyetje ka në tërë pyetësin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	Mjet institucional; Lideri strategjik (12P), Shërbimet e TIK (11P), Qeverisja e TIK (18P), Komunikimet dhe angazhimi (8P), Shërbimet e ndara (7P), Arkitektura e ndërmarrjes (13P). Mjet individual; Lideri i lartë strategjik (44P), Shefi i departamentit (40P), CIO (40P), Eksperti i lartë i TI-së (48P)
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasoni rezultatet tuaja me ato të mëhershmet?	Po, është në Excel
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësi/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	Jo automatikisht, por manualisht po
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	E vështirë të thuhet, është zhvilluar dhe lëshuar në sajte pilot, të gjithë ata që kanë deklaruar se synonin një ushtrim vjetor bazuar në mjete. Ata ishin të përfshirë në kurset LFHE (thuhet se 80% e liderëve të lartë të arsimit të lartë në MB kanë marrë pjesë në kurse) kështu që numri mund të ndryshojë
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për organizatat mësimore/ individët nëse plotësojnë ose jo pyetësin/mjetin në linjë?	Asnjë
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore (rajonale/kombëtare/evropiane)?	Ndoshta, por nuk është zhvilluar si reagim ndaj tyre
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	Nuk zhvillohet më në mënyrë aktive
A ka një proces për përditësimin e pyetësit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	Nuk zhvillohet më në mënyrë aktive
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Jo për aq sa dimë
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	

School Mentor (Mentor shkollor) Informacionet e ofruara nga Morten Søby	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	School Mentor http://www.skolementor.no/index.php/en/
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Qendra për TIK në Arsimit në Norvegji
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e tij?	Zhvilluesi: Qendra për TIK në Arsimit në Norvegji së bashku me drejtorët e shkollave dhe ekspertët. Palët e interesit: komunat, qarqet
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka mjet pararendës?	Njohuritë digjitale përcaktohen si shkathtësi bazë në kurrikulën kombëtare. Për shkak se kurrikula kombëtare konsiderohet si direktivë ligjore, ajo është politika e TIK-ut më e rëndësishme për shkollat. Kurrikula e promovimit të njohurive përcakton qëllimet e përgjithshme dhe specifike në secilën lëndë dhe për secilën fazë kyçe. Fazat kyçe janë të përcaktuara pas vitit të dytë, të katërt, të shtatë dhe të dhjetë/trembëdhjetë. Drejtoria për Arsimit dhe Trajnime në Norvegji ka zhvilluar një kornizë për pesë shkathtësitë bazë: verbale, të leximit, të shkrimit, digjitale dhe të numrave.
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	Në çdo kohë
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Në linjë. School Mentor është një mjet vetë-vlerësimi me bazë në ueb, që mbështet menaxherët e shkollave në punën e tyre me kompetencën digjitale. Përdorimi i School Mentor ndihmon që të fuqizohen planet dhe strategjitë e zhvillimit të shkollës për përmbushjen e kërkesave për kompetencë digjitale. Është zhvilluar me synim sigurimin që investimet e shkollave në TIK, në aspektin e pajisjeve dhe ngritjes së nivelit të kompetencës digjitale të personelit, të kryhen në kontekstin e qëllimeve realiste. School Mentor është një burim për reflektime dhe zhvillim të shkollës që ka për qëllim të mbështetë punën e administratorëve të shkollave për zhvillimin e kompetencës digjitale. School Mentor është i disponueshëm falas dhe është zhvilluar nga Qendra për TIK në arsim në Norvegji .
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm /tjetër? etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikatat pedagogjike; tjetër)?	School Mentor është një burim i synuar për reflektime dhe element kyç janë diskutimet e gjeneruara nga deklaratat e ndryshme. School Mentor nuk është menduar të jetë një mjet statusi apo raportimi. Si pikënisje, vetëm shkolla do të ketë qasje në raportet e saj. Shkolla mund të vendosë nëse dëshiron t'i japë pronarit të shkollës qasje në rezultate. School Mentor shërben më së miri për diskutimin nga administrata e shkollës të deklaratave të ndryshme në bashkëpunim me një grup në shkollë. Një person i vetëm duhet të jetë përgjegjës për regjistrimin e përgjigjeve në deklarata në mjetin School Mentor. Ky mjet i ofron shkollës mundësinë për të reflektuar për lehtësimin dhe ekzekutimin pedagogjik nga ana e saj të TIK-ut. Përmes përdorimit të School Mentor, administrata e shkollës do të jetë në gjendje të përdorë reflektimet për gjendjen aktuale dhe propozimet vijuese për masa për përmirësimin e punës strategjike dhe pedagogjike të shkollës, e cila në këmbim mund të përmirësojë rezultatet e të nxëniet të studentëve. School Mentor është zhvilluar për të siguruar që investimet e shkollës në TIK në aspektin e pajisjeve dhe zhvillimin e kompetencës digjitale të personelit, do të bazohen në objektiva reale. Përdorimi i School Mentor mund të jetë i dobishëm për të filluar

	një dialog me pronarin e shkollës për të dokumentuar nevojat dhe për të identifikuar sfidat. Pikat e forta dhe të dobëta në shkollë identifikohen përmes reflektimeve. Rekomandimet për punë të mëtejme prezantohen pas përfundimit të procesit. Ndonëse School Mentor synohet të përdoret kryesisht për administratën e shkollës, programi duhet të përdoret në bashkëpunim me mësuesin dhe punonjësit e tjerë. Kjo përfshirje e anëtarëve të personelit mësues duhet të sigurojë një integritet të fuqishëm dhe kuptimin e vizionit të shkollës, praktikës dhe të nxënës në aspektin e përdorimit të TIK-ut.
Kush e plotëson pyetësin dhe kur?	Drejtori i shkollës
Sa pyetje ka në tërë pyetësin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	School Mentor ka 30 deklarata të ndara në gjashtë fusha të ndryshme. Përgjigja e duhur në deklarata përcaktohet duke reflektuar për nivelin në të cilin gjendet shkolla dhe mund të fillohet me cilëndo nga fushat. Fushat janë si vijon: * Administrata dhe kushtet e kornizës * Burimet e shkollës * Paraqitja dhe planifikimi * Kompetenca digjitale * Praktika pedagogjike * Organizimi Informacionet në secilën fushë janë të disponueshme në Udhëzuesin e fushës (Area Guide). Udhëzuesi i fushës vihet në dispozicion pas fillimit të mjetit School Mentor. Përgjigjet ruhen një pas një dhe School Mentor mund të plotësohet shpejt ose ngadalë dhe në rendin që ju doni. Po ashtu të dhënat e një raundi mund të ruhen dhe të përdoren për krahasim me raundet pasuese. 500 përdorues. Përdorues të versionit Demo 1200? 1200 përdorues/përgjigje
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasoni rezultatet tuaja me ato të mëhershmet?	Një raport gjenerohet brenda secilës fushë duke treguar gjendjen dhe propozimet për masa. Pasi të përfundohet, gjenerohet një raport kryesor bazuar në të gjitha masat e propozuara, me këshilla specifike për punë të mëtejshme në planifikimin dhe ekzekutimin e përdorimit pedagogjik të TIK-ut.
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësi/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	Nuk kemi shifra për versionin demo.
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për organizatat arsimore/individët për plotësimin ose mosplotësimin e këtij pyetësi/mjeti në linjë?	Jo
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore/veprim (rajonale/kombëtare/evropiane)?	
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	
A ka një proces për përditësimin e pyetësit/mjetit në linjë? Nëse po, si	School Mentor do të integrohet në burimin e planifikimit për pronarët e shkollave

dhe sa shpesh?
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?

Opeka Informacionet e ofruara nga Jarmo Viteli	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	Opeka, një mjet vlerësimi në linjë për mësimdhënësit dhe shkollat për kompetencën dhe kulturën e tyre digjitale www.opeka.fi
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Qendra Kërkimore e Tampere për informacion dhe media (TRIM), Universiteti i Tampere, Finlandë
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e tij?	Fillimisht Opeka u zhvillua nga TRIM në partneritet të ngushtë me qytetin e Tampere, Bordin e Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka mjet pararendës?	OPEKA bazohet në metodat e vlerësimit të kompetencave të TIK-ut të mësimdhënësit (shkathtësitë, qëndrimet, motivimi, praktikat pedagogjike, bashkëpunimi)
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të tij?	Zhvillimi filloi në fillim të vitit 2012. Versionet pilot u realizuan në pranverën e vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013 shërbimi u përhap në mbarë vendin.
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Shërbimi i uebit në linjë i bazuar në një bazë të dhënash në linjë
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm/tjetër? etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikat pedagogjike; tjetër)?	- Mësimdhënësit në Finlandë, shkollat fillore dhe të mesme - Vetë-vlerësimi për mësimdhënësit - Tri "module": kultura e mësimit digjital, pajisjet dhe softuerët dhe shkathtësitë e TIK-ut
Kush e plotëson pyetësorin dhe kur?	Mësimdhënësit sa herë që duan, kryesisht një herë në vit ose pas çdo ndërhyrjeje që lidhet me TIK-un.
Sa pyetje ka në tërë pyetësorin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	145 pyetje, duke përfshirë 10 pyetje që lidhen me cilësinë e pyetësorit, disa pyetje lidhur me pajisjet dhe softuerët që i anketuari zgjedh dhe rreth dhjetë pyetje për informacione historiku (shkolla ku mësimdhënësi jep mësim etj.). Vetëm pyetjet e detyrueshme lidhen me informacionet e historikut. Në praktikë shumica e mësimdhënëseve përgjigjen në të gjitha pyetjet.
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasosh rezultatet e tua me ato të mëhershmet?	- Rezultatet mund të shihen në çdo kohë gjatë vitit kalendarik - Krahasimet me rezultatet e mëhershme mund të bëhen
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësori/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	- Pyetjet që lidhin përgjigjet individuale me pyetjet nuk mund të shihen përmes ndërfaqes WWW. - Pjesëmarrësit individualë mund të krahasojnë veten me shkollën e tyre, qytetin, mësimdhënësit që japin të njëjtën lëndë ose nivel si ata apo edhe tërë pjesëmarrësit që janë përgjigjur - Krahasimet ipen po ashtu gjatë plotësimit të pyetësorit pasi pjesëmarrësi të jetë përgjigjur në çdo pyetje. - Raportet që përmbajnë shpërndarjen e përgjigjeve të shkollave, qyteteve ose kombinime të këtyre mund të shihen nga personeli i lidhur me atë organizatë. Këto ipen vetëm kur të paktën 5 përgjigje janë marrë për të mbrojtur anonimitetin e pjesëmarrësve që janë përgjigjur.
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësorin/mjetin në linjë?	151 komuna / nga 330 1267 shkolla / nga 2800 13540 pjesëmarrës / nga 50 000
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për	Jo.

organizatat mësimore/individët nëse plotësojnë ose jo pyetësin/mjetin në linjë?	
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore/veprim (rajonale/kombëtare/evropiane)?	Informacionet do të përdoren për të modifikuar politikat për TIK në mjediset e shkollave në Finlandë.
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	Ne synojmë të gjitha shkollat dhe komunat në Finlandë, por në praktikë shkollat dhe komunat individuale (dhe në disa raste mësimdhënësit individualë) vendosin vetë nëse duan të marrin pjesë.
A ka një proces për përditësimin e pyetësit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	E kemi përditësuar pyetësin disa herë, por nuk ka ndonjë proces të përcaktuar.
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Disa publikime: Heikki Sairanen ja Mikko Vuorinen. "Opetusteknologian käytön trendit". Tuovi 12: Interaktiivinen tekniikka koulutuksessa 2014-konferenssin tutkijataapaamisen artikkelit. 2014. Jarmo Viteli, Heikki Sairanen ja Mikko Vuorinen. "The building blocks of a working digital culture: The case of some Finnish schools." World Conference on E-Learning in Corporate, Government, Healthcare, and Higher Education. Vol. 2013. No. 1. 2013. Jarmo Viteli. "Teachers and Use of ICT in Education: Pilot Study And Testing of the Opeka System". In Jan Herrington et al. (Eds.), Proceedings of World Conference on Educational Multimedia, Hypermedia and Telecommunications 2013 (pp. 2326-2346). Chesapeake, VA: AACE. Heikki Sairanen, Jarmo Viteli ja Mikko Vuorinen. "Laitteiden ja ohjelmistojen käyttö suomalaisissa kouluissa vuonna 2012." (2013). Heikki Sairanen ja Mikko Vuorinen. "Opetusteknologian kartoittimen kehittäminen ja arviointi." Tuovi 10: Interaktiivinen tekniikka koulutuksessa 2012-konferenssin tutkijataapaamisen artikkelit (2012): 22. Heikki Sairanen, Mikko Vuorinen ja Jarmo Viteli. "Collecting and Using Data to Develop Digital Learning Culture at School", esitelty TEPE 2013 konferenssissa
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	

Vensters voor Primair en Voortgezet Onderwijs Informacionet e ofruara nga Maartje Meuwissen dhe Bruno Emans	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	www.scholenopdekaart.nl , 'Vensters voor Primair en Voortgezet Onderwijs' - mjet në linjë për llogaridhënie dhe transparencë të të gjitha shkollave fillore dhe të mesme
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	- Këshilli për Arsimin Fillor Holandë - Këshilli për Arsimin e Mesëm Holandë - Organizuar në fondacionin "Schoolinfo" Maartje Meuwissen, maartjemeuwissen@schoolinfo.nl Bruno Emans, bruno@emans.nl
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Palët kryesore të interesit: të gjitha shkollat Audiencia parësore: prindërit, nxënësit, publiku Palët dytësore të interesit: Ministria e Arsimit, Inspektorati i Arsimit, të tjerë
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka kornizë pararendëse?	- Gazetat dhe mediat e tjera po "klasifikonin" shkollat. ("Cilat janë shkollat më të mira dhe më të dobëta në Holandë?") - Disponueshmëria e shpejtë e të dhënave pa përfshirjen direkte të shkollës www.scholenopdekaart.nl është një kundër-nismë e sektorit të arsimit për të arritur pronësinë e procesit të të dhënave - Sistemi ofron transparencë dhe llogaridhënie për cilësinë e ofruar dhe politikën e të gjitha shkollave në Holandë - Tani, ka një 'standard të artë' të përbashkët rreth informacioneve arsimore - Pronësia e kornizës i takon shkollave. Ato vendosin se cilat informacione prezantohet dhe si
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	2008: fillimi i zhvillimit 2011: mbulimi kombëtar për arsimin e mesëm Gjendja aktuale: stabiliteti për arsimin e mesëm, arritja e mbulimit kombëtar për arsimin fillor, përditësimet e rregullta
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Baza qendrore e të dhënave e kombinuar me një sistem në linjë për shkollat për të ofruar informacione shtesë. Rezultatet në një sajt uebi publik.
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm/ tjetër? etj.) Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikat pedagogjike; tjetër)?	- Llogaridhënia dhe transparencja e politikave dhe arritjet e të gjitha shkollave në Holandë - Shkolla fillore (6.000) dhe shkolla të mesme (1.360) - Njëzet tregues të standardizuar që përfshijnë tema të ndryshme: numrat e nxënësve, rezultatet e provimeve, kënaqëshmërinë e nxënësve, kënaqëshmërinë e prindërve, karakteristikat e ekipit të mësimdhënies, situatën financiare, partneritetet, planin e shkollës etj. Në uebsajtin kombëtar shkollat mund ta prezantojnë veten bazuar në një standard me njëzet tregues të shoqëruar me pika të referencës. Shifrat prezantohen bashkërisht me një shpjegim nga shkolla. Pranë uebsajtit publik, është një uebsajt me më shumë informacione dhe pika të referencës (informacione të menaxhmentit) për shkollat në një mjedis në linjë të siguruar. Parimet kyçe: - Informacionet e prezantuara në <u>nivël shkolle</u>

	(të dallueshme për publikun) 2) Të mbahen të thjeshta por <u>të sakta</u> 3) Shkolla prezanton një <u>raport "digjital" të performancës së saj</u> 4) Ofron material për të filluar një <u>dialog me palët e interesit</u> dhe ofron <u>pika të referencës për të filluar përmirësimin</u> 5) <u>Një fotografi e paanshme dhe e balancuar</u> (20 tregues të natyrave të ndryshme)
Kush e plotëson pyetësin dhe kur?	- Të dhënat e centralizuara: Ministria e Arsimit, Inspektorati i Arsimit, dy herë në vit. - Të dhënat dhe informacionet e tjera: shkollat, periudhat e standardizuara në cikle një vjeçare. Dy parime: - përdorimi i të dhënave ekzistuese kur është e mundur - reduktimi i pyetjeve të përsëritura për shkollat (dhe si rrjedhim reduktimi i ngarkesës së punës)
Sa pyetje ka në tërë pyetësin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	20 tregues me të dhëna të centralizuara dhe të dhëna të shkollës. Shkollat mund të zgjedhin nivelin e dhënies së informatave dhe mund të <u>shtojnë storien e tyre dhe shpjegimin e të dhënave.</u>
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasoni rezultatet tuaja me ato të mëhershmet?	Po, krahasimi me pikat e referencës deri në pesë vite është standard në raportet e lehta për përdorim për shkollat.
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësi/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	20 tregues janë publikë dhe përfshijnë pika të referencës. Audienca janë prindërit, nxënësit dhe publiku i interesuar për çështje arsimore. Me informacione të sakta, të padiskutueshme dhe të përditësuara, dialogu midis palëve të interesit për politikën dhe arritjet mund të përmirësohet. Informacionet më të ndjeshme dhe më të elaboruara të menaxhmentit janë të qasshme vetëm për shkollat. Kjo pjesë përmban edhe më shumë opsione për pikat e referencës dhe krahasimin.
Sa organizata arsimore/ individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	>95% e shkollave të mesme 88% e shkollave fillore - Të dhënat e centralizuara 100%
A ka pasoja (p.sh. stimuj, sanksione...) për organizatat arsimore/individët për plotësimin ose mosplotësimin e këtij pyetësi/mjeti në linjë?	Të dhënat e centralizuara publikohen për të gjitha shkollat. Për të tjerët, mjeti është një <u>instrument vullnetar</u> , ndonëse ka presion <u>nga palët e njëjta</u> dhe <u>presion publik</u> . Kur marrin pjesë, shkollat kanë qasje në informacione më të elaboruara të menaxhimit.
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore/veprim (rajonale/kombëtare/evropiane)?	Po, ka komponentë të fuqishëm të politikave: - Disa politika kanë gjetur vend brenda sistemit (p.sh. "koha e mësimdhënies") - Korniza ofron informacione për Këshillat dhe Ministrinë e Holandës. Vendimet mund të merren bazuar në të dhëna të sakta, të përditësuara, të padiskutueshme - Informacionet mund të gjenerohen për të nisur politika të reja - Pyetjet e përsëritura për shkollat janë reduktuar (nga qeveria, këshillat, institutet kërkimore, Inspektorati). Reduktimi i ngarkesës administrative për shkollat - Procesi i inspektimit të shkollave mund të përmirësohet
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	100%, nisma proaktive për të nxitur shkollat që të marrin pjesë dhe për t'ju ndihmuar të përdorin mjetin.
A ka një proces për përditësimin e pyetësit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	Fokusi në një sistem të qëndrueshëm, vazhdimisht të vlerësuar, të zhvilluar dhe përditësuar.

A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	• Klasifikimi në media kombëtare është ndalur. • Sajtet e komunave i referojnë prindërit tek www.scholenopdekaart.nl • Administrata dhe sistemi i nxënësve i referohen pikave tona të referencës • Ka një lidhje direkte në linjë nga platforma jonë për tek sajti i uebit i Inspektoratit • Partneritetet me institutet kërkimore.
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	Prezantim shtesë me vizualizime është i disponueshëm.

LIKA Informacionet e ofruara nga Jan Hysten	
Cili është titulli i plotë dhe adresa(t) e uebit e pyetësorit/mjetit në linjë?	Ledning, Infrastruktur, Kompetens, Användning - LIKA (Menaxhimi, Infrastruktur, Ekspertiza dhe Përdorimi) http://lika.ski.se/
Cila është organizata që drejton nismën? Kush janë personat e kontaktit?	Kryeson SALAR (Swedish Association of Local Administrations and Regions). Personi kontaktues është znj. Johanna Karlén, johanna.karlen@ski.se
Kush janë zhvilluesit/palët e interesit të përfshira në zhvillimin/zbatimin e saj?	Është zhvilluar nga një kompani për konsultime e quajtur Governo në emër të SALAR. Palët e interesit të përfshira në zhvillim janë edhe Agjencia Kombëtare për Arsime dhe Komiteti për Digjitalizim
Cili është historiku? A bazohet në ndonjë kornizë konceptuale? A ka kornizë pararendëse?	Historiku është një marrëveshje midis qeverisë dhe SALAR. SALAR duhet të zhvillojë një kornizë për të ndihmuar shkollat dhe komunitet që të zhvillojnë strategji për menaxhimin e ndryshimit dhe vlerësimin e vazhdueshëm. Gjithashtu, duhet të mbështetë përpjekjet për të vlerësuar, planifikuar dhe prioritetizuar operacionet e digjitalizimit në shkollat. Nuk ka kornizë pararendëse
Cilat janë datat e fillimit/përfundimit të zhvillimit/zbatimit të saj?	Data e fillimit për zhvillim – vjeshtë 2013. Data e fillimit për zbatim 27 gusht 2014.
Cili është formati i pyetësorit (bazë të dhënash në linjë/letër/tjetër)?	Bazë të dhënash në linjë
Cila është tema (ju lutemi, ofroni një përshkrim të shkurtër, përmendni sektorët arsimorë të mbuluar, mbulimin gjeografik, shpjegoni nëse është një mjet i vetë-vlerësimit/mjet i vetë-rishikimit/mjet i vlerësimit të jashtëm/tjetër? etj.)? Cili është fokusi (p.sh. integrimi i TIK-ut; novacioni; hapja; praktikatat pedagogjike; tjetër)?	Është për menaxhimin, infrastrukturën, ekspertizën dhe përdorimin. Supozohet të përdoret nga shkollat. Është e hapur për të gjitha shkollat në Suedi (dhe jashtë saj). Supozohet të udhëzojë shkollat për mënyrën e prioritetizimit të veprimeve (zhvillimin e kompetencës, zhvillimin e infrastrukturës, zhvillimin pedagogjik etj.). Mjeti jep reagime automatike të formuluaras kësaj – "ndoshta duhet të filloni në këtë fushë ... duke e bërë këtë ...". Mjeti plotësohet nga një blog me Pyetje dhe Përgjigje, video ku menaxherja e projektit jep këndvështrimin e saj për mënyrën se si të ndërmerren hapet e tjerë pas përfundimit të pyetësorit, këmbimin e përvojave midis shkollave që përdorin mjetin etj. http://lika.ski.se/blogg
Kush e plotëson pyetësin dhe kur?	Drejtori i shkollës. Kurdo.
Sa pyetje ka në tërë pyetësin? Sa prej tyre janë të detyrueshme? Cila është shkalla(ët) e përdorur?	78 pyetje gjithsej. Asnjë nuk është e detyrueshme. Shkalla ka pesë hapa: "Nuk është planifikuar", "Është planifikuar", "Ka filluar", "Gati në përfundim", "E arritur"
A është e mundur të ruhen rezultatet për t'i qasur më vonë? A mund të krahasoni rezultatet tuaja me ato të mëshmet?	Po. Po
Kush ka qasje në rezultate? Si mund t'i përdorë ato ai/ajo? A të lejon pyetësi/mjeti në linjë të krahasosh organizatën tënde/veten me të tjerët?	I mbetet përdoruesit të vendosë se kush ka qasje në rezultate. Mund të jem vetëm unë ose shkolla, ose nëse unë zgjedh mund të ndaj rezultatet e shkollës sime në formë anonime me pjesën tjetër të vendit. Rezultatet e shkollës nuk mund të krahasohen me të tjerët në linjë, por jashtë linje
Sa organizata arsimore/individë e kanë plotësuar tashmë pyetësin/mjetin në linjë?	Gjatë fazës pilot (pranverë 2014) shkollat nga 18 komuna kanë përdorur mjetin
A ka pasojë (p.sh. stimul, sanksione...) për organizatat arsimore/individët për plotësimin ose mosplotësimin e këtij pyetësi/mjeti në linjë?	Jo. Është tërësisht në baza vullnetare
A është i lidhur pyetësi/mjeti në linjë me ndonjë politikë arsimore (rajonale/kombëtare/evropiane)?	Jo
Cila është % e organizatave arsimore/individëve të synuar brenda rajonit/vendit tuaj?	100% e shkollave në vend

A ka një proces për përditësimin e pyetësorit/mjetit në linjë? Nëse po, si dhe sa shpesh?	Jo për aq sa unë di
A ka publikime, raporte vlerësimi, burime në linjë etj. të ndërlidhura?	Ka video udhëzuese në linjë për t'i ndihmuar shkollat të përdorin mjetin. Po ashtu është një blog tashmë i përmendur http://lika.skiblogg.se/
Ndonjë informacion shtesë që mendoni se është relevant dhe me rëndësi?	

Europe Direct është një shërbim që ju ndihmon të gjeni përgjigjet për pyetjet tuaja lidhur me Bashkimin Evropian
Numri i telefonit falas (*): 00 800 6 7 8 9 10 11
(*) Disa operatorë të telefonisë celulare nuk lejojnë qasjen në numrat 00 800 ose këto telefonata mund të faturohen.
Informacione të tjera për Bashkimin Evropian janë të disponueshme në internet. Mund të qasen përmes serverit <http://europa.eu>

Si të merren publikimet e BE-së

Publikimet tona janë të disponueshme nga Biblioteka e BE-së (<http://bookshop.europa.eu>), ku mund të bëni porosi me agjentin e shitjes që zgjidhni.

Zyra e publikimeve ka një rrjet të agjentëve të shitjes në mbarë botën.
Detajet e tyre të kontaktit mund t'i merrni duke dërguar një faks në numrin (352) 29 29-42758.

Misioni i JRC-së

Si shërbim shkencor i brendshëm i Komisionit Evropian, misioni i Qendrës së Përbashkët për Kërkime është të ofrojë mbështetje teknike për politikatat e BE-së me dëshmi të pavarura gjatë gjithë ciklit të politikave.

Duke punuar ngushtë me Drejtorinë Gjenerale, JRC-ja adreson sfidat kyçe të shoqërisë ndërsa inkurajon inovacionin përmes zhvillimit të metodave, mjeteve dhe standardeve të reja, dhe ndarjes së njohurive teknike me Shtetet anëtare, Komunitetin shkencor dhe partnerët ndërkombëtarë.

*Në shërbim të shoqërisë
Duke stimuluar inovacionin
Duke mbështetur legjislacionin*

doi:10.2791/54070

ISBN 978-92-79-54005-9

Commented [A1]: Eshte perkthyer, megjithate shikoni nese duhet lenë ne gjuhen angleze

